ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 17 KORRIK 2021. NUMËR 139. VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Nurie Emrullai dhe Andreas Dushi, janë dy krijues të rinj, pothuaj moshatarë të cilët po njihen çdo ditë e më shumë nga lexuesi. Nuria e rritur në Kërçovë, në një vend me dy gjuhë zyrtare kurse Andreasi vjen nga Shkodra e emrave të mëdhenj të artit dhe letërsisë shqipe. Në këtë bisedë të çiltër ato shkëmbejnë përvojat e tyre dhe shpalosin projektet për të ardhmen.

NURIE EMRULLAI ANDREAS DUSHI

Letërsia është ajo që i heq të gjithë kufijtë

In memoriam

URAN KOSTRECI

Poeti që ringjalli sonetin

nga Enver Kushi (fq. 8)

Një kujtim-homazh për poetin Uran Kostreci

nga Uran Butka (fq. 9)



DRAMATURGJIA E ETËHEM HAXHIADEMIT DHE SKENA E ASAJ KOHE

Nga Virion Graçi (fq. 6)

Krijimtaria letrare Etëhem Haxhiademit, e dënuar me heshtje dhe ndëshkime të skajshme përgjatë gjysmës së dytë të shek.XX në Shqipëri, del e plotë në dritë për njohje dhe studim këto kohë. Etëhem Haxhiademi, edhe vetë personazh tragjik në historinë e Shqipërisë komuniste, i dënuar padrejtësisht, është dalluar në vitet tridhjetë mes krijuesëve, përkthyesëve dhe intelektualëve të tjerë. Ajo epokë e ka dashur E. Haxhiademin...

Rreth romanit "Mbi tokën e ngushtë" të Thanas Dinos

NJË GJIROKASTËR SA ÇUDANE AQ DHE E ËMBËL...

Nga Josif Papagjoni (fq. 18)

Vëllimi me tregime "Tregime të një personazhi" të Esmeralda Shpatës

TREGIMET E NJË PERSONAZHI TË RI

Nga Ballsor Hoxha (fq. 19)

"RRAKULLIMA" E BEQIR MUSLIUT, DRAMATIKA HERMETIKE E MBITEKSTIT

Nga Behar Gjoka (fq. 5)

MIQËSIA TEK "UDHËTIM NË MALIN E SHENJTË" NGA NIKOS KAZANXAQIS

Nga Damian Alia (fq. 20)

SHKRIMTARI NASI LERA NDEROHET ME ÇMIMIN LETRAR "BEQIR MUSLIU" PËR VITIN 2021

Nga Emin Azemi (fq. 14)

SIMPATI PËR TRADHTARIN: NJË MANIFEST PËR PËRKTHIMIN

Mark Polizzotti

(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Rexhep Ferri *Maska e Zotit* (fq. 12)

Hajri Shaqiri *Bruno* (fq. 11)

Lindita Agolli *Dy tregime* (fq. 13)

Shazim Mehmeti *Dy tregime* (fq. 10)

Raymond Carver *Dhe diçka tjetër* (fq. 21)

Rainer Maria Rilke *Ishulli: Deti i Veriut* (fq. 23)

Sfidat e Xhevat Lloshit në interpretimet e disa veprave letrare

Nga Floresha Dado (fq. 16)

Në këtë vëllim me studime mbi tekste letrare nuk kemi subjektivizmin e një lexuesi të zakonshëm, por kuptime, mbikuptime të një specialisti të ligjërimeve, pra dhe të ligjërimit letrar...Kjo ka peshën e vet... Xh.Lloshi është *studiues i lirë,* me vëzhgime të vetat, të cilat, brenda subjektivitetit të natyrshëm, ngrihen përgjithësisht mbi koncepte dhe parime shkencore...

Nurie Emrullai dhe Andreas Dushi, janë dy krijues të rinj, pothuaj moshatarë të cilët po njihen çdo ditë e më shumë nga lexuesi. Nuria e rritur në Kërçovë, në një vend me dy gjuhë zyrtare kurse Andreasi vjen nga Shkodra e emrave të mëdhenj të artit dhe letërsisë shqipe. Në këtë bisedë të çiltër ato shkëmbejnë përvojat e tyre dhe shpalosin projektet për të ardhmen.

NURIE EMRULLAI ANDREAS DUSHI

Letërsia është ajo që i heq të gjithë kufijtë

A. D.: Nurie, së pari shumë urime për çmimin. Një vlerësim për ty, po aq sa është vlerësim edhe për brezin e ri të poetëve shqiptarë, mes të cilëve, për mendimin tim, vargu yt meriton një vend të veçantë. Me ç'emocion e përcolle atë moment?

N. E.: Faleminderit për urimin Andreas! Është fat për mua që e ndajmë të njëjtën kohë krijuese dhe po e zhvillojmë këtë bashkëbisedim. Si studiues dhe krijues i ri që je, më gëzon fakti që je kaq i përkushtuar ndaj letërsisë dhe je njohës i mirë i saj. Sa i përket kritikës letrare dhe çmimeve në letërsi, them se janë mjaft me rëndësi, si për autorin, gjithashtu dhe për lexuesin. Përmes kritikës letrare vëmendja e një pjese të mirë të lexuesve orientohet drejt veprës e cila tërheq vëmendje dhe vlerësohet. Përndryshe, përveç entuziazmit që vjen si ndjenjë e parë kur të përcillet një lajm i mirë, midis gëzimeve dhe urimeve të shumta që kam marrë, shtohet dhe përgjegjësia ndaj asaj që krijon, ndonëse kjo kthjelltësi duhet të jetë gjithmonë shoqëruesja e parë e krijuesit.

Po ti, duke e parë nga një sy si të thuash i jashtëm, si i sheh çmimet letrare në përgjithësi?

A. D.: Vërej të jenë intensifikuar ndjeshëm! Vepra, kur e merr një çmim, sikur fiton mbi kokë një aureolë të cilën, veç kohët e fundit ndjej ta meritojë vërtetë. Kjo është edhe arsyeja pse ajo ndriçon më shumë, pasi vjen si rezultat i një vlerësimi serioz bazuar veç mbi parime estetike të qarta, që sigurisht, duhet thënë se e ruajnë në vete një dozë subjektiviteti, por në tërësinë e tyre i përgjigjen koncepteve themelore të *shijes*. E për më tepër, kur *pasaporta* me të cilën bëhesh pjesë e konkurseve apo e vendos emrin në kontekst diskutimi mbi një çmim është vetëm gjuha e jo nënshtetësia, ndihesh më mirë, si kur e sheh nga jashtë, sikurse thua ti, por besoj edhe kur je laureat.

Ndërkohë, muaji i shkuar besoj do të mbetet në kujtesën tënde për shumë kohë, kjo pasi ishe në Tiranë ku, edhe me mua si me shumë miq e kolegë të tjerë të librave, u takove, ballëpërballë, për të parën herë. Është një ndjenjë krejt e veçantë ajo që përjeton kur dikujt i njeh veç poezinë: të duket sikur vendos një lidhje direkte me shpirtin. Prandaj, të të takoja, të të takonim, qe përplotësimi i një gëzimi që së pari na u lind prej vargjeve tuaja. Nuk e di, po për ty? Si ishin ato dy ditë? Të gëzoi, besoj dashamirësia e treguar nga shqiptarët e kësaj ane të kufirit?

N. E.: Fundjava në Tiranë, ishte takim shumë i pritur. Ardhja ime atje ishte një lloj befasie e një mikëpritje shumë e veçantë dhe në të njëjtën kohë shumë e zakonshme, siç presim në shtëpi një mik të mirë… Shtëpia Botuese është shtëpia e dytë e shkrimtarit, këtë gjë ma ka thënë z.Hudhri dhe që është një nga shprehjet më të bukura që do çdo shkrimtar do të kishte dëshirë ta dëgjonte. Që siç the dhe ti Andreas, pjesa më e madhe e njohjes ishte bërë përmes shkëmbimit të ideve mbi shkrimet tona letrare, prandaj kjo ishte ajo çka e bëri këtë takim më të mirëpritur. Pastaj mbrëmja letrare që u organizua te libraria "Onufri" qe gjithashtu një event mjaft i rëndësishëm për mua, sepse për herë të parë isha midis njerëzish që unë i njihja vetëm përmes veprave të tyre. Nuk mund të mos e lë pa përmendur dhe takimin që pata me shkrimtarin Ismail Kadare. Një ditë e shënuar dhe një përmbledhje e bukur e gjithë këtij takimi.

Dashamirësia dhe vlerësimi që më bëhen nga njerëzit e mi, unë i çmoj jashtëzakonisht shumë. Por, nuk do të doja të përdornim fjalën kufi. Në fakt nuk e di cilën fjalë mund të përdorim këtu, por nuk më pëlqen kjo fjalë, sepse është si të theksojmë një lloj ndarjeje. Dashuria që ushqejmë për gjuhën dhe për Shqipërinë, na ka bërë ta shohim si një vend që s'ka kufinj. Mbase këto fjalë tingëllojnë si fjalët e një njeriu shumë ëndërrimtar, por besoj tek ato ëndrra, thelbi i të cilave është i krijuar prej realiteti; Sidomos te letërsia; Letërsia është ajo që i heq të gjithë kufijtë dhe na mban të lidhur kaq sigurt në nyjet që kemi krjuar nëpër gjithë këta shekuj. Që fati jonë ka qenë kështu, tani historia nuk zhbëhet më, por mendoj se arti është një prej elementeve më me rëndësi që na mban lidhur kaq fort. Andaj i gëzohem shumë gjithë kësaj.

Po ti si i ke imagjinuar njerëzit nga kjo anë e kufirit? Cila ka qenë lidhja e parë, apo ndjesia e parë kur je njoftuar me letërsinë e kësaj ane?

A. D.: Letërsia shqipe zë fill në mallin e shqiptarëve për Shqipërinë. Sikur edhe vetëm shkrimtarët arbëreshë do të mjaftonin si argument në mbështetje të kësaj teze. Dhe besoj se shpeshherë, shqiptarët matanë kufrit, dikur në Itali e sot në Kosovë a Maqedoni, janë pararendës të një fryme a poetike që më vonë arrin këtej. Në Shkodër, nga lloji i erës, e ftohtë apo e ngrohtë, e lagësht apo e thatë e kupton se prej ku po vjen ajo. Edhe në rastin tonë, ndonëse është analogji e dobët, era që fryn nga ajo anë e kufirit, sikur e qartëson dhe pasuron ambientin kulturor e letrar shqiptar dhe i ofron risitë e andejme që sjell me vete këndej. Ndoshta këtu mund të zërë vend një tjetër pyetje (shumë më e thjeshtë të pyesësh se të përgjigjesh!). A e kujton si dhe kur të lindi nevoja për të shkruar poezi?

N.E.: Po e kujtoj një rast që ka lënë gjurmë në jetën time dhe po dua ta tregoj. Është ndodhi e jetuar para 13- të viteve. Sapo kisha nisur gjimnazin, secili prej nesh vinte nga fshatra të largët e shikohej me dyshim. Jeta në provincë është e rëndë për atë që ushqehet ndryshe. Kur mua më pyetën dhe salla ishte e mbushur me moshatarë të mi se: "Çfarë duam të bëhemi në të ardhmen?" Shumica prej tyre mbase nuk e kishin menduar deri në atë çast se çfarë duan të bëhen, disa prej tyre nuk kishin idenë e qartë, të tjerët nuk flisnin, mbase kishin turp për ëndrrat e tyre (sepse atë ide na kishin mbjellë në kokë, apo dhe mosha bënte punën e saj), ndërsa kur erdhi radha tek unë, një vajzë me një buzëqeshje të ndrojtur dhe me një fytyrë të skuqur nga vështrimet e të tjerëve, thashë që: "Ëndrra ime është të bëhem poete." Atëherë kishte disa vite që shkruaja, apo merrja fjalë nga poezitë që lexoja dhe i krijoja sipas mendjes sime, por nuk guxonte t'i lexonte askush. Madje, askush nuk guxonte të dinte se unë shkruaja, letrat e mia ndodheshin gjithnjë midis librash, fletoresh, apo brenda një ditari të vogël që hapej me çelës dhe çelësin e mbaja gjithnjë me vete. Gazetari ishte prej një organizate të huaj, me sa e mbaj mend, ai më pyeti për herë të dytë se u bë sikur nuk e kuptoi se çfarë doja të thoja... Unë përsëri iu përgjigja se dua të bëhem poete. Shumica prej fytyrave që sot as nuk i kujtoj qartë, por dëgjoj akoma të qeshurën e tyre tallëse, "se çfarë i ka shkrepur në mendje kësaj vajze, e cila mezi i nxjerrë dy fjalë nga goja." Tani dhe për punën e poetes, unë nuk deklarohem asnjëherë që jam poete, sepse mbase nuk ka definim të saktë a mbase nuk jam. Jam një njeri që më shijon poezia dhe më shijon të lexoj e të shoh botën e ta shpreh përmes fjalës... Nga ai çast që ata shokë e ato shoqe qeshën me mua, më bënë që të mendoj se mbase unë duhet të jem si të gjithë, që unë duhet ta ndrydh zërin tim që ishte aq i gjallë brenda meje duke më folur për fluturat, shiun, gjethet, tokën dhe dashurinë (kujtoni adoleshencën)... Ka pasur raste që dhe më vonë kam pasur tallje e krahasime me njerëz që i tallnin. Por mua nuk më krijonin përshtypje sepse isha mësuar që Poeti këtu do të shikohej si një njeri, që njerëzit fitojnë të drejtën të luajnë mbi ndjeshmërinë e tij. Por unë e dija që do të vinte koha kur ata tinëzisht do të hynin nëpër vargjet e mia për të gjetur pakëz prehje shpirti. Vazhdoi kjo gjë, derisa një ditë, duke u munduar aq shumë të jem si ata që rrethohesha, papritmas bota ime u përmbys dhe unë isha vetëm midis të gjithëve. U humba në jetë. Koha kalonte dhe zërin tim e kisha shtypur aq shumë sa mendoja që unë s'kam qenë ajo vajza që i ka thënë ato fjalë, se ka ëndërruar ndonjëherë. Sado e vështirë, unë gjeta kthimin në vete sepse ajo ishte, unë kisha qenë në kërkim të vetes dhe atë çast kuptova se: Unë dëgjoja, shikoja, dhe dashuroja, vuaja më fort nga të gjithë (ashtu mendon secili nga ne), por unë gjithashtu kuptova se e kisha zërin për ta thënë, unë mund ta thoja atë që ndieja. Dhe një ditë e thashë. Një ditë fola dhe shpirti im gjeti qetësinë, gjeti heshtjen që e kishte humbur prej ditës kur unë provova të jem si të tjerët. Dhe e di çfarë ndodhi? Kam parë njerëz, para syve të mi që kanë qeshur e kanë qarë. Kanë qarë duke lexuar poezitë e mia, kanë qarë para meje duke kujtuar nënën, motrën, babain, të dashurin apo në fund janë kujtuar për veten. Dhe unë s'kisha ç'të bëja përballë tyre përveç se t'u thoja që: "ti nuk je vetëm!" Unë të kuptoj, unë dëgjoj zemrën tënde, unë mund të dëgjoj shpirtin tënd, unë të dua dhe dua të të shpëtoj sepse në këtë rrugë jemi bashkë sepse unë jam poete apo çfarëdo që ta ketë emrin, por mbi të gjitha unë jam njësoj si ty. Sepse unë isha në kërkim të vetes dhe unë e gjeta atë.

Po ti, a i kujton fillimet tuaja në letërsi?

A. D.: Lidhet me një çast jo aq të qartë në rininë time të hershme, fazën e parë të adoleshencës e po të duash, e quaj edhe dashurinë e parë, kur akoma nuk e dija as ç'ishte dashuria, as ç'ishte "e para". Ngase ditët, para asaj thyerje të beftë ishin të njëjta, më frikësonte idea se pas *thyerjes* do të riktheheshin po ashtu, mediokre e boshe. Prandaj nuk doja t'i harroja këto ditë e vendosa t'i shkruaj, jo në trajtë ditari por si skica, pa pretendimin as për t'i quajtur letrare.

Më vonë, kur *thyerja* u ngjit dhe ditët vërtetë iu rikthyen zymtësisë së tyre, i lexova dhe më pëlqyen. Ndaj, i shkrova ndonjë reviste që nuk m'i pranoi. Konkurova për t'i bërë pjesë në antologji dhe prap nuk u pranuan. Për më tepër, njërën prej tyre e ktheva në *esse* në vit të dytë, gjimnaz dhe mësuesja deklaroi para klasës se *Andreasi nuk ka stil*!, ndaj më vuri tetë.

S'u zhgënjeva! Një vetëbesim idiot që do ta kërkoja vazhdimisht më pas më bëri të besoj se sikurse ajo e kishte gabim, edhe botuesit e kishin gabim. Pas tyre, sigurisht edhe pedagogët e letërsisë që më thonin mëso - e çfarë të mësoja, dallkaudllëqet e tyre! - dhe lëre letërsinë për më vonë se nuk hahet bukë me libra, kur një pjesë tyrja hanin bukë duke na shitur *dallkaudllëqet* si dispenca mësimore. Dhe shkrova e shkrova pa ndalur, i bindur se dikur do t'i botoja, por asnjëherë s'e kisha imagjinuar se 21 vjeç do të kisha një botues serioz, të vërtetë dhe unë, krejt i bjerrun, s'do të kisha diçka për të botuar!

Nejse, e thashë, më mirë të pyes se të përgjigjem, pasi vërej një sinqeritet për të cilin më vonë do të pendohem. Prandaj, më lejo të të bëj një tjetër pyetje.

Të jetosh në një vend me dy gjuhë zyrtare dhe t'i mësosh e flasësh të dyja njëkohësisht, qysh në fëmijëri, ka ndikuar ndopak në poezinë tënde?

N. E.: Të jetuarit në një vend me dy gjuhë zyrtare (edhe pse gjuha shqipe shumë vonë llogaritet si e tillë) ka ndikuar në formësimin tonë si individë dhe si shoqëri në këtë anë të Maqedonisë, por e di

në cilin aspekt? Na ka bërë më të ndjeshëm në raportin e gjuhës që e flasim në shtëpi, pra të gjuhës shqipe, të trashëguar e të ruajtur nga të parët tanë. Përrallat dhe këngët e para m'u rrëfyen nga gjyshi, i cili e dinte dhe këndonte një version të legjendës së *Konstandinit dhe Doruntinës*, por të konvertuar në një titull tjetër. Ai dhe gjenerata e tij, i thoshin *Motra me nëntë vëllazën*, ndryshe nuk e njihnin. Më vonë, në shkollë mësuam dhe për versionin tjetër të kësaj legjende, atëherë unë arrita të bëj lidhjen midis gjuhës që e flisnim dhe asaj që e dëgjonim në shkollë, gjë që pasoi pastaj me një kureshtje të shtuar për gjuhën dhe elementet e tjera. Prej atij çasti, që unë kuptova se përkas diku, vazhdon të më ndjekë po e njëjta ndjesi, që e gjithë lidhja jonë e këtushme dhe e atjeshme më duket e mrekullueshme. E di pse? Sepse, pavarësisht ndarjeve që kemi pësuar, pavarësisht se na është mohuar e drejta e shkollimit, ne kemi funksionuar dhe vazhdojmë të funksionojmë si një shpirt i vetëm. Folklori, tradita, letërsia aq pastër e trashëgojnë kujtesën tonë...

Dua të them, që gjuhën maqedone e kemi përdorur vetëm në anën praktike të gjërave, prandaj dhe nuk them dot që ka pasur ndonjë ndikim te krijimtaria ime. E në këtë vazhdë pyetjeje, po në krijimtarinë tënde a ka ndikuar ndonjë dyzim apo dallim?

A. D.: Shkodra është vend i çuditshëm, plot me dallime, nga më të voglat si për shembull radhitja e luleve në parvaz, deri te më të mëdhatë, përfshirë edhe mënyrën e të folurit. Unë thoja *Lulekrisht*, ndërsa shoqet e shokët e pallatit, *Lulesahat*; unë thoja *kotull* ndërsa ata *havër* e sa e sa të tjera si këto. Për të qartësuar veten në raport me to u shkrua edhe *Marrja e gjakut*, edhe pse idea lindi krejt tjetër kund. Por, më shumë se gjithçka, edhe pse jam rritur mes ndryshimeve, më bën përshtypje kur tani në Tiranë them *Të du fort!* dhe marr si përgjigje *Edhe unë të dua shum*ë! Kur thashë një natë se është hera e parë që dikush më thotë *Të dua!*, u krijua një situatë e këndshme dhe me humor: ngjante sikur po përjetoja të parën lidhje. Në këtë mënyrë sendërtohet letërsia ime, por nuk lind këtu e kështu. Ndërsa në rastin tënd, nuk e di, poezia brenda teje, si lind e mandej, në ç'shteg kalon për t'u konkretizuar? Çfarë mund të thuash për procesin tënd krijues?

N. E.: Procesi krijues. Është i magjishëm, i trazuar, i vërtetë, i egër, ngushëllues. i pranishëm në çdo veprim. Tani ditët lidhen me krijimin dhe vice versa. Poezia është gjithkund te secili prej nesh, është e lindur dhe e trashëguar bashkë me përjetimet e tjera që na bëhet se i kemi jetuar dikur. Është kjo shprehja e Cioran që çdo herë ma trondit fort qenien, thotë kështu: *Kur jemi me mijëra kilometra larg poezisë, ne akoma e përdorim atë, atëherë kur na vjen një dëshirë e papritur për të bërtitur - si faza e fundit e lirikës.* Poezia është është lum në të cilin ne pastrohemi. A e ke vënë re se sa të pastër janë gurët të cilët janë nën rrjedhë? Ashtu pastrohet dhe lahet shpirti me anë të artit. Poezia është proces që kërkon kohën, vetminë dhe kthjelltësinë e të jetuarit me të tashmen. E tashmja i ka të gjitha kohët brenda.

Me sa kam vënë re, nuk ke folur asnjëherë as ti për procesin tënd krijues. Jam vërtetë kureshtare të di ç'mund të thuash...

A. D.: Ndoshta sepse nuk kam çfarë të them, nuk e di. Rregulli dhe disiplina s'kanë asnjë lidhje as me procesin tim krijues, as me mua përtej punës. Kështu që, shkruaj pa asnjë kriter, darkave kryesisht dhe ndaloj veç kur më mbaron alkooli apo cigaret, çka kohët e fundit po ndodh shpesh. Ime ëmë më tha një mëngjes "Sa mirë që shkrun natën!" "E pse?" e pyeta. "Po të ishte ditën, kishe me ik e me ble prap cigare e alkool, kshu'që do të pishe ma shumë. Ndërsa naten, dyqanet janë mbyll!" S'e di nana që këtu në Tiranë, ngjitur me shtëpinë kam një *Tabacco Shop* hapur 24 orë! Por nuk është kaq e thjeshtë. Të rifutem edhe një herë, pasi të kthehem nga dyqani në hullinë krijuese nga ku me vështirësi dal, si prej një marrëdhënieje shumë të bukur që thjesht e ndjen, i ka ardhur çasti të marrë fund, të ndahesh për t'u takuar sërish, në rastin më të mirë të nesërmen. Dhe veç tash që e rilexoj përgjigjen, po vë re sa shumë mohime paskam bërë. Të lidhet kjo me faktin se vetë procesi krijues është një mohim i madh?!

Por të lutem, t'i rikthehemi poezisë tënde, të rikthehemi te ti. Sepse ka elementë dhe vargje që dua t'i diskutojmë bashkë, të ndalemi pak më gjatë.

Përmbledhja poetike *Vargmale nën dhé* (Onufri, 2020) *ndahet në diku midis reve qëndron një zog, një dimër dhe një mall për kthim, Koha para kujtimeve, Plakje pa stinë, Në ç'çast lind ai diell?, Zgjimi midis dekadash, Prekja për të kujtuar, Muzës së heshtur, Fundi s'njeh veten, Vargmale nën dhé* dhe *Histori për ardhmërinë.* A ka diçka që i bashkon të gjitha këto pjesë?

N. E.: Në lexim të parë, të gjithë këto ndarje duken shumë poetike, por përveç pjesës poetike, janë dhe shumë të përfytyrueshme për lexuesin. Ndarja e cikleve te *Vargmale nën dhé* është bërë si rrjedhojë e jetës sonë në përditshmëri, e udhëhequr nga ndjeshmëria dhe prekshmëria e shpirtit, e kohës dhe sidomos e natyrës. Kohë e cila krijohet nga elementet konkrete dhe abstrakte në të cilat qullet dhe kullohet jeta. Sigurisht përdorim gjithçka për të arritur atë formë që e dëshirojmë, sa më afër imazhit tonë për të përsosurën. Këto cikle ndahen midis kohës hapësinore dhe kohës biologjike të njeriut, por fillon e përmbysur. Është lindja e hënës. Çarja e errësirës, paralajmërimi për diçka të re, pritet dita e re, që është jeta e re. Dhe kështu përshkruhen dhe proceset e tjera. Poezia është thellimi brenda vetes. Sa më thellë vetes, aq më thellë tokës, aq më pranë qenies. Është procesi i krijimit të njeriut dhe gjithë përjetimet që lëmë këtu si një dëshmi për të ardhmen.

A. D.: Po për librin *Lëre dashurinë të vijë si të dojë* me të cilin u vlerësove nga *Qendra Kombëtare e Librit dhe e Leximit*, çfarë mund të thuash?

N. E.: Libri, *Lëre dashurinë të vijë si të dojë,* është gjithashtu përmbledhje poetike, i cili pati fatin të vlerësohet sipas motivacionit të jurisë për *theksin e fortë bashkëkohor, të përpunuar mbi parime të kthjellëta estetike, spontane në figuracion dhe e strukturuar qartë në narracionin e vet.* Janë poezi që janë krijuar në periudha të ndryshme të jetës sime dhe flënë shumë pranë shpirtit, shumë pranë ndjeshmërisë, mendoj se mbajnë të gjithë emocionin tim që kam dashur të përcjellë te lexuesi. Ndjenja pa të cilat nuk krijohet asnjë jetë, dhe që na duhen për të vazhduar të ëndërrojmë. Pavarësisht sa larg duam t'i ikim ndjeshmërisë njerëzore, me të gjithë këto shpikje të fundit njerëzore, me intelegjencën artificiale, nuk i ikim dot qenësores, nuk u ikim dot ëndërrimeve, qofshin ato edhe më qesharaket, përjetimit të ndjenjave, njohjes së sendeve më bazike njerëzore që janë thelbësore dhe themelore për vazhdimin dhe trashëgimin e jetës sonë. Do të parafrazoj një pjesë nga eseja e Virginia Woolf *Një dhomë më vete*, "…poetët e poezisë moderne shprehin ndjenja të cilat sapo krijohen edhe shuhen, prandaj dhe harrohen shumë shpejt poezitë të cilat lexohen në këtë kohë." Pra, poezitë moderne për dallim nga poezitë e kohës që i kanë folur njeriut për ndjenjat dhe realitetin me të cilin përballej ai. Për fat të mirë letërsia jonë ka pasur poetë të cilët qëndruan shumë pranë njeriut të tyre, mund të përmendim këtu: Migjenin, Nolin, Camajn, Rreshpjen... Pra, poeti nuk është "njeriu i përzgjedhur" që jeton midis qiellit dhe vështron teksa "njeriu vdekatar" lufton me jetën. Poeti është po ai njeriu i zakonshëm që nuk dallohet midis njerëzve të tjerë, që vuan dhe dashuron njësoj si ata dhe beson si ata, prandaj dhe i takon të flasë për veten e tij.

Po, poezia ime nuk dua të jetë e veshur dhe ajo do të qëndrojë pa "asnjë rrobë" përballë lexuesit, e thjeshtë, por sendet e thjeshta, madje dhe mënyra se si hamë bukën apo lëvizim këmbët nëpër rrugë, sjellin komplikimet më të mëdha te mendjes sonë.

A. D.: Cilat janë dy ose tri poezi të tij që mund t'i botojmë paraprakisht, si pjesë të kësaj interviste, për të grishur e ngacmuar lehtë lexuesin?

N. E.:

Lërë dashurinë

Lëre dashurinë të vijë si të dojë.
Si diçka që vjen.

Lëre dashurinë të ikë si të dojë.
Si diçka që ik.

Mos e shtyj kur s'ka çfarë të të thotë,
secilës kohë i duhet një tjetër prekje.

Lëre të të kundrojë pak më gjatë,
mos ia hiq duart nga koka jote.

Se dashuria vjen si të dojë,
se asaj gjithmonë i japin një adresë të gabuar.

Por ja që ajo vjen ashtu e hutuar,
si ai që çon lule në adresë të padëgjuar,
kushdo që i merr ato lule nuk kërkon llogari
sepse ti thjesht ke shkruar një pusullë:
"Më fal që kam munguar"

Këtu përket vetmia ime

Ja një vend pa të ardhme,
pa të ardhmen njerëzore,
atëherë, përse nuk e zëvendësojmë
kohën me një kohë tjetër,
të tjerë njerëz të pushtojnë vendin, të hanë bukën?
Po përse këta fërkojnë sytë,
dhe u vjen mërzi të përdorin gjuhën,
e ata që e përdorin shkatërrohen.
A nuk jetojmë në të shkuarën,
a nuk jetoj unë vetë atje?
A do ta dimë ndonjëherë përse
na pëlqen të duam çka kishim,
dhe çka kemi s'na bën përshtypje?
A nuk tregon historia për dikë si unë,
që Erdhi, Pa dhe Dashuroi?
Ç'dëshmi tjetër kemi të vdekatarëve,
ku do të përkasë ndjenja ime,
vetmia ime që unë e bart si lurek?

Sa male m'u deshën të kapërcej që të jem këtu,
në sa lumenj mbyta egon, hijet, trupin?
Kurrkund fytyra ime nuk gjeti një vend,
një vend perëndimesh të çlodhet shpirti im,
një fushë t'i mbjell gurët që m'i gjuajti jeta.
Ja, kjo mund të jetë gjeografia njerëzore.

Sa herë qava që s'kuptoja kush jam,
se ku jam as dija të pyes,
se as nuk gjeta dikë që t'i dëgjojë thirrjet e mia.
Sa herë i ika atdheut për t'u mbrojtur,
dhe sa herë marrëzisë i vendosa kufinj mendor…
Ja, kjo mund të jetë historia njerëzore.

Ç'punë na hynë faktet historike?
Faktet biologjike le të rrinë, që të duam veten.
Mirë e kishin fëmijët e mi,
ç'punë na hynë formulat kimike,
Ose format e pashtjelluara të foljes?
Përse nuk mësohemi të dimë
çfarë fshihet pas fjalës:
- mirë
Dhe çfarë pas fjalëve:
- nuk di.
- nuk mundem.
- harroje!
Sa herë shpeshtohen rrahjet e zemrës nga frika,
dhe a janë rrahjet e njëjta kur dashurohemi?
Ja, për këto gjëra do të ligjëroja.
Se unë do kisha dashur dikush të më mësonte,
sa isha pa gjeografi njerëzore,
sa isha pa histori njerëzore,
atëherë mbase do të mund të mbaja mend,
se tani pasi të gjitha i provova në lëkurë,
nuk ia vlen të flitet më.
Fërkoj sytë që t'i pushoj pak nga koha, e them:
- ja, një vend pa histori njerëzore,
- këtu është e rëndësishme të flitet
  për kohët e pashtjelluara të foljes.

Mbamendje

Lëngun e ditëve të mërzisë e pimë në gota uji.
Nuk zbrazet asnjëherë.
Jemi mësuar të themi: mjafton! pas dy-tri gllënjkave.

Pastaj hamë në tasa të krijuar për njerëz - verbuar me mungesa.
Luga fluturon sa në njërin skaj, në tjetrin.

Pas buke duhet të pimë barnat e harresës.

A. D.: Malli, humbja, vetmia… Tematikat e poezisë tënde, edhe kur janë të trishta, të japin mundësinë ta zbërthesh dhe kuptosh jetën, në secilin moment të saj. Për ty, a janë poezitë që shkruan copëza të një mozaiku që kur bashkohen, paraqesin brendinë e Nuries?

N. E.: Siç thotë Jorgos Seferis në veprën e tij *Monolog mbi poezinë dhe ese të tjera*, se "poeti nuk mund të ndahet hermetikisht nga personaliteti i tij, dhe funksionimin e poetit e ushqen një ecejake e pandërprerë midis unit të brendshëm dhe atij sipërfaqësor." Pra,vetmia është një ndjenjë universale, po e fus pa hezitim te ndjenjat, sepse është një dëshirë e pakontestueshme dhe një pajtim fati që e shoqëron njeriun e kohës sonë. Poezitë nuk janë vetëm përjetime personale, janë dhe përvoja, fenomene të ditëve të mia, të njerëzve të mi, në realitet e të gjithë njerëzimit. Këto ndjenja nuk janë shpikur sot. Vetmia është shoqëruese e njeriut, sado që secili e mbush atë hapësirë me veprime që ta mbajë sa më larg vetes.Ndjeshmëritë tona janë krijuar nga përvoja dhe shpesh janë dhe paralajmëruese të një përvoje që siguristh e mohojmë, siç janë: humbja, frika për të panjohurën, mosdija... Këtu po e kujtoj dhe Sabaton si cili te *Shkrimatri dhe fantazmat e tij* shprehet "Shkrimtarët e sotëm akuzohen për pesimizmin e tyre. Nuk kuptohet se janë pesimistë ngaqë janë plot besim, ngaqë janë idealistë. Për t'u akuzuar janë të tjerët, që bëjnë letërsi të lehtë: janë cinikë dhe skeptikë. Krejt e kundërta e pesimizmit."

Gjithsesi, duhet ta them se as ti nuk je ndonjë shkrimtar i tematikave të gëzimeve të mëdha...

A. D.: Po, ke të drejtë. Dostojevski thotë "Më jep një dhimbje, të të jap një kryevepër!" dhe ralisht, e kam menduar me veten se s'kam ç'i dua kryeveprat kur vinë si pasojë e dhimbjes. Pra, kam menduar më mirë mos të shkruaj sesa të vuaj për të shkruar.

Jam i sigurt se po të shkruaja gjëra që tejçojnë një *ndjesi* pozitive, *vepra ime* do të ishte shumë më e hollë. Pastaj ndoshta, meqë librat të cilët e kanë përshkuar me gjithë forcën e tyre qenien time janë *Krim dhe Ndëshkim*, *I huaji*, *Lehtësia e padurueshme e qenies*, *100 vjet vetmi, Portreti i artistit në rini, Pallati i* Ëndrrave e pak të tjerë, historitë e gëzuara i kisha zët qysh në krye të herës. Nuk janë të rrallë as skandalet e krijuara në promovime, për të cilët nuk jam **aspak** krenar, kur kam thënë fjalë nga më të papërshtatshmet pasi autori e kryesisht autorja deklaronte se qe frymëzuar nga Daniel Steel apo Nicola Sparks.

Por, gjithsesi, rikthehemi sërish te ti, te vargjet tuaja.

poeti nuk sheh nga e ardhmja,/ bëhet bishë e egër për hir të së shkuarës/ prandaj, hapë sytë dhe si panter i zi i kacavirret kohës shkruan ti në poezinë *Fati i Poetit*. Si shkrimtar, herë pas here mendoj me vete mos ndoshta do të kishte qenë shumë më mirë të mos isha i tillë, për të qenë normal në raport me gjërat që më rrethojnë, për të mos parë *Nëpër shirat e vdekur peshqit fluturonin drejt/ Çerdheve, te yjet.*, sikurse shkruan Rreshpja. E mendon ndonjëherë me veten se *fati i poetit* apo i artistit në përgjithësi nuk është ndonjë fat edhe aq i mirë?

N. E.: Secili nga ne mendon se një tjetër botë do të ishte më e mirë, se një vend tjetër do të ishte më i mirë, se një dashuri tjetër do të ishte më e mirë… mund të aludojmë pafund me këto zgjedhje të cilat e dimë se nuk i ndryshojmë më, por kur vjen puna te mënyra e jetesës, saktësisht te zgjedhja e fatit... historia ka shënuar shumë dëshmi në kalendarin e saj, shumë fakte dhe shumë fatkeqësi që përcjellin jetën e shkrimtarit. Se përse gjithmonë shkrimtarin e ka përndjekur një fat i tillë, aty kanë ndikuar shumë faktorë, të cilët gjithmonë rrinë në hije. Mendoj se artisti ka vetëm një përparësi në fatin e fatkeqësisë së tij krahasuar me të tjerët, e gëzon të drejtën e përjetësimit.

A. D.: *Jam e shuar; jam njeriu - fëmijë; jam pemë; jam asgjë…* Në shumë poezi tregon pikërisht gjendjen e *unit lirik*, duke përdorur foljen *jam*. Mes tyre, dalloj *Vajzës që i kërkohej të rritej*, për shembull. Pse? Pse kaq shumë gjendje?

N. E.: Vetë jeta është gjendje e lëngshme, e rrëshqitshme. Vetë njeriu është i tillë, një fëmijë që kërkon të mësohet, të rritet. Unë jam *ti* dhe unë jam *ne*. Dhe ndërsa koha kalon, ai asnjëherë nuk është i sigurt nëse ajo është rritja për të cilën të gjithë flasin. Rritja nuk është gjë tjetër, përveçse përshtatje. Përshtatjet në jetë, herë - herë vijnë natyrshëm, herë janë të dhimbshme. Dhe mu aty në dhimbje ndodh krijimi i një gjendjeje, e cila ose kalon pa u vënë re, ose rri gjithmonë e paprekshme dhe gjithë jeta jonë rrotullohet rreth atij çasti, që herë duket se ka ndodhur në ne, herë duket e largët dhe jashtë nesh.

A. D.: *Kërkoj gjithkund për një njeri,/ Jo më të mirë se vetja,/ As ndryshe,/ Dhe takoj çdo natë hijen time/ Varur nën degët e një lisi.* Si është të takohesh me veten?

N. E.: Tani që po u përgjigjem këtyre pyetjeve, po e vë re se sa shumë i kam theksuar fjalët *jetë* dhe *njeri*. Dy elemente kryesore të cilat në dhimbje bashkohen dhe në dhimbje ndahen. Sigurisht se jeta e njeriut përbëhet dhe përcaktohet nga vetëdija e tij personale, duke pasur përballë vetëdijen kolektive. Duhet të ekzistojë një pasqyrë ku të shohim veten. Nga këto përballje që shpesh përfundojnë në konflikte, njeriut i ndodh që në jetë të zgjohet disa herë. Aty ndodh dhe takimi me veten. Edhe pse shpesh tenton t'i ikë kësaj përballje dhe kërkon që t'i ngjajë dikujt tjetër, pa pranuar dhe pa njohur unin e tij fillimisht. Por, në momentin që ne e pranojmë

veçantinë tonë me të gjitha virtytet dhe boshllëqet që mund të kemi, ndalemi së kërkuari dhe admiruari tjetrin, që për fat të mirë kurrë s'mund t'i ngjajmë.

Po për ty Andreas, kur ka qenë takimi i parë me veten dhe si ke reaguar?

A. D.: Kjo është pyetja më e vështirë që mund të më bëje! Ndërkohë që e shtyj bisedën pasi s'di si t'i përgjigjem, ndjej se kryeredaktori e do materialin sepse po vonohet përgatitja e gazetës. Pikërisht këtij "presioni" dua t'ja mvesh secilin boshllëk që kjo përgjigje mund të lërë.

Deri pak kohë më parë, kisha përshtypjen se veten e kisha takuar veç *të fragmentuar*, të ndarë në copa, asnjëherë të plotë. Por e gjitha ndryshoi kur mora si dhuratë një kopje të *Lehtësia e padurueshme e qenies*, të cilin kushedi sa herë e kam lexuar. Në faqen e parë, ishte një dedikim shkruar *Për Andrean, që e ka bërë lehtësisht të durueshme qenien time. Me shumë dashuri,* Ç'kisha bërë unë që të meritoja diçka të tillë? Në ç'mënyrë *e kam bërë lehtësisht të durueshme* gjënë më të padurueshme në botë për një njeri, *qenien e vet*? Dhe si ka mundësi që unë, i angazhuar seriozisht me letërsinë, të mos kisha lexuar diçka më të bukur se kjo?! Dreqi e mori, kush isha? Ku mund ta takoja veten?

U ktheva pas, hipur mbi një re të vogël, si ajo e Gokut te *Dragon Ball* (mjaft folëm vetëm për letërsi!) dhe pashë veten mbyllur brenda dy syve që po më shihnin. Sy të vegjël, të bukur, shumë të bukur! Krejt sinqerisht e them, i fola vetes. Përgjigjen e mora nga *e zonja e syve*. Aty, brenda syve të saj, te fjalët e saj e njoha veten, në gjithë plotninë që një qenie njerëzore mund të shfaqet. Asnjëherë s'do ja dal ta përshkruaj si duhet atë çast, e di, por ky qe takimi im i parë me veten.

Tani, sa herë të më marrë malli ta ritakoj Andreasin, takohem me atë, ndonëse për të më merr malli shumë më shumë se për vetveten!

Edhe xixëllonja e fundit/ Fiku dritën dhe u kthye në insekt të zakonshëm. Nuk kam pyetje, këto dy vargje thonë gjithçka e as nuk e di nëse ke diçka për të shtuar. Nëse jo, kalojmë te e radhës.

N. E.: Poetit nuk i ngelet asgjë pas kësaj.

A. D.: Nurie, duke parë volumin e librave të tu, kam përshtypjen se shkruan shumë. Po procesit të përzgjedhjes dhe të redaktimit, sa kohë i kushton?

N. E.: Kur e zbulova poezinë, shkruaja shumë. Faza kur shkruan gjithçka dhe befasohesh me çdo fjalë, është një filtër nëpër të cilin supozoj se çdo artist kalon në ato fillimet e tij, një lloj pastrimi derisa të arrijmë te kullimi i pastër i fjalës sonë. Sot, pasi krijimtaria ka kaluar nëpër shumë filtra dhe e kupton çfarë duhet të kishe botuar dhe çfarë duhej të mbahej veç për vete, ndjesia për të shkruar vazhdon të jetë njësoj... Pjesa e redaktimit është pjesë mjaft e rëndësishme në krijimtari, që duhet t'i kushtohet vëmendje. Unë i kushtoj aq kohë sa mendoj se është e nevojshme. Përzgjedhja pastaj është me e lehtë. Çdo krijues e ndjen se kur ka shkruar diçka të mirë, dhe kur ka shkruar një gjë që nuk është niveli që ai priret ta arrijë. Kështu, shkrimtari duhet të jetë kritiku i parë dhe më i afërt ndaj vetes.

A. D.: Përveçse poete, je edhe studiuese e së fundmi, ke përfunduar temën tënde rreth Kunderës. Këto dy realitete, e poetes dhe studiueses, si bashkëjetojnë në ty?

N. E.: Një poet nuk jeton dot pa lexim dhe pa muzikë të mirë (te muzika e mirë do të fus klasiken).

Është e jashtëzakonshme kjo që të pasurit shije për letërsi të njëjtë na ofron dhe krijon rrethe me të cilat ndan të njëjtat bindje, siç po na ndodh ne të dyve. Nëse për ty ka qenë një përballje a njohje me veten *Lehtësia e padurueshme e qenies*, per mua ishte *Shakaja*. Shakanë e lexova pa pasur asnjë informacion mbi atë vepër, vetëm Kunderën e kisha të dëgjuar se shkruan mirë. Nuk e dija që aq fuqishmë do të reagojë në thellësitë e mia. Sepse kur arrin nëj moshë, apo një lloj pjekurie dhe letrare, është pak e vështirë për të të bërë përshtypje letërisa që lexon. Dhe Kundera qe ai që më forcoi atë shije dhe më bindi për t'i shkuar pas letërsisë së mirë. Sigurisht se, leximi të mundëson në thellimin e mendimit dhe të studimit. Tema e ekzilit dhe identitetit lidhet kryesisht dhe me letërsinë tonë. Janë terme të cilët shoqërojnë njeriun e ditëve tona. Pra, krizat identitare, çfarë duhet të merret dhe çfarë duhet të shmanget nga vendi ku përket. A mund që njeriu të përshtatet krejtësisht në një vend ku shkon? Apo të jetë i pashkëputur nga e shkuara e tij, njeriu që përjeton ekzilin, një prej formave të shumta të ikjes. Por nuk është vetëm ikja nga vendi yt, është edhe ikja nga vetja një lloj proteste dhe ekzili i brendshëm që ekziston. Këto tema sociale dhe psikologjike që kanë në qendër njeriun, ngjallin kureshtje te unë si studiuese e letërsisë. E shikoj se studimet e mia kanë të bëjnë me ato tema të cilat unë i trajtoj gjithashtu nëpër poezi. Pra, e kanë gjetur mënyrën se si të bashkëjetojnë në mua, duke dhënë dhe marrë nga njëra - tjetra në të njëjtën kohë.

A.D.: Sapo u shpallën READ Residency Program dhe t'i ishe e përzgjedhur, si do të jetë procesi i gjithë kësaj?

N.E.: Po ka pak javë që u shpallën rezultatet e këtij projekti, që unë e quaj një përvojë mjaft të nevojshme për krijimtarinë time. Jam e perzgjedhur dhe po përfaqësoj Maqedoninë e Veriut në Turqi. Qëndrimi im atje do të jetë për një muaj. Një muaj i mbushur me takime dhe aktivitete që do të jenë të organizuara nga ana e tyre. Përveç këtyre pjesa kryesore është pjesa e shkrimit që sigurisht është pjesa kryesore.

A. D.: Po në prozë, e ke sprovuar veten ndonjëherë?

N. E.: Vazhdoj dhe provoj të shkruaj edhe në prozë, por nuk e di në është pikërisht tani ajo që dua të them përmes saj, prandaj e mbaj larg meje. Proza është krejtësisht e ndryshme nga poezia. Ka tjetër mënyrë se si përshkruan momentin dhe kërkon të tjera fjalë. Ndjesia është krejtësisht ndryshe, një realizëm magjik që jeton brenda meje dhe ngjallet pikërisht kur jam duke shkruar prozë. Prandaj po i jap kohë që të flejë në mua edhe pak, por që gjithsesi të shohim...

E ti në poezi, ke provuar ndonjëherë?

A. D.: Unë kam një libër me poezi, për fatin tim të mirë krejt të panjohur! Botuar në pak kopje, kur isha shtatëmbëdhjetë vjeç. Pas tij, kam botuar shumë rrallë poezi, aq sa mund të numërohen me gishtat e njërës dorë. Ndërsa tani, për t'ju rikthyer një pyetjeje të mëparshme, pasi takova veten në sytë e saj, po shkruaj shumë, vërtetë shumë, si asnjëherë. I mbaj me një fanatizëm e xhelozi të sëmurë, janë të miat, s'mund të jenë të dikujt tjetër (ose kështu justifikoj frikën mos nuk janë të mira sa duhet për t'u botuar!).

Dhe në mbyllje, një pyetje që mund të ishte edhe si fillim, kryesisht për ata të cilët artin e kanë mjet e jo qëllim, por meqë ne jemi ndryshe, e lëmë të fundit. Fakti që kritika është shprehur mirë për ty, madje edhe me entuziazëm, ka pasur ndonjë lloj ndikimi në ty, të të ndryshojë mënyrën se si e sheh poezinë apo edhe veten tënde?

N. E.: Mendoj se kritika gjithmonë ka qenë e rëndësishme për letërsinë, ne që e kemi studiuar këtë e dimë më mirë. Sigurisht se ajo i jep shumë peshë poezisë që udhëheq lexuesin dhe adhuruesin e fjalës drejt një vepre. Ka mjaft rëndësi kur vlerësimi vjen nga studiues dhe profesorë të cilët kanë një përvojë të gjatë në fushën e letërsisë. Pastaj, e gjithë kjo kërkon të kalojë nëpër një proces që quhet kohë. Letërsia nuk e ka asnjëherë ndjenjën e entuziazmit, përveç në momentin e krijimit. Koha është treguesi më i mirë ndaj çdo arti. Por, poezia për mua gjithmonë mbetet njësoj, siç e kam parë dhe ndjerë që në ditën e parë, si diçka që është krejtësisht e brendshme, si një mekanizëm për të shpëtuar, si një lloj gjetjeje e paqes brenda vetes, si një lloj lirizmi, si një ikje e realitetit, apo ngushëllim i ngjarjeve që nuk zhbëhen, si një lutje në të cilën besoj...

"RRAKULLIMA" E BEQIR MUSLIUT, DRAMATIKA HERMETIKE E MBITEKSTIT

Nga Behar Gjoka



Në këtë libër, të rrallë për nga vlerat letrare, ku janë përfshirë katër tekste dramatike, përkatësisht: Murana, Kori i Korbave, Familja e Shenjtë dhe Antifona, pra duke u nisur kështu vetëm prej dheut të vendlindjes, Gjilanit, shkrimtari Beqir Musliu, prej Makondës reale, duket se ka sendërtuar një Makondë Letrare, që këtu na prezantohet në Magnus Libris, të ngjashme dhe të ndryshme, porse tejet të bukur si vatër e frymimit artistik vetanak. Tekstet dramatike/tragjike, përçojnë veçmas tjerash, një ndjesi terri të thellë dhe si prani mbizotëruese, mbase tashmë edhe si të hijezuar, që i jep dramatikës së autorit një përndritje të veçantë dhe të pakrahasueshme në letrat shqipe.

ERRËSIRA SI FRYMË

Rrokja e saj është krejt e mundshme në të gjithë krijimtarinë e Musliut, në peozi dhe prozë, veçse në shkrimin dramatik, ajo na del e prekshme dhe fuqiplote në të katër tekstet, e paraqitura në këtë libër, madje na shpërfaqet edhe me nuanca më të forta:

- Si prani e fuqishme e frymës erratake, ku në fakt përzihen edhe hijedritat e ferrit – purgatorit - parajsës, pra të secilës pjesë të tetraptikut (kuartetit) dramatik, nga më të thekurit si poetikë e shkrimit të saj.

- Si një rrezatim krejt i pazakontë, i beftë dhe çudibërës, letrar dhe gjuhësor, i mbijetesës së qenies, sidomos të përfshirë nën kthetrat e fatit, tmerrësisht të zi.

- Si një frymim, etik dhe estetik, human dhe më përtej tij, për të shpaluar ankthin dhe tmerrin, kryesisht përmes ligjësive të artit të fjalës.

- Si një sprovë e përfunduar, e hartimit dhe materializmit, të dramatikës së mëvetësishme dhe hermetike, të autorit më një errësi të përveçme.

Terri, pra kuptohet se është fjala për errësirën e skajshme, mbase më tepër se sa çështje fryme dhe atmosfere mbizotëruese, në veprën e gjerë dhe përplot laryshi shkrimore të Beqir Musliut, shpërndërrohet këtu plotësisht, madje organikisht në vetë fatin e artit, si magji shkrimi, ka gjasa edhe si një mantel i ndriçimit erratak, të menduar dhe të endur qëllimisht kështu, si një qark i mbyllur, ku frymon jeta dhe matanëjeta.



RRETHI VICIOZ I QENIES

Jeta dhe vdekja, pamëdyshje dy bashkudhëtar të ekzistencës së vetë qenies, veçmas në hapësirat tekstologjike të librit Rrakullima, përgjithësisht ecin përkrah, ndonëse nganjëherë lëvizin edhe në kahje të ndryshme:

- Ecin paralelisht, madje si dy prani të pandashme, duke krijuar kështu edhe një shans të qartë të kundrimit të tyre, pra të jetës dhe amshimit, mbase edhe si thelb dhe tipare përfaqësimi.

- Ecin përkundruall, pra gati – gati, si në një shesh beteje, ku nga çasti në çast, edhe mundet të nisë dyluftimi i ashpër, për jetë a vdekje.

- Ecin, po ashtu me turravrapin e tmerrit dhe lebetisë, duke ikur kështu prej shoqja – shoqes, pushtuar më tepër nga angështia e mosqenies.

Një shtysë e fortë, teorike dhe letrare, për të prekur praninë e këtyre shenjave ekzistenciale të qenies, ka qenë edhe sugjerimi i studiuesit Nehas Sopaj, kur shprehet: Dramat e B. Musliut janë ndërtuar si një rrëfim i vetëm dhe i gjatë me tetë shkëputje të titulluara, një rrëfim – udhëtim mes jetës dhe vdekjes në të cilin lexuesi mbetet i befasuar me saktësinë matematikore të të vërtetave në gjeneralitet, të vërtetave të realitetit objektiv. Jeta dhe matanë jeta, madje kjo e dyta, është diçka më e theksuar në hapësirat tekstologjike, të dramatikës hermetike të autorit, pra dukshëm janë dy protagonistët thelbësor të saj.

SHKËRBIMI I PERSONAZHEVE

Stilema letrare, thënëse dhe artistike, formatuese dhe sendërgjuese, shpaluese dhe rrëfimore, më e beftë dhe po kaq funksionale, e teksteve dramatike të librit, është shkërbimi i vazhdueshëm dhe krejt organik, i personazheve të dramave, domethënë shndërrimi i tyre në njëri - tjetrin, si dhe po ashtu edhe anasjelltas. Shpërndërrimi i vazhdueshëm, ngjet:

- Tek Murana, sidomos me dy Haxhinjtë në dy sfinga, pastaj në Harut dhe Marut, në dy hije, në treshenë, Mjekërrkuqi, Vetullkërleshuri, Sykapsallituri e pambarimisht kështu.



- Ndërsa tek Kori i Korbave, ku përveç dy Haxhinjëve, që shpërndërrohen në Fatamorganë dhe Iblis Keqa, në skenë futet Ademi dhe Kipci, pra përsëdytësi i tij, për të ardhur tek historia e Havës me Ademi, që bart në fakt fatin biblik dhe jetësor, si dhe të fëmijëve të tyre, pra të Kabilit dhe Habilit, Vedia dhe Demimja.

- Në tekstin Familja e Shenjtë, një nga pjesët më tronditëse dhe më të skalituara, si skena tragjike dhe dialogim, sërish kemi praninë e të dy Haxhinjëve, po ashtu edhe të familjes së Ademit, por edhe të Qoftëlargut, e ku ky i fundit shpërndërrohet krejt natyrshëm, në secilin personazh, por mbase këtu, veçmas të tjerash, mbizotëruese është skena e gjeredekut, si një akt i shpërndarjes dhe ruatjes së farës së fisit.

- Në tekstin Antifona, që shënon të mbramin tekst të Rrakullimës, ku tashmë rishfaqen në skenë të gjithë personazhet e të gjitha pjesëve të këtij librit, tronditës dhe hermetik, madje edhe në një dyzim kundërvënës dhe të jashtëzakonshëm ndërmjet vedit.

BOTA E TREFISHTË

Tekstet dramatike të këtij libri, pamëdyshje që të katër pjesët dramatike, veçmas dhe bashkarisht, sugjerojnë dhe sendërtojnë një botë të trefishtë, e cila në fakt përbëhet:

A – Ferri/xhehenemi, nën dhe mbitokësor, i pranishëm dhe funksional, pothuajse nëpër të gjitha hapësirat e tekstit, si mëkat dhe madje edhe si mëkatim tërësor.

B – Purgatori ose mali i vuajtjeve të panumurta, padyshim i të gjithë protagonistëve, si një akt që krijon gjasat e plotësimit të kushteve për vajtjen e merituar deri në parajsë.

C – Parajsa/xheneti, që në të gjithë tekstet e dramave/tragjedive, që vetëmse përmendet se sa preket, duke mbetur kështu, mbase më tepër një ëndërr krejt e pamundur.

Trefishësia e botës, letrare dhe mentale, pra si Ferr, Purgator dhe Parajsë, që në fakt është sendërtuar më parë dhe madje mrekullisht nga Dante Aligeri, me ndarje të shumta në rrathë dhe në një formë letrare të papërsëdytshme, si dhe të pagjashme për t'u kryer më si e tillë. Prania e konceptit të botës së trefishtë, në tekstet e Musliut, ka pësuar ndryshime të thella:

- Tek Rrakullima, duket tashmë, se më tepër kemi të bëjmë me një udhëtim imagjinar, si më thënë këtu na shpalohet një shtegtim ëndërror, pra që realisht nuk u krye kurrë.

- Pjesa e tretë e kësaj bote, në hapësirat e teksteve të këtyre dramave/tragjedive, pra Parajsa vetëm sa përmendet dhe shpalohet, kinse dhe më tepër si një imazh ëndërror.

- Fati i qenies njerëzore, në ekzsitencën dhe po ashtu edhe në mosqenien e vetë, në të gjithë tekstet e B. Musliut, është e bashkëlidhur me fatin e librit, pra të vetë artit të shkruar.

- Kemi të pranishme, madje të zhvilluara kaq gjerësisht, dy linja të njëkohshme, kërkimin dhe mohimin, qëmtimin dhe dyshimin, që më tepër të fanit fatin e doktor Faustit me Mefistofelin, të Gëtes.

Këto ndryshime, thelbësore dhe sendërtuese, të hermetikës dramatike të autorit, padyshim edhe të tjera shenja, të pranishme në hapësirat e teksteve të librit, të shpien natyrshëm edhe tek ngjizja e një tipologjie të përveçme shkrimore të Musliut.

Shkrim – mbi - shkrimi dramatic

Rrakullima, veçmas teksteve të tjera dramatike të shkrimtarit, duket se palimpsestin, pra shkrim – mbi -

(Vijon në faqen7)

DRAMATURGJIA E ETËHEM HAXHIADEMIT DHE SKENA E ASAJ KOHE

Nga Virion Graçi

Krijimtaria letrare Etëhem Haxhiademit, e dënuar me heshtje dhe ndëshkime të skajshme përgjatë gjysmës së dytë të shek.XX në Shqipëri, del e plotë në dritë për njohje dhe studim këto kohë. Etëhem Haxhiademi, edhe vetë personazh tragjik në historinë e Shqipërisë komuniste, i dënuar padrejtësisht, është dalluar në vitet tridhjetë mes krijuesëve, përkthyesëve dhe intelektualëve të tjerë. Ajo epokë e ka dashur E. Haxhiademin, ka mirëpritur punën e tij, ka pranuar me natyrshmëri personalitetin e tij, talentin, protagonizmin e tij si qytetar e si shkrimtar. Pajisur e formuar sa me kulturën klasike aq dhe me kulturën bashkëkohore-europiane, ai synoi të sjellë në shqip kryevepra nga fondi botëror i letërsisë, sikurse, nga ana tjetër, në harkun kohor të dhjetë viteve, afërsisht, shkroi e botoi një sërë veprash për skenë, tragjeditë mitologjike si "Ulisi", "Akili", "Diomedi", dhe ato me temë historike si: "Aleksandri", "Pirrua", "Skënderbeu," "Abeli."

Në vitet '30 Etëhem Haxhiademi është pranuar dhe përshëndetur nga autoritet letrare si autor i ri, me talent të veçantë, zë i përveçëm dhe i shquar, jo vetëm në brezin e tij. Vangjo Nirvana (Vangjel Koça) duke përcjellë me një analizë paraqitëse të karakterit psikologjiko-historik tragjeditë "Ulisi," "Akili", "Aleksandri" shprehet: "Këto janë të tri tragjeditë e para të Haxhiademit, që, me gjithë të metat e tyre – se dhe kryeveprat akoma kanë të meta, kanë cilësira që e nderojnë zotësinë dhe inspiratën e autorit të tyre, dhe janë një prodhim i vlyer në letteraturën e sotme të brezit të ri." Vlerësim më i lartë i bëhet autorit të ri E. Haxhiademi nga Gjergj Kuka, kur shprehet: "Në radhët krenare të shpatëtarëve të literaturës së re shqiptare, ai ecë me ball të lidhun me dafinat e nderit.. Shkrimtarë të tempramentit të Haxhiademit s'kanë nevojë për lëvdata mbassi e kanë fitue me mundime të vazhdueshme vendin e tyne në litteraturën Shqiptare."

Për shumë arsye, nga veprat e tij origjinale, ende sot, më e rëndësishme mbetet tragjedia "Skënderbeu". Botimi i tragjedisë "Skënderbeu" nga Shtëpija Botonjëse "Kristo Luarasi", Tiranë, 1935 ka qenë ngjarje e shënuar në jetën kulturore të kohës, është pritur me shkrime përshëndetëse nga intelektualë të dalluar si Branko Merxhani, Aleksandër Xhuvani, Behar Shtylla (me pseudonimin Bardhi Shtylla), Vangjel Koça (me pseudonimin Vangjo Nirvana), Jup Kastrati, etj.

Duke përkujtuar autorin, duke u përpjekur të gjejmë afërsisht vendin e tij në historinë e letërsisë sonë, etiketimi i parë që të shkon në mend është ai që vetë autori do ta kishte ëndërruar, "themelues i tragjedisë shqipe". Dhe, siç do ta shohim më tej, në atë periudhë, është ndier nevoja për ta pasur një theatër kombëtar, në dobi të edukimit qytetar, estetik dhe atdhetar të njerëzve të zakonshëm. Në historinë e dramaturgjisë shqiptare këtë vend, "themelonjës i tragjedisë shqipe" Haxhiademi e ka merituar. Por, parimisht, nga dramaturgjia e shkruar - te historia e teatrit si histori repertori teatror, si kategori historike, si fenomen social- kulturor - shumatore shfaqesh të suksesshme dhe rikonfirmimesh përtëritëse të pjesëve teatrore nga njëri brez në tjetrin, rruga është e gjatë dhe misioni mbetet pa provuar dhe i papërmbushur, fatkeqësisht. Në këtë rrafsh, pra, një trashëgimi teatrore si lëndë e parë e objekt pune kryesisht për studiuesit, për historianët e letërsisë dhe të gjuhës shqipe, prurjet prej debutuesi në një zhanër autoritar si tragjedia, institucion shpirtëror e moral për më tepër se dymijë e pesëqind vjetë në jetën e popujve të mesdheut, mund të arsyetohen e të pranohen relativisht, brenda sistemit letrar shqiptar të asaj kohe. Nëse shohim përqark aso kohe, kemi teatrin e Luixhi Pirandelos, pjesët për teatër të Zhan Pol Sartre, teatrin e Bertold Breht, e disa autorëve të tjerë, me gjasë, të njohur edhe nga autori ynë i mirë shkolluar, E. Haxhiademi. Prandaj, sot e vendosim në kontekstin përkatës tragjediografinë e tij, rëndësinë e saj, si meritë e autorit Haxhiademi, dhe kufizimet – si kufizime vendimtare të traditës si mungesë dhe të horizontit pritës.

Le të kthehemi në vitet '30-të. Vedad Kokona te Revista Letrare, Tiranë, 1944, nr, 4, në shkrimin "Theatri dhe ne" shprehet: "Në një vend ku përqindja e analfabetizmës ndodhet në një shkallë t'atillë sa njeriut i vjen me të vërtetë keq, ku turma e verbër ngryset e gëdhihet përpara tavllës apo xholit duke pirë duhan e duke zënë njëri tjetrin në gojë ose ku edhe ata që dinë këndim e shkrim nuk të zënë kurrë një libër me dorë, theatri duhet të lozë kryesor në edukimin e popullit; të jetë një shkollë e vërtetë ku, hërë pas here, edhe ay më i humburi që rron në llomin e jetës, të ketë mundësinë të jetojnë në një atmosferë fisnike dhe qytetëronjëse. Mjerisht ndër ne, edhe pikërisht ndër ne ku ndjehej nevoja më shumë se në çdo vend tjetër, theatric nuk e ka lozur këtë rol me rëndësi dhe ka mbetur dhe sot e kësaj dite, në mes të shekullit të njëzet dhe në një vend që është një urë mes Lindjes e Perëndimit – ka mbetur, themi, në fazë aq embryonale aq sa, mund të thuhet pa pikë hezitimi, se në lëmin theatror asnjë tentativë serioze nuk është bërë në vëndin t'onë."

Tjetër intelektual i asaj kohe, Muhamet Bala, te "Kultura Islame", Tiranë, 1942, nr.5-6-7 në shkrimin "A kemi nji dram modern shqiptar?" shprehet: "Pse popull i vogël e gadi gjithmonë nën zgjedhë të huej, pse përherë i nëpërkamun prej amnikut të pashpirt e gjakpirës, Shqipnija, s'pat rase me njoftë mirë e me hye për palc, deri vonë, jetës mendimtare e hartistike të huej: Ky asht zakonisht fati i të gjithë kombeve të vogjël." Po aty, "Ndijësija e Bukuria kanë nisë me u përvetësue mjaft prej nesh. Na kemi një epikë. Kemi një folklorë. Lirika vazhdon gjithnjë tue u mprehë e tua u hollue sa ma tepër. Novella s'na mungon, madje një novelë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Romanxi vazhdon me u zhvillue me hapa të shpejtë. E dramatikja? Dramatika ka mbetë me gjith se populli asht i ethshëm për theatro. Shpesh dëgjoj zane si: "Jemi lodhë ma prej dramave historike.. Mjaft me drama me shtjellime të kalueme... Kur do të shohim ma nji dramë të kohës?..dramë e kohës, me sensibilitete të ditës, personazhe me petka qytetare.."

Fiqret Fterra, te gazeta "Shkëndija", Tiranë, 1943, në rubrikën "Për një ritrajtim theatror", shprehet: "Për popullin t'onë vlera e theatrit, nuk do të kufizohet vetëm si qendër edukimi por do të ndreqi një urë të fortë, e cila do të lidhi kulturën me turmat....(shkurt - vg) Në këto dhjet vjetët e fundit, theatri ynë a ka bërë ndonjë përparim? Po t'a shqyrtojmë, në bazë të numrit të çfaqeve, në vend përparuar jemi në dekadencë. Të gjithë mbajnë mënd pa a shumë se përpara pak vjetëve, në Shkodër, Korçë, Tiranë ndihej një etje dhe vlim për theatër, dhe çfaqet ndonëse me shumë të meta artistike prapë ishin të shpeshta ashtu edhe në Elbasan, Vlorë etj". Sa i përket repertorit të huaj, që mund e duhet të përmbushë nevojat estetike të çdo publiku, F. Fterra bën një vëzhgim interesant, një qortim me vend: "Kemi pasur rastin të shohim personazhët e komedive të Molier-it të mveshur me brekushe e me një tufë presh në duar; ose tjerë auktorë të huaj, të përmëndur, personazhët e të cilëve, dilnin në skenë me këmisha nate (një lloj pizhame) e me faqore të rakisë nëpër duar, duke u unjur këmbëkryq mbi rrogozë."

Në një mjedis të tillë mungesash e nevojash të jashtëzakonëshme kanë ardhur tragjeditë e E. Haxhiademit. Duke lexuar me kritere të zhanrit "Skënderbeun" e tij, mund të themi se jemi larg zhanrit; jemi në zhanër sa i përket anës formale, mënyrës së rrëfimit, organizmit të lëndës në akte, në skena, zbulesës së personazhve nëpërmjet dialogimit, trialogimit, jemi në zhanër edhe sa i përket fundit me vrasje a vetvrasje personazhi; kurse pjesa përmbajtësore, konflikti



i madh ideor e botëkuptimor i përfaqësuar nga të paktën dy protagonistë, nga dy autoritete rivalizuese në planin etik – nuk e ka intesitetin dhe subilimim e domosdoshëm; idealet e reja, kumtuar nga heroi i cili sakrifikohet me vetëdje për t'i mbrojtur e afirmuar ato nëpërmjet flijimit të tij heroik, janë jehona faktesh dhe hamendësimesh, por jo vetëdije e re ekzistenciale që kërkon e meriton të fitojë të drejtën e qytetarisë. Nisur nga numëri jo dhe aq i bollshëm i tragjedive në tradiën botërore të teatrit, parë me kriteret e nënkuptuara dhe funksionet e tragjedisë si zhanër, nga "Poetika" e Aristotelit e këndej, do të kishim tragjedi, katharsis, nëse Skënderbeu ose një i ngjashëm i tij do të humbiste jetën duke i artikuluar e mbrojtur deri në flijim idealet e veta, përkundër forcave rivale, madhore, etj. Parë edhe me sytë spektatorit të teatrit klasicist, me të cilin e kanë njësuar dramaturgjinë e Etëhem Haxhiademit bashkëkohësit diturakë si Branko Merxhani me të tjerë, do të zbulonim largime edhe nga ajo paradigmë teatrore. Dhe, nuk janë nga ato largime krijuese-novatore që e pasurojnë zhanrin, i sjellin risi, i sjellin zbulesa domethenëse brendish njerëzore dhe - galerisë së personazheve letrare i shtojnë tipa origjinalë, me domethënie të fuqishme social-filozofike e etike. Nga praktika e teatrit klasicist gjejmë të mishëruar vetëm vizatimin e personazheve bardh e zi, të pa ndryshueshëm në rrjedhë të ngjarjeve, si dhe përfundimet tepër të arsyeshme, tepër të arsyeshme për të qenë zgjidhje konfliktesh tragjike, që do të thotë, artificiale, *deux ex machine*. Por këto të fundit nuk numërohen si të arritura të atij teatri, përkundrazi. Veç pritshmërive të sipërcekura të pjesëve që janë titulluar tragjedi, është dhe një kriter thelbësor që e dallon tragjiken/dramatikën nga zhanret e tjera letrare: protagonistët veprojnë e nuk rrëfejnë. Ky raport, pra, midis veprimit të personazheve, si mjet afirmues i tyre dhe, nga ana tjetër, e rrëfimit për vetveten, është tregues që e cilëson veprën, e klasifikon atë.

Më shumë se tragjedi, "Skënderbeu" i Etëhem Haxhiademit është një eulogji e shquar për Heroin tonë Kombëtar. Autori dramtizon në mënyrë mjaft të thjeshtëzuar disa episode të diskutueshme që kanë lidhje me mënyrën e lidhjes së martesave dhe tradhëtitë e princërve/ushtarakëve madhorë të Arbërit, bashkëluftëtarë ose familjarë të Gjergj Kastriotit. Oborri mbretëror, Gjergj Kastrioti dhe shpura e tij janë maja e shoqërisë, dhe problemet, gjakimet e tyre vlejnë të mishërohen vetëm në zhanrin e lartë, që është tragjedia, sikurse E. Haxhiademi ka bërë. Po ashtu, gjuha e përdorur është në përshtatje me personazhet e sërës së lartë dhe me zhanrin: është gjuhë poetike, mbizotëron retorika, fjalori - i përzgjedhur me kujdes, dhe elokuenca në dialogim. Secila shprehje karakterizon madhështinë e Gjergj Kastriotit, urtësinë e tij, trimërinë e pa shoqe, shpirtgjerësinë, virtytet, rëndësinë si prijës kundër Turqisë, etj. Këto, e të tjera si këto, deklarohen/rrëfehen e nuk shfaqen, nuk vinë përmes veprimit dramatik. Konflikti ndjenjë-arsye nuk ndodh, nuk është në plan të parë sepse mbizotëron arsyeja dhe panegjirika. Nuk është hedhur në fushën e sprovës simboli, garantuesi dhe mishërimi më i lartë i cilësive njerëzore dhe shtetërore, Gjergj Kastrioti. Vend kryesor ka zënë sqarimi i lexuesit/publikut se Hamzai, Moisiu, Zanfina ishin të zemëruar me mbretin Skënderbe, por ishin të zemëruar për arsye meskine, karriere, lakmie apo nga ndjenja të tjera inferioriteti përballë Fatosit të Shqipërisë, mbretit të Shqipnisë. Pjesa është, mbi të gjitha, glorifikim i Skënderbeut dhe historisë së tij në sytë shqiptarëve të zakonshëm të viteve '30. Bie në sy përdorimi i thirrorëve: Mbret i Shqipnisë si dhe përsëritja e shpeshtë e fesë, nënvizimi se jemi tjetër fe me Turqit. Në fundin e arsyeshëm (sipas poetikës klasiciste të tragjedisë) kemi Skënderbeun:

SKËNDERBEU

Si don qi t'jet tradhtija e 'tij mbaroi, /Porse tradhëtia e Hamzait filloi. /Filluëm të msohem na me pun' t'këqija. /Dhe si po shoh e mjer' do t'jet' Shqipnija. /Por un deri sa t'rroj nuk do t'kursehem. /Për t'mbrojtur tokën t'ime qi ushqehem. /Barbarit të tërbuëm sa të jem gjallë /Do t'i vërsulem rreptësisht me pallë /Dhe gjak' i im bregoret do t'i lajë /Qi t'rroj Shqipnija, dhe flamur' i sajë!

Me "Skënderbeun" e E. Haxhiademit jemi përsëri në frymën e epikës-romantike rilindase, krahas emrave të mëdhej si Jeronim de Rada, Naim Frashëri, krijimtaria e të cilëve, më së pari, kur lëvronte këto subjekte kishte pathos edukativ-atdhetar. Ja si e fillon Naim Frashëri gati gjysmë shekulli përpara Haxhiademit, "Histori e Skëndedrbeut":

Këndo, ëngjëll, urtësinë /Edhe gjithë mirësitë, /Skënderben' e trimërinë, /Q'i dha Shqipërisë dritë. /Të lumtë goja, këndona, /Me gjuhë të ëmbël si mjaltë, /Skënderben'e madh tregona / Trimnë burrë, Zotn' e naltë. /Punëtë që ka punuar /Kordhëtari i vërtetë /Kombin duke nderuar /Dhe Shqipërinë përjetë.

Ngjashmëria mes vargjeve të mësipërme të Naimit dhe vargjeve të marra nga E. Haxhiademi, është simetrike.



Haxhiademi ka përkthyer në gjuhën specifike të një zhanri tjetër të njëjtin imazh, të njëjtën frymë. Dhe kjo është vlerë e çmueshme e tij. Karakteri agjitativ, didaktika patriotike në dramën shqipe të gjysmës së parë të shek. XX, dëshmuar mjaft te 'autori ynë,' është i kuptueshëm dhe i pa shmangshëm, ndonëse, në gjini të tjera letrare, tregim, novelë, poezi, kapërcimi në fushën e artit të kulluar, kishte ndodhur në emrat më përfaqësues, në veprat më përfaqësuese.

Si përfundim, nëpërmjet "Skënderbeut" dhe veprave të tjera të tij, Etëhem Haxhiademi zë një vend nderi në plejadën e v.'30 të shek.XX. Duke njohur vështirësitë, përpjekjet dhe prurjet intelektuale të asaj periudhe, ideologët dhe mendimtarët e shquar shqiptarë të të gjithë drejtimeve politike që po përpiqeshin për një ideologji kombëtare, për një neoshqiptarizmë, për një orientim perëndimor të shoqërisë dhe vendit tonë, për përparim kulturor e ekonomik, për emancipim botëkuptimor, qytetar e estetik, gjejmë se E. Haxhiademi, sikurse para tij Naimi, Konica, Noli, Fishta e të tjerë, e ka bërë muzën krijuese dhe bagazhin e tij artistik, më së pari shkollë edukimi, forum predikues, forcë morale për të ndjerë krenaritë e trashëguara dhe për të marrë përgjegjësitë e duhura.

(Vijon nga faqja5)

shkrimin, e ka jo vetëm bazamentin mbi të cilën ka ngritur ngrehinën e vetë dramatike, ka më shumë gjasa të jetë mirëfilli tragjike, por edhe vetë tharmin unik të poetikës dhe estetikës së tij. Prania e disa shenjave të prekshme:

- Të frymës dhe teksteve të Biblës dhe Kuranit, në fakt i bëjnë ato materien parake, mbi të cilat ka marrë shtysa autori, për të sendërgjuar tekstet e të gjithë librit.
- Bota e trefishtë, pra e vizionit të Ferrit, Purgatorit dhe Parajsës, të çon menjëherë tek një situatë paratekstuale e Komedisë Hyjnore të Dantes, si frymë e qenies.
- Paratekstet, tashmë autoriale, në fillesë të secilit tekst dramatik, po ashtu edhe diku më në brendësi, të pasuara edhe nga shpërndërrime të pafundme të gjendjeve të personazheve, e zgjerojnë ndjeshëm gamën e pranisë dhe të rolit të palimpsestit.

Shkrim – mbi - shkrimi, ndërkaq bart edhe disa tipare të dyfishta, pra të një procesi zbulues, si dhe të një akti krijues estetik të mirëfilltë. Procesi zbulues, pra i shkrimësisë letrare, lidhet me heqjen e njollave dhe të pluhurit të pranishëm, si dhe tashmë edhe me sjelljen në dritë, të disa shenjave që njerëzimi, gati qe bindur se ishin zhdukur. Puna e thelluar dhe e domosdoshme, për të kryerë procesin zbulues, nxorri në pah edhe një moment tjetër çudibërës, të përplasjes së ngjyrave, të shkronjave dhe fjalëve të ndryshme, e prej saj, krejt vetiu edhe (si një qëmtim i vazhdueshëm) përlindi kështu edhe estetika e palimpsestit, pra e shkrim – mbi - shkrimit, që dihet se ka për at Borgesin.

TIPOLOGJIA E TRAGJEDISË MODERNE

Tekstet dramatike, të librit Rrakullima, padyshim që të katër veprat dramatike, gjer më tash, janë lexuar dhe emërtuar në një larmi formash. Ideja e N. Sopajt, kur shkruan: Ngjashëm si edhe te poezitë dhe romanet, dramat e B. Musliut parashtrojnë pyetjen e llojit letrar, zhanrin e veçantë dramaturgjik që kultivon autori për shkak të veçantisë së shkrimit të tij. Tipologjia e përcaktimit të këtyre, shtjellimeve dhe përcaktimeve, endet nëpër këto gjasa:

- Shkrimi dramatik modern, çka materializohet në skenat e shumta dhe të ndryshme, veprimet dhe në dialogun e pranishëm.
- Shkrim dramatik i antidramës, pra i një tip tjetër shkrimor, kahasuar me dramaturgjinë klasike.
- Shkrimi dramatik automatik, që ndërron kahje të paraqitjes së vetë orë e cast, porse e shoqëruar edhe më një nuancë të shkrimit sinkretik letrar, pra të ndërthurjes së poetikave shkrimore gjithgjinore.
- Shkrimi dramatik i natyrës së tragjedisë, ku Rrakullima, përbëhet nga katër drama: Murana, Kori i korbave, Familja e Shenjtë dhe Antifona.
- Tragjedi moderne, një tip shkrimi, që do ta hasim si natyrë dhe formatim edhe tek dramatika e Anton Pashkut, me dy tekstet, Gof dhe Sinkopa, të cilat edhe i ka emërtuar si të tilla.

Duke qenë se sa i përket tipologjisë së llojit letrar dramatik, mbroj hipotezën se i përket, më tepër se të tjerave, natyrës së tragjedisë moderne, atëhermë do të duhen qëmtuar dhe theksuar argumentat mbi të:

- Fundi tragjik, i një humbje të shumëfishtë të familjes së shenjtë, që e shpie vetvetiu tek ngjyresat e një tragjedie të mirëfilltë.
- Befasia e fundit tragjik, që vejn krejt panatyrshëm si rrjedhë logjike -klasike, porse që na shaploset krejtësisht organike, në rrjedhë të lëvrimit modern të shkrimit letrar.
- Prania e shenjave të paratekstit, të intertekstit, pra të natyrës së shkrimit letrar, si palimpsest ose shkrim – mbi - shkrim, e rrëshqet dramatikën e tij, përfundimisht dhe më tepër në tipologjinë shkrimore të tragjedisë moderne.

PËRFUNDIME

Shenjat e mësipërme, të frymës së errtë, të një rrethi vicioz ku gjallon qenie, të dyzimit dhe shpërfytyrimit të personazheve, po ashtu të sendërgjimit të botës së trefishtë, të pranisë së palimpsestit dhe të sendërtimit të tragjedisë moderne, burojnë vetëmse nga leximi, i vëmendshëm i teksteve dramatike të shkrimtarit. Druajse, në procesin e rileximit të Rrakullimës dhe të çdo teksti të B. Musliut, shumë prej këtyre qasjeve, ka gjasa që të vihen në dyshim, e madje edhe të përlinden të tjera, sepse tekstet e Musliut, bartin shumëkuptimësi, shumështresime dhe shumëngjyrësi letrare, çka mendimin përmbi shkrimtarinë e tij e vë në zgrip të përcaktimeve të fundme.

In memoriam Uran Kostreci

POETI QË RINGJALLI SONETIN

Enver Kushi



Këto ditë ndërroi jetë Uran Kostreci, poeti i mirënjohur dhe një nga njerëzit më të mirë që kam njohur. Uran Kostreci i përket atij brezi poetësh që regjimi diktatorial kërkoi t'ua mbyllë gojën, t'u prangosë shpirtin dhe poezinë. Ai i provoi të gjitha: edhe burgun, edhe torturat në hetuesi, edhe internimin, edhe vetminë e skajshme. Uran Kostreci asnjëherë nuk e uli kokën. Në përfytyrimin tim ai mbetet poeti dhe njeriu me personalitet dhe karakter të spikatur. Deri në fund e ruajti si gjënë më të shtrenjtë dinjitetin. Ai iku nga kjo jetë jo i vetmuar, ndonëse jetonte vetëm. Ai në çdo orë të ditës rrethohej nga miq të shumtë: intelektualë, poetë, shkrimtarë, piktorë, kompozitorë, miq të dikurshëm të burgjeve komuniste..etj. Sa herë që i telefonoja, më thonte se më priste tek "Piazza". Dhe kur hyja ne lokalin e madh, e gjeja vazhdimisht me miq të shumtë.

Shkrimi që po publikoj si "In memoriam" është shkruar shumë vite më parë. Le të jetë ky shkrim homazh për njeriun dhe poetin e veçantë Uran Kostreci.

PËR VITET SHKUAR DËM TË DJALËRISË…

Elegant, veshur me kostum ngjyrë të errët dhe borselinë të zezë, me një pamje ku vitet dhe koha duken si të ngrira ose më saktë, në një moshë të papërcaktuar, i çiltër, me humor e i këndshëm në bisedë, gjithmonë në lëvizje, mik i pandarë dhe besnik i cigares e i sonetit – ky është portreti i poetit Uran Kostreci.

Jeta e tij para viteve nëntëdhjetë, ka qënë një kalvar i vërtetë vuajtjesh. Në moshën 23 vjeçare, kur kishte shkruar poezitë e para dhe ëndërronte të bëhej poet, arrestohet. Përfytyroni: një djalë të ri delikat, të ndjeshëm e romantik, që flinte me poezitë e Naimit e Petrarkës nën jastëk, të mbyllet në muret e qelisë… Dhe jo pak , por 20 vite. E megjithatë, siç shkruan ai në sonetin "Pendës":

S'më la në baltë! N'atë burg mizor,
Me pendë e sfidova tiraninë
Midis betonit akull në dhjetor…

Në vitin 1981 del nga burgu. Ndjehen në portretin e tij 20 vitet e humbura, dhimbja për miqtë që ka lënë në qeli, për vatrën e rrënuar të shtëpisë dhe "vitet dëm të djalërisë…" Ata që e kanë njohur nga afër në ato vite, me siguri kanë dalluar tek Uran Kostreci të pacënuar shpirtin e lirë, romantik, rebel. Edhe kur punoi punëtor krahu, edhe kur për pesë vite të tjera u internua në një fshat të humbur të rrethinave të Peqinit, ku banonte në një barakë llamarine, nuk e thyen dot njeriun dhe poetin Kostreci…

Tashmë muzgjet dhe nata e jetës së tij, kanë mbetur pas, si një kujtim i hidhur i një brezi të tërë, që u përball me dhunën e diktaturës… Prandaj tingëllon kuptimplotë vargu i një prej soneteve të tij:"Veç penda më dha forc' t'i bëj ball ferrit". Në kushtet e demokracisë dhe lirisë, në Shqipërinë postkomuniste, penda e Kostrecit vjen me një forcë tjetër, duke botuar librin me sonete "Lundërtari dhe deti" (1993), poemat satirike "Epopeja e karkalecëve"(1995) dhe "Agonia e karkalecëve(1996).

Dhe pas dhjetë viteve largimi nga Shqipëria (ai emigroi në SHBA në vitin 1997), Kostreci vjen me një libër të ri të titulluar "Sonete".

ME RIMË LIGJËROVA, U THUR SONETI !

Jam i bindur se pasi të kisha lexuar sonetet e tij e ndoshta pa e njohur, kudo që ai të më shfaqej, mes mijëra njerëzve në Nju Jorkun e madh apo në çdo skaj të globit krejt i vetëm, do ta dalloja poetin dhe njeriun me emrin Uran Kostreci. Rëndomë thonë se kështu ndodh me krijuesit. Unë do të thoja se kjo është pjesërisht e vërtetë. Në letërsinë botërore dhe natyrisht edhe në atë shqiptare, janë me fat ata krijues që në krijimtarinë e tyre kanë arritur të formëzojnë portretin dhe shpirtin e tyre. Një prej tyre, në letrat shqipe, është ëngjëlli mbrojtës i shqiptarëve, Naim Frashëri. Poezia e Naimit është e brishtë përtej brishtësisë si vetë poeti, e shenjtë përtej shenjtërisë si vetë Naimi, delikate dhe e dhimbshme siç ishte Naimi ynë.

Sonetet e Uran Kostrecit (gjithsej 66), botuar në librin "Sonete" janë portreti dhe bota e papërsëritshme e poetit, jeta dhe shpirti i tij i trazuar. i ndjeshëm (sikur ecën ngadalë për të mos trazuar vesën e mëngjesit), herë – herë me një dhimbje të përmbajtur, shpëthyes dikur tjetër, si stuhia, për t'u qetësuar më pas, filozof e meditativ për padrejtësitë e kësaj bote, stigmatizues i së keqes, por edhe mëshirues e zemërmadh, ky është Uran Kostreci në librin 'Sonete".

Ai është poet i imazheve dhe kontrasteve të fuqishme. Optika e poetit, duke lëvizur në kohëra dhe hapsira konkrete, përcjell tek lexuesi emocione të veçanta drithëruese. Edhe kur i këndon natyrës (këto ndoshta janë sonetet më të arrira), edhe kur jep motive nga jeta e tij e dhimbshme apo në të tjera, nëpërmjet rrëfimeve të thjeshta e jetësore, ai të rrëmben me fjalën, figuracionin e pasur, por veçanërisht me imazhet poetike dhe gjendjet emocionale që ato krijojnë tek lexuesi. Do të mjaftonte soneti "Stuhia" për të ndjerë forcën e imazheve dhe fjalës poetike, e cila më kujton vrullin e muzikës së Bethovenit:

Kjo stuhi sonte, ankth jep dhe drithërima,
Papritmas qielli sterr ndizet flakë,
Nga gjarpërinjtë e zjarrtë shkreptima
Dhe shndritja kthehet fill në terr mbas pak.

Dhe në dy strofat e fundit, me një kontrastim mjeshtëror, sjell një atmosferë tjetër:

Po siç ja mbath fantazma kur sheh dritë
Furtuna shpejt fashitet sapo agon
Natyra e lodhur shtang një çast, dremit.

Pikëlojn' drizat, dheu avullon;
Del bagëtia, zogu çuçurit.
Sheh… diellin bari e shtriqet mugullon.

Kostreci zotëron mjeshtërisht fjalën dhe vargun në sonetet që ka krijuar. Dhe kjo nuk është pak. Sepse të zotërosh fjalën dhe vargun, t'i vendosësh ato në vendin dhe kohën e duhur, kjo quhet në krijimtari mjeshtëri artistike. Dhe më shumë se kushdo këtë e kërkon soneti. Poezia e vërtetë, po veçanërisht soneti, nuk duron tepri fjalësh. Sepse soneti është delikat dhe i brishtë si njeriu në adoleshencën e tij apo edhe si një vajzë e re e bukur, e brishtë, që akoma nuk ka provuar puthjen e parë… Poeti në këtë libër i ka nën komandë fjalët, ashtu si në ushtri gjeneralët e zot

komandojnë ushtarët e tyre. Kjo nuk është e lehtë të arrihet. Të zotërosh fjalën do shumë mund, lodhje, tension, vëmendje, përqëndrim, pagjumësi, sepse në poezi fjala i bindet poetit, që njeh çdo nuancë të saj ose që sheh përtej asaj që mund të shohë njeriu i zakonshëm.

Tek soneti "Gjallesa nate", fjalët si ca qingja të urtë, rrinë bukur pranë njëra – tjetrës e ku lexuesi ndjeu bukurinë e poezisë së vërtetë ose ngjitet në majat, ku zotëron qetësia sublime:

Perëndoi dielli, reja kuqëloi
Po u zbe shpejt e erdhi duke u nxirë;
Një vello e murme u nde, ra mugëtirë
E, fushën, ngadalë nata e mbuloi.

Ose tek "Hëna":
M'u zu firoma nga terri e vetmimi
Qëkurse hëna u fsheh e bota nxin,
Më pikom zemra gjak... e psherëtin',
Si pus i zi më mbyti ah, trishtimi!

Uran Kostreci është i vetmi, ndoshta i fundit poet, që sjell ose më saktë ringjall në poezinë moderne shqipe të fillimshekullit të njëzetenjëtë, sonetin. Dhe jo vetëm kaq. Duke ruajtur formën klasike të tij prej 14 vargjesh, të ndarë në 4 strofa, ku dy të parat përbëhen prej 4 vargjesh dhe dy të fundit prej 3 vargjesh, zakonisht njëmbëshjetërrokësh e me rima të gërshetuara në mënyrë të ndryshme, Kostreci e pasuron atë me motive të kohës. Soneti, ndryshe nga vargëzimet e tjera, është më i brishtë, më delikat , më aristokrat, por herë-herë edhe kryeneç, që nuk i bindet kujtdo. Poetit Uran Kostreci, me natyrën e tij, i shkon për shtat soneti ose ka ditur ta fusë në "vathën" e tij atë. Kështu ndodh me shifrën 66 të soneteve të vëllimit poetik, me çdonjerën prej tyre të përfshirë në këtë shifër biblike. E tillë është edhe ajo që çel vëllimin, me titull "Vetëtima" Ndonjë poet tjetër, po të ulej e të shkruante të njejtin motiv, atë të vetëtimës, do t'i përcëllohej fytyra, do të mbetej pa vetulla e flokë ose ndosha me duart tërë flluska nga djegia... Kostreci jo. Ai në vargun e fundit edhe e dashuron vetëtimën, pasi admiron "magjinë e përshkënditjes" dhe e kqyr atë "syngulitur".

Me këtë libër me vlera, por edhe në të tjera që do të vinë më pas, moto e poetit do të jetë vargu i një prej soneteve të tij:" Me rimë ligjërova, u thur soneti!" Lexuesi ka nevojë edhe për këtë lloj poezie, disi të harruar, por që dekada dhe shekuj më parë , e kanë shkruajtur disa prej mjeshtrave të mëdhenj botëror e shqiptarë.

PA GAZ E POEZI, KUFOMË E GJALLË...

... Elegant, veshur me kostum ngjyrë të errët dhe borselinë të zezë, me një rini të rikthyer në portretin e tij, Uran Kostreci, pas gati dhjetë vitesh emigrimi në SHBA, është kthyer në Tiranë.

Të shumtë janë miqtë që e takojnë ose ulen me të për të biseduar.... Herë – herë, në muzgjet e bukur të vjeshtës së Tiranës, ai ecën i vetmuar me të njëjtin kostum dhe borselinë... Duket, me cigaren e pashuar në buzë, si poetët bohemë parizianë. Sepse poetët kanë nevojë të rrinë me vetveten, të meditojnë apo kinse rrinë me vetveten... Ata, ëndërrimtarë të përjetshëm e të pandreqshëm, jetojnë në ca botëra të tjera, që njerëzit e zakonshëm vështirë se i kuptojnë... Uran Kostreci jeton në botën e soneteve, thur vargje , flet me vdektarët e mëdhenj Petrarka, Mjeda, Serembe... Ai nuk është vetëm... Poetët asjëherë nuk janë vetmitarë. Uran Kostreci jeton rininë që u përpoqën t'i rrëmbenin, sepse, siç shkruan ai "Pa gaz e poezi, kufomë e gjallë".

Tiranë, vjeshtë e parë e motit 2007 – Korrik 2021

Një kujtim-homazh për poetin Uran Kostreci

nga Uran Butka

Me Uran Kostrecin jemi njohur në fillim të vitit 1991, pasi kishte dalë nga burgu, kur ai vinte nga Elbasani, tek banonte, për në Tiranë, ku e kishte selinë Shoqata e të Përndjekurve Politikë. Mandej, kur u themelua gazeta "Liria", organ i kësaj shoqate dhe ai u caktua kryeredaktor i parë i saj, bashkëpunimi dhe miqësia jonë u shtua.

Ai ishte një njeri krejt i veçantë. Profilin e tij, sidomos sjelljen, ia ka theksuar më së shumti jeta në burg, ku njeriu ose shkatërrohej krejtësisht, ose dilte më i fortë e më i mençur- siç ndodhi me Uranin. U dënua për tentative arratisjeje dhe, natyrisht, sepse ishte i biri i Fuat Kostrecit, nacionalist dhe antikomunist nga Kostreci i Dangëllisë, i burgosur politik edhe ai, me akuzën e rreme se bënte pjesë në një grup armiqësor në Kolonjë.

Në burgun e Burrelit Urani pati fatin të njihte personalitete të shquara si Engjëll Çobën, i cili i dha mësime italishteje dhe e kalli në botën poetike të Dante Aligierit; Koço Tasin, që i dha mësime filozofie, Kudret Kokoshin, që e ushqeu me nacionalizmin, Dom Nikollë Mazrekun, që i forcoi besimin e faljen dhe mjaft të tjerë, nga të cilët mësoi, por edhe dha nga vetja, sidomos shembullin e mosbindjes dhe të qëndresës.

Kohën më të gjatë në burg e kalonte në vetmi në birucë, nga që dënohej vijimisht nga komanda për mosbindje, kundërshtim dhe shpërfillje.

Një herë burgun e Burrelit e vizitoi një titullar i Ministrisë së Brendshme. Me këtë rast i mblodhën të burgosurit që ta dëgjonin. Ai ishte minoritar grek dhe nuk e fliste mirë shqipen. Shpesh përmendte në fjalën e tij: "Skipëria" skëmb graniti, "skipëtari" ja bën fora !

Kur mbaroi titullari i lartë, drejtori i burgut tha:

-"A ka ndonjë pyetje?".

Urani ngriti dorën

-Mos ia jep fjalen atij, se është I rrezikshëm, - i tha drejtori I burgur te deleguarit.

-Më mire t'ia jap, qe ta shohim se çka në kokë,- tha i deleguari. Pa shohim e bëjmë pastaj..

U ngrit Urani më këmbë dhe foli kështu: "Faleminderit që na lejoni të bëjmë ndonjë pyetje. Unë kam lexuar mjaft dhe kam bërë, fatmirësisht, ca vite shkollë, e njoh mire gjeografinë, po emrat "Skipëri" dhe "Skipëtar" nuk i kam dëgjuar. Dhe nuk e di ku bien. A mund të na i thoni se në ç'anë bien?!"

Mbledhja u mbyll menjëherë dhe Urani përfundoi 15 ditë në birucën me ujë për tallje ndaj të deleguarit.

Një herë tjetër, shkoi në burg një i deleguar po nga Ministria e Brendshme, por më i nxënë, tip intelektuali. Ai foli për politikën e jashtme të RPS të Shqipërisë, ndërkohë që dënoi agresionin dhe ndërhyrjen ushtarake brutale të Brezhnjevit e të ushtrisë sovjetike në një vend sovran si Çekosllovakia, e cila donte të shkëputej nga kampi revizionist. Në përfundim të ligjerimit, i deleguari i kënaqur pyeti nëse kishte ndonjë gjë të paqartë.

Urani ngriti dorën.

Drejtori I burgut e paralajmëroi të deleguarin, qe të mos ia jepte fjalën. Eshtë rebel, i tha.

Lektori, bëri si bëri, ia dha fjalën, sepse Urani ngulmonte, ndersa lektori pati ndjesinë se i burgosuri do ta lavderonte.

- Jam në një mendje me zotërinë tuaj, që mësymja kundër Çekosllovakisë është një agresion i pastër kundër një vendi sovran dhe bëri mirë qeveria jonë që e denoncoi, - tha Urani. – Po përse nuk e bëri qeveria jonë këtë denoncim edhe në vitin 1956, kur ushtria sovjetike e pushtoi dhe e përgjaku Hungarinë?

- Nuk ka lidhje. Janë dy gjëra të ndryshme, - tha i deleguari dhe u err në fytyrë.

Po Urani vazhdoi:

- Janë të ngjashme si dy pika uji, por qëndrimi juaj është i ndryshëm.

- Mendimi yt është i ndryshëm! - u hakërrua i deleguari dhe e mbylli mbledhjen.

Këtë herë Uranin e lidhën me pranga, e torturuan dhe e hodhën rrëshqanthi në një birucë.

Kjo i ndodhte shpesh Uranit përgjatë 20 vjetëve që vuajti në burg, madje s'kishte muaj që të mos dënohej për kundërshtim të urdhrave të eprorëve, apo për pyetje provokuese. Gradualisht ai u kthye në një rebel, që ndihej mirë vetëm kur ironizonte apo kundërshtonte urdhrat e padrejta dhe fyerjet e dhunimet që u bëheshin të burgosurve.

Gjithsesi, në heshtjen dhe vetminë e qelisë, Urani i pranguar dhe i dhunuar, zbuloi alter-egon e tij dhe nisi të hahej me të. Ajo ishte një qenie e brishtë, e ndjeshme, poetike, ndryshe nga dukja e ashpër, e palëkundur, rebele e Uranit. Ai kishte brenda poetin, që jetonte në një botë ideale dhe që e bënte edhe zhguallin e tij fizik të mbijetonte.

Poeti krijonte në mendje, ndonjëherë edhe në ndonjë copëz letër, sonetet lirike, mandej edhe poemën "Epopeja e karkalecave". Dhe, kur disa nga ato fletushka ia sekuestruan gardianët, ai u tha "I kam në mendje". Edhe për këtë përgjigje u dënua sërish dhe u mbyll në birucë, sepse i paskësh pasur mendimet dhe vargjet e fshehura në mendje!

Mirëpo, ndonjë herë kur shpirti poetik prekte realitetin e dhimbshëm, torturat dhe poshtërimet e burgut, atëherë jeta s'kishte më kuptim dhe vihej në pyetje ekzistenca e saj. Përse duhet të jetonte? Kështu, një çast dëshpërimi ai iu drejtua telave me gjemba, që ngriheshin mbi muret e burgut, jo për t'i kapërcyer e për t'u arratisur, por për të prekur fundin e tij. Zgjati duart drejt telave, dëgjoi thirrjet e rojave: "Ndal! Ndal!", mandej krismat e automatikëve dhe vërshëllimat e plumbave, që i shpuan xhupin, nga i cili dolën flluska pambuku të zi. Një plumb e fshiku mbi ballë dhe e përgjaku. Mandej duart e rojeve që e zaptuan, e goditën dhe e tërhoqën zvarrë deri në birucë, ku e kishte vendin dhe hodhën atje si një kufomë. Dhe kur trupi i tij nuk ndiente më, kishte vdekur, shpirti i poetit gjallonte, gëlonte nga dëshira për jetën, gëzonte që kishte mbetur gjallë, ndonëse për një çast dëshpërimi kishte kërkuar mortjen. Ishte dashuria instiktive për jetën, sido që të ishte ajo!

E kini vënë re që Uran Kostreci mbante mbi krye vazhdimisht një kapele republike? Ai nuk e hiqte kurrë, veçse kur flinte, gjithnjë i vetmuar dhe i heshtur, si në burg, ndonëse tashmë i lirë. Ai e mbante kapelën në kokë, që të mos i dukj shenja e plumbit mbi ballë, që të mos dukej si hero apo si viktimë, por si një njeri i zakonshëm, ndonëse I lire dhe poet përbrenda .

Me shumë respekt, vdekja!...

Pas një nate të gjatë e me shumë gjumë, fiks në ditën kur i mbushi dyzetë vjet, ai u zgjua, lau dhëmbët, fytyrën, hëngri pekmez manash me një copë të mirë buke, piu një gotë qumësht të ftohtë, dhe doli përpara shtëpisë.

Po bëhej gati të përshëndetej, ditëlindisht, me diellin; po bëhej gati, t'i japë ditës, falënderimin për frymën.

Kur uli sytë e u përkul për t'i mbathur këpucët, përpara hyrjes së shtëpisë, ai pa një zarf. E mori, e hapi me kujdes, dhe filloi ta lexojë letrën brenda zarfit, që ishte e shkruar me print:

"Përshëndetje, njeri i mbarë!

Mos më keqkupto që po të shkruaj kaq herët; kështu e kam urdhërin. Ti mbrëmë fjete bukur, fjete gjatë. U kënaqe fort, besoj. Por, kjo është dita jote e fundit. Fiks n'ora njëzetëedy, do vij ta bëj përmbarimin.

Me shumë respekt, Vdekja"

Vetëkuptohet, iu këputën këmbët atij, sado që mendja dhe zemra i krehnin një dëshirë a një mendim të sigurt, se bëhej fjalë për ndonjë shaka miqsh.

Prapë se prapë, megjithëse e kishte edhe ditëlindjen e dyzetë, mendoi ta kalojë bukur atë ditë. I telefonoi të dashurës, Hanës, dhe i tha:

"Sot është ditë e diel. Siç e di edhe ti, e kam ditëlindjen e dyzetë. Sot, dua gjithë ditën ta kaloj me ty... Mos ma pështill me arsyetime të kota. Ma bë këtë nder. Lëri pezull gjithë obligimet që ke. Takohemi te "Serenata", pas një ore..."

Andej telit, ajo qeshi ëmbël..., dhe ky, s'i tha gjë asaj për atë punën e letrës. Ia shkeli gazin "golf"-it, dhe fiks pas një ore, hyri në kafenenë "Serenata". Zgjodhi një tavolinë, u ul, porositi një kafe.

Mendimet për atë letër të çuditshme e preknin fort, por jashtë kësaj, dita kishte mbarësinë e vet.

I qeshën sytë, pas ca minutash, kur prapa xhamit ngjyrëgri të derës së kafenesë, u shfaq fytyra e bukur e Hanës. Ky, me shumë xhentilesë, u ngrit, i doli përpara, dhe e përqafoi fort. As nuk vuri re, se ajo s'ia uroi ditëlindjen. U ngut ta shfrytëzojë rastin, si gjithnjë: në përqafim e sipër, në një sekondë të vetme, ia puthi asaj, laprën e veshit.

Gjithnjë duke folur e qeshur, i pinë kafetë dhe dolën. Me veturë, u nisën.Vërtet qëlloi e bukur ajo ditë vere. Në vozitje e sipër, Hana qeshte dendur, dhe i ngjitej për krahu. Ai bënte ta puthë, dhe Hana i largohej. Nën furimën e frymës së ngrohtë të verës, që vinte nga dritarja e hapur e veturës në anën e saj, flokët e Hanës, të pabindura si gjithnjë, i përplaseshin atij, për fytyre e për goje.

Aty kah pasditja, e parkuan veturën në një vendparkim të sigurt, dhe u futën, më këmbë, në zemrën e qytezës. Shëtitën nëpër shumë rrugë; u ulën e pushuan në ulëset e shumë parqeve; shijuan gjithë bukurinë e qytetit; u dhanë lëmoshë ca lypësve; ushqyen ca pëllumba në njërin park; darkuan në një restorant hoteli me shumë ekzotikë, dolën...

Pasdarkja kishte mbërritur, dhe mbrëmja ua ekzaltonte ndijimin. Një hënë delikate e hijeshonte qiellin.

– Po tani? – i tha ai dhe e kapi për beli.

Ajo u mblodh si kone dhe u përgjigj:

– Tani do marrim veturën dhe do shkojmë atje, te Pika Dyzetëenjë e bregut të lumit. Ti sapo ke hyrë në vitin e dyzetenjëtë të jetës, zemra ime...

Që nga ajo kohë e largët (kur në atë pikë lumi, u mbyt Lejtiku – shok i tij i fëmijërisë), ai, kurrë më, nuk kishte shkuar në atë pikë lumi. Gjithë qyteti e dinte, se ajo pikë ishte tepër e rrezikshme për t'u larë. E gjithë pika ishte një shkëmb, dhe përposhtë shkëmbit, njëzetë metra më poshtë, lumi. Por, ishte pasdarke, dhe vetëkuptohej, se ajo, nuk i propozonte të shkonin atje për t'u larë. Në fund të fundit, a i thehet zemra zemrës?...

Pak para orës njëzetëedy, ata u gjetën te pika në fjalë. Dora e Lunakut (Lunak quhet dyzetvjeçari ynë në fjalë), e mbërtheu fort belin e së dashurës. Por, koneja e tij e dashur akoma s'i jepej. Ajo, me gishtin tregues, ia qiku buzët atij, iu shkëput nga duart, vrapoi si erë drejt shkëmbit të rrezikshëm, dhe u ndal, mu te cepi i tij.

Gjithë frikë, ai i vajti pas, dhe e luti të largohej. Kishte, vetëm dy hapa largësi ndërmjet njëri tjetrit, dhe ora ishte fiks njëzetëedy. Fiks n'atë çast, trupi i kones lëvizi, bëri dy hapa në drejtim të burrit të zemrës, dhe ia vuri duart mbi supet. Atje lart në qiell, hënën e miklonin një grusht yjesh. Nata, derdhej në vete, si me magji muzike, dhe trupat e të dyve, ngjitur për njëri tjetrit, vetvetishëm, filluan të rrotullohen, mu te cep i shkëmbit.

Në sekondën më të bukur të ndërlidhjes së trupave (kur mishi përprek mishin dhe bëhet frymë), ai u gjet i kthyer me shpinë kah lumi dhe me fytyrë nga ajo. Ky qe çasti kur rrotullimi i trupave pushoi, dhe koka e tij mbështetej ëmbël mbi ballin e saj. Ai ngriti sytë e ndezur, dhe, kur trupesy, provoi të futet në sytë e saj, ajo ia dha të shtyrën. Po atë çast, atij i doli përgoje, një "ooooohhhhhh.... nënë...", që zgjatej, me jehonë, drejt rënies, bashkë me trupin që binte përposhtë,

DY TREGIME NGA SHAZIM MEHMETI

dhe me shtytje gravitacioni, rrotullohej pandarë drejt errësirës së ujit.

Kur këmbët iu përplasën me ujin (fat i madh), në një sekondë kohe, ai arriti të mendojë: "Paskësh qenë Vdekja, me fytyrën e Hanës!..." Po kështu mendonte, edhe kur trupi i jepemerrte me gjithë shpirt, në thellësinë e lumit.

Sa i doli koka mbi sipërfaqen e ujit, veç një hap më tutje, plasi një përplasje, si bllllluuuummmm, në errësirë. Stërkalat e lumit iu përplasën për fytyre. Errësira ia kafshonte sytë, me dhëmbë vdekjeje.

– Oh, vdekje!... – rrënkoi, dhe i lëshoi sytë drejt cepit ku e mendonte Hanën.

Ishte çasti i gjëmimit të veshëve ai çast, ishte mosdorëzimi. E mbate, disi, veten mbi ujë, – arrinte ta mendonte edhe shpëtimin, – kur, një përkapje nënujëshe e shtyu me forcë përpjetë.

– Oh vdekje!... rrënkoi sërish, e, sapo rrënkoi, mu përpara hunde, errësira i polli një tjetër befasi: diç që doli nga uji, dhe i foli dridhur: " Jam unë, zemra ime!... Ishte shaka, zemra ime!... E mendova si dhuratë për ditëlindje... "

Ishte vërtet ajo; ishte Hana, që n'ujë, i varej për qafe, e përqafonte fuqishëm, dhe e puthte pandalur.

Andej kah dukej pak më mirë, ata notuan drejt bregut të shpëtimit, krah për krah. Atje në breg, gjithnjë duke u dridhur, ai e shikonte natën dhe atë: nata ishte, po ajo; Hana ishte, po ajo.

A u besonte syve?...

U ngjitën, shtegut, që e njihnin të dy. Ashtu të veshur, e të rënduar nga lag'ja, arritën sërish te "pika e vdekjes" ku ndodhi shakaja. Ca hapa larg cepit, të dy, deri nën lëkurë u zhveshën, dhe u përqafuan ngeshëm. Nën dritën e hënës (që ishte në të pesëmbëdhjetën e saj), dhe nën qelibarin e shpërndarë të qiellit veror të natës, deri para mëngjesit, ata bënë me njëri tjetrin, gjithë ç'bëjnë dy të dashuruar, në një natë vere me hënë...

***

Të nesërmen pasdite, Hana u përmend, në një dhomë spitali. Pas gjithë atyre orëve që kishte qenë pa vetëdije, kur i hapi sytë, ajo fillimisht pa një bardhësi si bardhësi muresh, pastaj pa një si dritare të gjërë sa gjatësia e murit, pastaj pa një si derë poashtu të bardhë, pastaj i pa edhe ato pajisje sanitare si zorrë të holla, që ia kishin lidhur për trupi e për hunde. Pa, më pastaj, edhe një infermiere kujdestare, që i rrinte anësh.

– Lunaku, ku është?... – qe e vetmja gjë që Hana tha.

Nuk kishte zë; Hana, mezi tha aq.

Infermierja heshtte e i ulte sytë përposhtë, por vetëm pas pak, në dhomë hyri një mjek me moshë, dhe Hana ia bëri atij po të njëjtën pyetje: "Lunaku, ku është?..."

Mjeku mblodhi krahët, dhe mezi i shqiptoi këto fjalë:

– Atë... s'e shpëtuam dot... Më vjen shumë keq!... – vazhdoi – Ju... mbrëmë..., e kishit patur... fatin e keq... Ju ka sulmuar një psikopat i armatosur... Fatkeqësisht, pas luftës që sapo ka kaluar, psikopatët dhe armët janë shtuar me shumicë!...

Krizantema

Mëngjesi qe me vesë e me aromë mali, e dielli agimtar kishte çelur në majë, i bardhë e i bukur, si një krizantemë e re.

Palë-palë, si një zonjë e hajthme, hiqej natë e freskut, duke ua larë sytë ushtarëve me copëza ëndrrash.

Ngjitej Malsharrit edhe frymë e mallit, e freskët dhe e lehtë, si vasha me flokë ere, që shpatin kalonte ditë për ditë, dhe me shtambat në duar sillte ujë të ftohtë në istikame.

E në krah të togut, ushtari më i ri, një djalë që s'kish lëshuar as brisk mbi fytyrë, pa frikë fare, i rrinte sipër një minahedhësi të ri, dhe i përqëndruar fort, mbante shenjën mbi një tank armiku, që nga poshtëgryka kërcënonte si kafshë e egër, e zezë.

Djali, fytyrënjomë qe fare, dhe vasha që ujin sillte, fytyrënjomin donte.

Atë mëngjes, vasha la shtambat, iu afrua si ngahera. Ushtari e ndjeu, por trup e mendje i kishte bërë peng mbi minahedhës, dhe s'kthente kokë. Syrin e mbante pingul, në shenjë, mbi tank.

Vasha fshiu djerrsët që i rridhnin faqeve të mbushura e të njoma, u kollit gëzueshëm, por ushtari vazhdonte të përgjojë vëmendshëm, me syrin në shenjë, mbi tank.

Ngacmueshën, vasha lëvizi me këmbët e bardha fakefuk, por ushtari ngujohej edhe më, me syrin në shenjë, mbi tank.

Sakaq, vasha iu ul përkrah, por ushtari vazhdonte përqëndrimin, me syrin në shenjë, mbi tank.

Vasha ia preku edhe supin, por ushtari sytë i kishte bërë katër, i përqëndruar fort, me syrin në shenjë, mbi tank.

Vasha i cërcëroi në vesh ca fjalë zemre, por ushtari e ngujonte edhe më tej shikimin, me syrin peng, në shenjë, mbi tank.

"Ooohhh"- klithi vasha, ankueshëm, sa për t'u mahitur paksa.

Atë çast, si me instikt bilbili, ushtari u ngrit rrufeshëm, i hodhi sytë e trishtuar kah bukuri e vashës, dhe mori sakaq, në lule të ballit, një plumb armiku!!!...

Mëngjesi qe me vesë dhe me aromë mali. Liria gjak kullonte. E mbi trupin e pajetë të ushtarit më të ri, lotoi një krizantemë...

BRUNO

Tregim nga Hajri Shaqiri

H.J. u trishtua si asnjëherë më pare kur u kthye nga puna i rraskapitur i tëri dhe hapi derën e shtëpisë me mendjen të futej brenda, të hidhej menjëherë mbi krevat dhe të zhytej në një gjumë të thellë që do të zgjaste jo më pak se deri të nesërmen pasdreke, kur fillonte me punë turni i dytë në fabrikën e helikopterëve.

"Oh,. my God!... Oh, my God!...", u trishtua fort dhe thirri në ndihmë Zotin me zë të lartë, si të ulërinte. Skena që i doli përpara ia preu këmbët. Brunoja qëndronte i shtrirë në dysheme, i tëri i mbuluar në gjak dhe rënkonte. Kokën e kishte të dërmuar, sytë nuk ia vëreje dot, hunda i ishte lëvarur dhe sa nuk i binte përdhe. Mendoi se edhe një vesh nuk e kishte. Dukej shumë keq. Në një qoshe të dhomës ia kapën sytë Fazin, që ishte strukur me frikën mos ta gjente fati i Brunos. Ndërkaq, Zaku, mbase siç do të sillej çdo fajtor tjetër në të tilla raste, qëndronte në kanape dhe vështronte në një pikë të papërcaktuar, diku në murin e dhomës, për të mos puqur shikimin me njeriun që hyri nga dera. Rënkimet e dhimbshme dhe të pandërprera tregonin se Brunoja po kalonte nëpër një ferr të vërtetë, në të cilin u fut papritur edhe H. J. Autoambulanca çante rrugën me shpejtësi, ndërkaq ai nuk ishte i sigurt nëse fatkeqi do të shpëtonte nga plagët që kishte marrë, megjithëse ende kishte shpirt.

Në tokën e premtuar ishte vendosur pas qëndrimit disamujor në një kamp refugjatësh në Romë të Italisë, si një shqiptar adoleshent i ikur nga Ballkani. Dhe, gjatë viteve që pasuan, kishte ndërruar shumë qytete, disa gra që pastaj, të përfundonte në vendin e "kaubojcave", në bungallonë që e kishte vendosur në një lagje, të paraparë enkas për këtë lloj shtëpishë mobile. Megjithëse kishte mundur të blinte edhe shtëpi të zakonshme (të tilla në Amerikë i quajnë shtëpitë e ndërtuara prej dërrasash), ato që mund t'i bartje nga një vend në vendin tjetër, i pëlqenin më shumë. Kur mundohej të gjente shkakun e një parapëlqimi të tillë, atij gjithnjë i vinte në mendje, përveç të tjerave, mundësia për t'u zhvendosur pa telashe të mëdha diku tjetër, sa herë që do të dëshironte, madje, pa ndryshuar ambientin e brendshëm të folesë së tij. Megjithatë. përkundër përparësive të tilla, pasi u vendos në Dallas, ai nuk pati dëshirë thuaja asnjëherë të zhvendoste shtëpinë, siç nuk pati dëshirë as të martohej sërish, pas ndarjes me gruan e tij të fundit. Bungalloja numër shtatë e vendosur në periferi të qytetit, dukej e mjaftë madje edhe komode për të, për Brunon, Fazin dhe Zakun.

Në spital, mjeku e pranoi pacientin urgjentisht. Pa njëherë Brunon, pastaj i hodhi një shikim edhe H. J. Mbylli buzët duke i shtërnguar aq fort sa mbeti vetëm një vijë e shtrembër midis tyrë dhe luajti kokën me mosbesim..."Çojeni shpejt!", u bërtiti ndihmësve të tij dhe shoqëroi urdhrin edhe me dorën e shtrirë në drejtim të sallës së operacionit. Kur po futej mjeku në sallë dhe ky ia pa vetëm krahun që i kishte mbetur jashtë, si pjesën e fundit të trupit të njeriut tek i cili kishte mbështetur të gjitha shpresat, mendoi se po kalonte një periudhë të vështirë të jetës.

Vetëm ca ditë më parë kishte qenë te mjeku i tij personal. Një kohë të gjatë nuk ndihej mirë, jetonte në ankth dhe i ndodhnin gjera të çuditshme për të cilat s'gjente dot asnjë shpjegim. Një ditë, bie fjala, kishte shkuar në qytet dhe, pasi kishte shetitur deri sa ishte lodhur nëpër qendrat e mëdha tregëtare, ishte ulur për të ngrënë në restorantin e tij të preferuar. Dhe pikërisht në kohën kur kishte vendosur të këthehej në shtëpi, i kishte ndodhur e pabesueshmja. Me orë të tëra kishte qëndruar i hutuar në mes të parkingut të madh. Ishte përpjekur të përdorte edhe truqe që do t'ia ngacmonin trurin dhe t'ia kujtonin çastin kur ishte futur në atë vend, si qindra herë të tjera. Por çdo gjë kishte qenë e kotë, nuk kishte mundur ta kapte fillin dhe nuk i ishte kujtuar se ku e kishte parkuar veturën edhe sikur ta kishe vrarë. Përkundër kësaj, pasi kishte futur dorën në xhep, kishte konstatuar se i kishte humbur, në të vërtetë, edhe çelësat. Në fund kishte hequr dorë nga aksioni i kërkimit dhe nga parkingu ishte larguar me taksi. Kur kishte arritur në shtëpi, kishte rënë në përfundim se nuk e kishte humbur fare veturën, ajo kishte qenë aty, përpara shtëpisë, madje me çelësat brenda. "Budalla!", i kishte bërtitur vetes. Kur ia pat treguar ngjarjen mjekut, ai e kishte pyetur nëse i kishte ndodhur diçka e nagjashme edhe ndonjë herë tjetër. Kishte pohuar me kokë dhe ia kishte treguar rastin kur, duke u kthyer nga puna, e kishte humbur rrugën dhe mezi e kishte gjetur kthesën për në shtëpi. Mjeku nuk i kishte thënë gjë, por e kishte çuar tek mjekë të tjerë. Ata e kishin inçizuar në kokë, e kishin pyetur për gjëra, që ai i kishte cilësuar, të parëndësishme, madje i kishin dhënë të kryente edhe disa teste logjike. Në fund fare, njëri nga ata ia kishte përmendur shenjat e dallueshme të sëmundjes së alzheimerit dhe pastaj, në ikje, para se ta mbyllte derën, i kishte rekomanduar të lexonte libra,

çfarë do lloji të ishin ato, të bënte ushtrime të thjeshta matematikore dhe të konsumonte sa më shumë kos të përzier me boronica.

Pasi u ul në karrigen prej plastike në koridorin e spitalit, afër sallës së operacionit, sytë e përlotur i kapën një portret të varur në murin përballë, të mbyllur në një kornizë të zezë metali. Gruaja flokëverdhë, me një buzëqeshje të ëmbël dhe eksituese njëkohësisht, i hodhi një shikim përkëdhelës, i shkeli syrin dhe i foli butësisht: "ke dëshirë të vi e të ulem pranë teje?" "Merilin Monro", belbëzoi i hutuar dhe nuk arriti t'i përgjigjej ofertës që i erdhi papritur. Nuk tha as "po" dhe as "jo". Aktorja e bukur vërtet doli nga korniza, por nuk erdhi te ai. Vendin e saj e zunë ca portrete grash të tjera që ky, sa herë që i kujtonte, i kujtonte me numra dhe jo me emrat e tyre të vërtetë. E para, mendoi, nuk do ta ngushëllente shumë edhe sikur të qe aty në ato çaste. Në fakt as ai vetë nuk do të kishte dashur ta ketë pranë. Pasi e kishte marrë në Amerikë, si një vajzë nga vendlindja, i shtyrë para së gjithash nga nostalgjia, ajo nuk kishte qendruar gjatë me të. Kishte mësuar ca gjera për Amerikën, kishte marrë "Green cart"- ën dhe në fund, ia kishte mbathur. Të dytën, poashtu nuk e quajti të përshtatshme për të qenë me të në ato çaste të dhimbshme. Megjithëse i kishin bërë ca vite martese, asnjëherë nuk kishin fjetur bashkë. Kur një ditë ia kishte qarë hallin shokut të tij të punës, ai i pat thënë se gruan e kishte frigjide dhe, kur ky i kishte zgurdulluar sytë, shoku i kishte dhënë edhe një sqarim plotësues. Gratë e tilla, i kishte thënë, nuk kanë dëshirë të bëjnë seks, me asnjë burrë. Për të tretën ishte plotësisht i sigurt se do të ishte një mbështetje e mirë për të zbutur ankthin nëpër të cilin kalonte. Dhe vërtet, ajo kishte një simpati të veçantë edhe për Brunon por, ç'është më e rëndësihmja, kur bëhej fjalë për dashurinë, ajo asnjëherë s'i thoshte jo. Bënte seks sa herë t'i kërkoje, madje e bënte me dëshirë. Megjithatë, një ditë ajo u zhduk, edhe pse ky asnjëherë s'i kishte thënë të ikte dhe ç'është e vërteta, as ajo nuk kishe shfaqur në asnjë rast ndonjë shenjë që tregonte se nuk dëshironte të jetonte me të. Dikur u kuptua se prirjen e saj në fushën e seksit, e kishin zbuluar edhe të tjerë dhe një ditë njëri nga ata, e kishte marrë...

Dikush e lëkundi dhe ai doli nga ankthi, i pasigurt nëse kishte bërë ndonjë copë gjumë në karrigen e sallonit të pritjes dhe, nëse kishte fjetur, nuk i kujtohej nëse i kishte mbyllur sytë apo i kishte lënë hapur? Vërejti dorën që i ishte qepur në sup dhe po e lëkundte. Ngriti kokën me trishtim dhe pa sytë e lodhur të mjekut. Megjithëse nuk e dinte saktësisht ç'kohë kishte kaluar duke rikujtuar të shkuarën të përzier me një përfytyrim të aktores holivudiane, ndjeu një dhimbje koke që po ia ndrydhte trurin dhe nuk i jipte mundësinë të mendonte dhe, aq më pak të fliste.

"Shpëtoi, zotëri. Kishit fat, edhe ju edhe ai... Do t'ju lajmërojmë kur do të mund ta mirrni në shtëpi", tha mjeku në ikje e sipër...

H. J. vazhdonte të ishte i hutuar. Nuk arriti të nxirrte asnjë fjalë të vetme nga goja. U mundua së paku të thoshte një "faleminderit", por, kur iu kujtua fjala, sytë nuk ia kapën mjekun që, tani më ishte futur në njërin nga bërrylat e shumtë të korridoreve të spitalit. Fshiu lotët me mëngën e këmishës, por nuk arriti të hiqte edhe ndjenjën e boshllëkut që e mundonte. Mbështeti kokën në murin me pllaka të bardha, hodhi shikimin e turbullt në drejtim të tavanit dhe pastaj e zbriti deri te korniza e zezë prej metali. Merilin Monro ishte kthyer, ishte futur sërish brenda saj dhe vazhdonte t'i buzëqeshte ëmbëlsisht. Pasi ofshani thellë, tha: "Thenks God..." Ndjeu një valë të ngrohtë që i erdhi nga këmbët dhe u zgjerua gjithandej që pastaj të përqendrohej diku në kraharor. Nuk deshi ta prishte atë ndjenjë. U afrohej të shtatëdhjetave dhe kishte kohë që kishte humbur besimin tek vetja... tek gratë... tek njerëzit, në përgjithësi. Qentë, Bruno, Faz dhe Zak, për të ishin çdo gjë, madje, shpesh i dukeshin edhe më njerëzorë se vetë njerëzit. Ndenji edhe një copë herë në karrige pa lëvizur fare dhe mendoi se ishte i lumtur, megjthatë.

MASKA E ZOTIT

Nga Rexhep FERRI

1.

Tregoje fytyrën!
Ku ta gjej?!
Askujt nuk i mungon fytyra.
As që kërkon që ta kuptojë pse i kemi dy fytyra.
Ëndrra nuk është ëndërr.
Nga gazi lotsjellës nuk po ankohemi.
Mësova shumë.
Njerëzit e natës na e sollën historinë e tradhtisë, dhe lojën e qorrfermanit.
Te kufijtë e provokimit.
Kur jemi ata që jemi.
Një histori që nuk ka as drejtësi e as ligje.
Prapavija pikë e zezë.
Jo unë!
Jo ti!
Krime dha lavdi.
Çka harrohet harrohet.
Për historinë nuk kemi të dhëna të sakta.
Ndikimet janë të shumë interesave.
Në stilin e thjeshtë të kërkushave.

2.

Kur flasim nuk shikojmë.
Duam vetëm të flasim.
Qyteti i zi e ka Muzeun e zi.
Flamuri në gjysmështizë është fjalë publike.
Vendlindja ime është një qytezë e humbur thellë në provincë.
Shkon nga veriu në veri.
Kthehet nga jugu në jug.
Dhe prapë shkon atje ku ishte.
Arratisje.
Vëllavrasje.
Përsëri mashtrime çdo ditë e çdo ditë.
Shqiptari nuk vdes nga helmi i gjarprit, por nga fjala e vet dhe urrejtja.
Thuaj diçka të lutem.
Dua të më besosh.
Jam libër i hapur.
Kthehem më shpejt se shpejt.
Kam të drejtë ta jetoj jetën time.
Deri në atë pikë kur Ajo fillon të tallet me mua.
Kujt i kemi premtuar?
Nga lakmia e kemi harruar besimin në Zot.
Absurdi lehtë e zbulon anën e errët të njeriut.
Për ata që nuk e dinë se çka është frika, ndarja e botës nuk është më shumë se unë e më pak se ti.
Viktimat dhe xhelatët kanë mbetur pa varre.
Konfliktet e mëdha çdo ditë po rriten.
Papritë e pa kujtuar po na imponohet diçka e pakuptueshme.
Kur fama tejkalon vetveten, pas çdo feste fillon rrumpalla.
Kurrkush nuk e njeh kurrkënd.

3.

Një vajzë trupeshk, ta hajë dreqi!
Shumë e gjallë e shumë e mirë dhe shumë e bukur vonë erdhi dhe shkoi shpejt.
- Vetja po më duket si e humbur. – tha dhe vazhdoi udhëtimin për të bërë një fotografi.
Nuk ka më biseda normale.
Provojeni çmendurinë.
Patriotët e pabesë janë me armikun.
Konfliktin e madh e kishin me vëllavrasjen.
Nga Lufta e Dytë Botërore e pas Luftës së Dytë Botërore ka triumfuar bashkim-vëllazërimi me duart e lyera me gjak.
Ku po shkojmë do ta shohim!
Nuk e di a kemi ëndrra për të ardhmen.
Na duhet pak të rrezikojmë.
Budallenjtë po argëtohen.
Ne pse po qeshemi?
Deri në fund e di se është marrëzi.

4.

Para e pas takimit kemi jetuar ndarazi.
Jemi rritur ndarazi.
Jemi plakur ndarazi.
Është e pamundur të bëhet vlerësimi.
S'kemi aftësi që ta fisnikërojmë mendjen.
Bisedat intime e kanë humbur kuptimin.
Natyralizmi ka shkuar deri te asimilimi.
Legjenda thotë: Shikoje veten, korrigjoje mendjen!...
Duke e ruajtur ekuilibrin më mirë kuptohet thesari.
Zoti edhe pse nuk shihet është afër.
Larg syve tanë, syri frontal, në profil qeshet.
Si dhuratë për pagëzim kur njeriu nuk di ta sheh as veten.
Ka sy për detaje.
Kujt i beson nuk ia thotë as vetes.
Pse ndodh kështu, çdo pyetje ka një histori.
Në këtë botë nuk ka drejtësi.
Çdo gjë e ka një çmim.
Ku të gjendet fajtori.
Tokën e kemi vrarë.


Pikturë nga Agron Bytyqi

Një ditë njeriu, ish-njeriu u bë edhe ujk, edhe dhelpër.
Do të mbesin vetëm varret.

5.

Këtë marrëzi nuk do ta kuptojmë kurrë.
Kurrë nuk më ka shkuar ndërmend se njeriu mund të jetë edhe kaq kërkushi.
Njeriu dhe djalli filluan ta quajnë njëri-tjetrin mik.
Zoti pa dhe qeshi.
Me rojet e urave që e vranë shekullin, besimi shkoi drejt detit.
Kur shohim më larg kujt t'i besojmë?!
"E urrej krenarinë time".
Mos harroni, koha meriton më shumë.
Të bëhemi pak më realistë.
Kemi tre minuta kohë shtesë për të menduar.
Një buzëqeshje e hollë dhe e pastër si loti e ka përgjigjen pse jetojmë.
Pse kemi lindur.
Dashuria nuk është diçka krejt e dukshme si futbolli.
Ajo në anën e vet ka diçka të gjallë e të lëvizshme.
Deri te e papritura e ka përgjigjen pse jetojmë.
Ky kalim kufiri shkon derisa kohës t'i kalojë koha.

6.

Jo për një shekull!
Jemi vonuar më shumë se për një shekull.
Pse ndodhi kështu nuk e di.
Ç'të bëj me veten, po ashtu nuk e di.
Për ne hyrja në Mesjetë zgjati shumë.
Dalja nga Mesjeta zgjati edhe më shumë.
Fundi po tregon se nuk jemi kurrkund.
Deri te Guri i Fundit në maje të Piramidës, ku ka vend vetëm për një gur që e mbyll piramidën.
Fjala që po zhduket.
Jeta që po zhduket po na fusin frikën.
Iku rasti.
Dëgjova fundin.
Harrova fillimin.
Nuk kam humbur asgjë.
S'ka burrë që jeton si burrë!
S'ka burrë që vdes si burrë!
Kujt t'i falënderohemi?

7.

Koha e pa shpresë nuk është as pyetje e as përgjigje.
Jeta sa e dhimbshme, sa e bukur, është edhe humbje.
Njeriu ka nevojë ta shuajë etjen.
Kush i bie në sy e thërret.
- Oh, eja!...
Koha është të më besosh.
Kemi sy për detaje.
Për ta ruajtur sekretin.
Ruajtja e sekretit nuk është më shumë se unë e më pak se ti.
Nuk ia kam thënë këtë besim askujt.
Më 1961, kur isha student në Beograd e bleva një libër të arkeologjisë.
Në kopertinë ishte reproduksioni me legjendë "Maska e artë e mbretit ilir".
Me hypjen e temperaturës politike mbi njëqind, pas njëzet e katër viteve, në ribotimin e atij libri ishte e njëjta pamje figurative e kopertinës, por tani e kishte ndryshuar legjendën "Maska e artë e mbretit të vdekur", ilirët i çoi në harresë.
Meqenëse kemi jetuar jashtë historisë, të trishtuar dhe të lumtur, kurrë nuk kemi menduar se kujt i hyn në punë historia.
Për ta shpëtuar profilin mësova shumë nga historia e pashkruar.
Po vjen një kohë e largët.
Do ta jetojmë momentin.
Shkojmë në det.
Dëgjojmë oqeanin.
Nga turpi nuk do të dimë as të gënjejmë.
Kjo vetmi nuk është as fillim e as fund!

Qershor, 2021

Grua në qelq

-Eja!
-Ja edhe pak, të mbledh rrobat në tel.
-U lodhe! Çlodhu pak.
-Epo, duhen bërë.
-Mos thuaj që nuk të ndihmova.
-Jo, nuk them, vure në punë lavatriçen.
Pason një heshtje disa sekondëshe.
-Eja pra, shtrihu pak…

Ajo nxiton të mbarojë shpejt e pas pak gjendet në shtrat. Tendoset për të çlodhur gjymtyrët. Ai le mbi komodinë librin që është duke lexuar dhe kthehet nga ajo. E sheh në sy dhe buzëqesh. Ajo mbyll sytë duke pritur vazhdimin e buzëqeshjes. Pak sekonda dhe nuk pipëtin asgjë. Ashtu si gjatë gjithë ditës, kur ai nuk flet pothuaj kurrë një fjalë, nuk reagon kur ajo i flet, apo jepet i tëri pas ndonjë filmi të viteve të

shkuar, dalë jashtë mode dhe që e ka parë përmbi katër herë. Ajo vazhdon të presë. Sikur! Ah, sikur të ishte dikush t'i shtypte pakëz pulpat e këmbëve, kurrizin..ose të paktën kyçet e duarve. Detergjentët janë të pafuqishëm pa duart e saj e ato duar janë të pafuqishme pa kyçe të çlodhur. Kyçet çlodhen duke i masazhuar pak.

Me llërën hedhur mbi sy,si për tu mbrojtur nga drita, ajo pret. Llërët i ka të bardha e të ndjeshme dhe një prekje e lehtë rrëshqitur mbi sipërfaqen e tyre i ngjall dëshira gruaje krejt të papritura, marramendëse. Çlodhja do kapërcente llërët dhe urat e tyre të bardha do ta përcillnin prekjen në anën tjetër të ekzistencës, thellë, aty ku asgjë nuk është e dukshme si lëndë, por rrjedh si e tillë.

Kapakët e syve fillojnë të ndjejnë peshën e llërës. Nuk mund të flejë dhe as të pushojë. Paraditja e mundimshme kalon revan në çdo mbaresë nervore dhe zgjon ëndrra të cfilitura femërore. Ah, çon nëpër mend, ah të më krihte dikush flokët tani, këtë çast!

Ai lëviz pak, zhvendos shpatullën dhe rregullon trupin për t'u ndjerë më mirë. Sytë i janë qepur në gjumin e gjithnjëbehur, ndërsa dora e tij shtrihet poshtë dhe mbështetet mbi kofshën e saj e vakët, e kotë, e padëshirim. Ai kështu fle, në krah, në të shumtën e rasteve në krahun tjetër me kurriz nga ajo, e nëse jo në krah fillon të gërhasë. Lodhja fillon t'i verë gardh durimit e kështu, me duart e saj të holla ajo fërkon ballin e mandej tëmthat. Kujton se ai po e ndjek me vështrim, por asnjë lëvizje. Bishti i syrit kap në flagrancë gjumin e tij, gjumë lodhës e torturues.

Sjell ndërmend burrin e ëndrrës së saj dhe e di mirë se ai do kish bërë ndryshe…

Me të nuk do kishte asnjë dialog. Do të kish vajtur pas saj ndërsa mblidhte rrobat e lara dhe do t'ia kish hequr duart që andej. Do ta kish tërhequr ngadalë e pa zhurmë prej ballkonit, e aty, në dhomë brenda, sapo t'u ishin fshehur syve të fqinjëve, do ta kish marrë hopa e do ta shëtiste nëpër korridoret e dhomat e shtëpisë ashtu pezull, derisa ajo të qeshte e të qeshte e të thoshte mes të qeshurash "lëshomë, lëshomë se po më merren mendtë". Ai do ta çonte në shtrat e do t'i kërkonte të rrinte përmbys. Do fillonte t'i shtypte kurrizin, shpatullat, do t'i fërkonte supet e qafën. Po ndoshta do ta fillonte edhe nga shputat e këmbëve.

Gruaja lëviz ngadalë kokën. Sytë e saj trishtohen teksa kacavirren përgjatë kurrizit të tij e ajo më kot përpiqet të kujtojë pamje tjetër nga kjo. Nuk nervozohet e as lëndohet. Trishtimi merr trajtën e melankonisë dhe kalamendet nëpër arsyetimet se përse ai e bën këtë gjë ngahera. A thua vërtet t'i vijë keq kaq shumë për lodhjen e saj?! E nëse është kjo, përse kthen kurrizin?!

Ulet buzë shtratit dhe kujtohet duke mërmëritur instiktivisht se edhe këtë herë duhej të ishte aty për ta vënë në gjumë.

Ndrin në një qoshe të errët mendimore një e vërtetë e paditur deri më atëherë: ai e thërret atë sepse kështu qetëson ndërgjegjen dhe e ze gjumi i drekës më shpejt e më mirë! Burri i saj i vërtetë, ai të cilit ajo nuk do t'ia kish parë shpinën kurrë, do kish pritur derisa ajo të dremiste e mandej, ndoshta, do shkonte të përfundonte punën që ajo mund të kishte lënë përgjysëm.

Gruaja çohet. Një grua vjen dhe ikën nga shtrati për të kryer detyrat e saj. Çohet dhe vazhdon pa u lodhur, sepse nuk mund të shtrihet më aty ku kurrizi i një burri e lodh më shumë se punët e saj të pafundme...

Përbindëshi i horizontit gëlltit në pak sekonda portokallin e stërmadh. E befas, në gojën e tij bie pre muzgu. Gruaja pret errësirën si të vetmen mike që përfill nevojën e saj për të pushuar dhe për të biseduar me veten.

***

Nata e vonë përgjon makinat që mbledhin mbeturinat e ditës. E lodhur deri në dhimbje nga punët e pafund, ajo ulet buzë shtratit të saj të butë. Qëndron gjatë ashtu pa lëvizur dhe persiat copëza dëshirash nëpër ajër. E ndjeshme ndaj çdo lëvizjeje, gjendet vetëm me një hap jashtë, në ballkon. Kurrizi i rrugës reflekton dritë. Një dritë të çuditëshme pa emër burimi. Dritë dielli jo, dritë hëne jo, dritë dite jo, dritë nate jo. Ndoshta pikërisht ajo dritë e përsiatjeve të saj rreth shpresës. Në to, duke dashur t'i ikë natës, ajo kërkon fytyrën e Burrit të saj dhe psherëtin se po të kish jetuar shekuj më parë, do të ishte pranë Zeusit me tërë këtë dashuri perëndish në zemër.

Gdhin. Ai, sapo që hap sytë, nuk bën asgjë. Sikur të jetë i vdekur që merr frymë pa lidhje. Zgjat dorën me përtesë drejt gruas, e vendos mbi kofshën e saj në atë mënyrë dhe me atë lloj prekjeje që ajo e njeh fare mirë dhe e bën të kuptojë angarinë dhe mosdashjen. Aq më keq, kjo është dëshmia e tmerrshme se ai e di "detyrën" e vet. Ka harruar dëshirën. Kurrë nuk ndodh ta ledhatojë në kokë, t'i prekë flokët e t'ia rregullojë pas qafës, gjë që e bën atë të ndjehet në vëmendje. Sepse ku nuk ka dashuri, mënyrat humbasin rrugën…

Vjen mëngjes i artë dhe ajo përmendet. Shpina e tij vazhdon të flerë pa ndjerë ndriçimin e ditës, ndërsa ajo pret...

Të gjithë ne presim. Presim ditën tek vjen si një gjë e re, presim të shkojë nata si një gjë e vjetër, presim pastaj të vijë nata si një gjë e pazbuluar, presim të ikë dita si gjë e humbur rrugës pa shteg. Çdo gjë, çdo rast, çdo pamje, shfaqet e shndërruar në njëra-tjetrën. Rasti shndërrohet në gjë, gjëja në pamje, pamja në rast. Por asgjë nga këto nuk e thyen dot burgun e qelqtë të një gruaje…

DY TREGIME NGA LINDITA AGOLLI

Flamur ballkoni

1 ballkon, 2 ballkon, 3 ballkon, me lule e pemë mbjellë në vazo betoni të stërmëdha shtrirë përgjatë bordurave të tyre. Pastaj, 4 ballkon, 5 ballkon, 6, 7, 8 ballkon. Atje lart harbojnë viza të bardha, VIZA blu, flamuj të pakuptimtë kombëtarë, nuk di pse. Hijet e tyre valviten në një lojë gënjeshtare fasadave të pallateve ku bie dielli. Flamuj në ballkone, brenda shtetit të flamurit! Flamuj që i tregojnë kujt, cfarë, pa ndonjë interes prej kalimtarëve.

Përkundrejt, ballkoni im i zbrazët me ndoca vazo të zbrazëta në qoshe pas murit rrethues, vazo që presin ditën kur do mbajnë pakëz prej dheut të errtë e ndoshta ndoshta ndonjë lulezë të mbarë. Ballkoni im i heshtur e me çimento të zezë skaduar prej vitesh, papastruar, ballkon pa flamur! Po lulet, a kane flamur?!

Dhjetë metra më tutje, ballkonet përballë soditen pa asnjë mundim si në pëllëmbë të dorës. Vajza me fjongo të gjerë rozë që ia mban flokët pas, ndez dy qirinj. Hyn dhe del në verandë derisa shtron mirë për të ngrënë e, në fund, shoh të sjellë një poce qelqi si vithet e një gruaje të kolme. Lëngu i kuq duket të jetë verë e mirë, mjaft të parakalosh në kujtesë lëvizjet nazike me të cilat vajza shtron tryezën. Pastaj, përballë saj vjen e ulet një djalosh, fytyrën e të cilit nuk mund ta dalloj dot që këtej, anës sime. Ndizen neonët dhe rruga ndricohet paq, ndërsa më shumë se ato, në gjendjen time melankonike bëjnë dritë qirinjtë e darkës së dy të rinjve. Në katin lart, sipër tyre, vajza bjonde që fliste me zë të lartë, hynte dhe dilte me celular në vesh dhe hera herës shtyn me nervozizëm cepin e varur të flamurit. Përbri, në ballkonin fqinjë, një plak i trashë dhe krejt i bardhë, mbyll grilat. Lulet në ballkone marrin pamje trupash, flamujt heshtin mbytur si në vaj për humbjen e vizave blu, ndërsa unë sjell ndërmend qirinj ndezur atje, në vendin tim, për shkak të errësirës kaqshekullore. Instiktivisht ndez edhe unë tre qirinj.

***

Mëngjesi vjen me një përparëse amvise të lidhur ashtu, shpejt e shpejt. Marr për të panumërtën herë fshesën. Nga kati më sipër bien pambarimisht gjethe lulesh, pluhura, flokë e penjë përzjerë, gjithçfarë mbeturinash te ngrënësve vizablu, të atyre që nuk shkojnë dot më lart se katet e tyre. Sipër kokës sime valvitet flamur, nën këmbët e mia hargalisen plehra sjellë prej valëvitjeve të flamurit.

Mbaroj së pastruari dhe zilepsem pas ballkonit përballë, ballkon i stolisur për të cilin nuk paguhet asnjë cent. Për të gjorin ballkonin tim, nuk ka stoli. Pastolinë e tij e paguaj me gjysmën e rrogave të vogla që sjellin pas shumë mundimesh burrat e shtëpisë.

Nuk kam ç'bëj në këtë hapësirë të ngushtë e të vogël gërryese, gërryese si vetë boshësia. Mbyll dyert të mos më mbushet shtëpia me pluhur dhe filloj të vishem për të dalë. Më mirë një shëtitje në Park. Atje flitet kuptimshëm dhe nuk të shqetëson asnjë flamur. Atdheu flet të gjitha gjuhët, a, si të them, gjithë kombet flasin një Gjuhë, atë të Paqes.

Zheg mbi asfaltin e murrmë e hije të zeza zogjsh mbi asfalt ku këmbët herë zvarriten e herë hophopen si gjymtyrë deveje në shkretëtirë. Këtu dhe atje, shtrirë nëpër Athinë, gjinj të stërmëdhenj gruaje mbajnë mbi shpatet e tyre banesa të reja e të vjetra, banesa që zbythen nëpër të tatëpjeta ca duke i rënë njëra tjetrës në gjunjë si vajtim, e ca në këmbë si përulje,

Pallati im gjendet në majën e njërit prej gjinjve. Përtej, majë gjirit tjetër krekoset Akropoli i bardhë, ditën i pagjak, natën i shndrritshëm si hënë e gurtë. Teposhtë kodrës së asfaltuar më shoqëron gjelbërimi i portokalleve. Më pëlqen të eci nëpër këtë rrugë që më çon ngado; në parkun pranë shtëpisë, Parkun Kombëtar, në Muzeun e Madh Arkeologjik, Zara, Notos Galeri, Artisti Italiani, supermarketin A&B, te furra e bukës Athinaja, në lokalet rreshtuar pas njëra tjetrës.

Jam bërë manjake pas ballkoneve. Tashmë kam mësuar të dalloj ata me pronarë dhe ata me qera. Të parët ekspozojnë lule shumë dhe flamuj me viza blu. Të dytët magazinojnë objekte të çuditshëm - varka të shqyera si këpucë, flokë të ngatërruar si tela, thyerje e dhëmbë si dërrasa, shtrembësira si hekurishte, gjëra si tavolina a karrike, ndonjëherë argasje të nderura në tel si robe të porsalara.

Të parët, ballkonët me pronarë, ekspozojnë shpesh cigare në gishtërinj tekanjozë zonjash ndërsa të dytët po aq shpesh, fshehin në togun e argasjeve vraga duarsh e gërvishtje të thella llërësh prej punëve të rënda kurrë te paguara sa i takon.

Unë shkoj rrugës dhe ngre sytë. Kujtoj një flamur ngjyrë gjaku dhe mërmëris trishtim. Ky është vendi im i jetesës, por unë thjesht kështu kujtoj. E përherëshme është zemra e vendit tim, atje…atje larg… ku ruhen gjurmët e mia që prej lindjes e unë jetoj në zemrën e atij vendi përjetësisht. Brenda meje, një shpend flamuri, përpjek krahët ballkonit të mendimeve të mia.

Sipër kateve, një zonjë e rreshkur shpalos flamur te hekurosur dhe pastron gjethet e vyshkura të luleve. Vazhdoj të zbres. Në kthesë gjithnjë viza në flamur. Kam filluar ta pëlqej flamurin e ballkoneve dhe njerëzit e atij flamuri, madje mahnitem pas përkushtimit të tyre. Sikur ta bënim edhe ne këtë, mendoj pothuaj me zë. T'i donim aq shumë ballkonet tona. Ka që i duan. Por duan thjesht ballkonet dhe krekosjen në ta, lulet më pak, flamurin pothuaj aspak dhe askund.

Vështroj rrëmbimthi në të dy krahët me kujdesin të mos më shpëtojë asnjë ballkon nga vëmendja. Atje në të majtë, në katin e parë, gjithnjë më ka tërhequr shikimin një ballkon i gjerë, me dy ullinj të vegjël në të dy qoshet, hekurave rrethues të të cilit, një dorë e kudjesëshme ka thurrur një rrjetë ngjyrë druri, sic duket për të penguar depërtimin e diellit. Valvitet pranë ullirit në skaj, një flamur vizablu, krejt i ri dhe farfuritës. Dikur pata dalluar një grua të re të hijshme, me një përparëse të bardhë, tek ujiste lulet dhe pemëzat e ullinjve. Ja, përsëri qenka aty, ulur në tavolinë, duke ushqyer një fëmijë që mesa duket sapo ka filluar të flasë. Kaloj dhe ndjej të më ngazëllejë ajo grua e përkushtuar ndaj fëmijës, ndaj luleve, ndaj ballkonit me flamur. Tashmë kam harruar të shoh përreth, në mendje kam atë grua sikur të jetë shqiptarja ime, në sy pamjen e atij ballkoni, në shpirt një brengë për veten dhe flamurin tim. Eci pa kthyer kokën.

Pas shpinës sime dëgjohet zëri i lartë i gruas që i bërtet fëmijes me një shqipe të pastër, ndërsa andej këndej nëpër ballkone, gëlojnë flamuj vizablu sipas ritmit të tigujve të britmës...

SHKRIMTARI NASI LERA NDEROHET ME ÇMIMIN LETRAR "BEQIR MUSLIU" PËR VITIN 2021

Nga Emin Azemi

Juria në përbëre Ibrahim Kadriu (kryetar), Sadete Tërnava dhe Emin Azemi (anëtarë), nga një listë me tetë emra të mundshëm, zgjodhën sivjet për çmimin "Beqir Musliu", shkrimtarin e njohur nga Shqipëria, Nasi Lerën, duke u mbështetur në një varg veprash të tij të botuara, me të cilat e pasuroi dhe vazhdon ta pasurojë letërsinë tonë.

"Nasi Lera është ndër shkrimtarët tanë të rrallë që di pse shkruan dhe di çka shkruan; vepra e tij, është e lidhur me botën tonë; e shpreh këtë botë dhe i kthehet po kësaj bote nëpërmjet artit dhe të komunikimit artistik që nxit teksti poetik", vlerëson shkrimtari dhe studiuesi, Anton Nikë Berisha

Më datën 24, Gjilani pati festë letrare. Si çdo vit, edhe sivjet ky qytet juglindor i Kosovës, nderon shkrimtarët për të arriturat e tyre me çmimin të shquar letrar "Beqir Musliu'. Ars klubi me të njëjtin emër, i udhëhequr nga shkrimtari Sabit Rrustemi, po përkujdeset rreth ndjekjes së veprimtarisë letrare të krijuesve, duke identifikuar tek ata vlerat më të spikatura, që do të hyjnë pastaj në një përzgjedhje më të ngushtë për t'u vlerësuar me Çmimin e njohur letrar 'Beqir Musliu'.

Sivjet ky nder i takoi shkrimtarit dhe përkthyesit nga Tirana, Nasi Lera. Për ndarjen e këtij çmimi vendosi juria profesionale e përbërë nga Ibrahim Kadriu (kryetar), Emin Azemi dhe Sadete Tërnava (anëtarë).

Ceremonia e ndarjes së këtij çmimi u bë në Bibliotekën e qyteti të Gjilanit 'Fan Noli'. Të pranishëm ishin edhe familjarët e shkrimtarit Beqir Musliu.

Për të nderur laureatin e sivjetmë, kishte ardhur edhe kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili në një ceremoni të veçantë, i dorëzoi shkrimtarit nga Shqipëria, Nasi Lera, çmimin letrar "Beqir Musliu", i cili jepet për arritje të larta letrare.

Duke e uruar fituesin e sivjetmë, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se ky çmim bashkon sot dy cepa të tokave tona, ku kufiri akoma i ndan shqiptarët mes vete, por duke ecur përpara drejt një bashkimi. Zaten, theksoi ai, Sabit Rrustemi, tash e tridhjetë vjet, Gjilanit i ka dhëne epitetin një qendre kulturore dhe emrat sikur i juaji kanë bërë që ne, përmes shkrimeve shqip dhe në rasti tuaj, edhe përmes përkthimit të autorëve të mëdhenj, ta kuptojmë më mirë veten tonë, gjë që dëshmon se libri dhe dija mbeten gjithmonë kërkesë e jetës.

Duke e falënderuar poetin për gjithë kontributin dhe krijimtarinë e tij letrare, Haziri tha se në murin e çmimit të madh letrar 'Beqir Musliu', një çmim ky unik në Gjilan dhe Kosovë, tash e tutje do të jetë i vendosur edhe emri Nasi Lera.

Haziri nënvizoi se çmimi letrar 'Beqir Musliu' ngërthen në vete jo vetëm një gjini letrare, sepse ne kemi themeluar qendrën kulturore evropiane e cila në vete do të ketë bibliotekën, muzeun e qytetit, galerinë dhe institucionet e tjera kulturore, që do të ndërlidhen me emrin e Beqir Musliut, i cili Gjilanin e ka bërë krenar kudo ku flitet dhe shkruhet shqip.

Kryetari i Ars Klubit "Beqir Musliu", shkrimtari Sabit Rrustemi, duke u ndërlidhur me vlerësimet që u dhanë, në një prononcim për mediat tha se laureati i sivjetmë, shkrimtari dhe përkthyesi, Nasi Lera, paraqet një nder për qytetin tonë Gjilanin dhe një mirënjohje të madhe për letërsinë, e cila po njihet edhe më mire përmes vlerësimeve dhe kontakteve të drejtpërdrejta, siç po ndodh sivjet edhe me shkrimtarin Nasi Lera.

Shkrimtari Sabit Rrustemi evokoi kujtimet e viteve të hershme të rinisë prej kur ishte njohur me krijimtarinë letrare të Nasi Lerës në periodikun letrar të Kosovës, duke u shprehur i kënaqur që pikërisht klubi letrar që ai drejton sivjet po e vlerëson një prej prozatorëve më të veçantë të letërsisë shqipe.

KUR HYRA NË GJILAN PATA NDJESINË SE PO HYJA NË KORÇËN TIME

Nasi Lera

"Kur më lajmëruan se isha vlerësuar me çmimin "Beqir Musliu" përjetova një emocion të veçantë, emocion që e kisha përjetuar shumë vite më parë, kur u botua, në Prishtinë, romani im "Të jetosh kohën" dhe vëllimi me tregime "Dita e tretë".

"I nderuari z. kryetar i Komunës së Gjilanit, z. Lutfi Haziri, të nderuar anëtarë të jurisë së shpërblimit "Beqir Musliu" z. Ibrahim Kadriu, zonja Sadete Tërnava dhe z. Emin Azemi, të dashur djem të shkrimtarit të nderuar Beqir Musliu, më lejoni qe ta ndiej veten anëtar të familjes suaj. E ndiej veten shumë të nderuar dhe do ta ndiej veten edhe më të nderuar kur ju të vini në shtëpinë time ashtu si do vij dhe unë në shtëpinë tuaj, jo vetëm me libra por shpirtërisht... Kur hyra në Gjilan pata ndjesinë se po hyja në qytetin tim. Këtë nuk e them për t'u dukur se ja tani duhet thënë një fjalë e mirë, sepse

të kanë vlerësuar, jo; këtë e them sepse me të vërtetë e ndjeva sikur hyra në qytetin tim të lindjes, në Korçë, pasi kam lindur në Korçë. M'u duk e njëjta atmosferë, e njëjta ngrohtësi, dhe aq më shumë kjo atmosferë dhe kjo ngrohtësi m'u forcua edhe më shumë kur u takova me njerëzit që po më prisnin në hyrje të bibliotekës, kur u takova me kryetarin, nënkryetarin e komunës, kur u takova me drejtorin e bibliotekës etj.

Gjithmonë kam dashur të komunikoj me njerëzit, gjithmonë kam dashur të vij e të vizitoj Kosovën. Sidomos kur m'u botua romani dhe vëllimi me tregime. Doja që patjetër të vija në Kosovë, por ishte e pamundur; dëshira ime nuk varej nga unë; dëshira ime që të sendërtohej varej nga dikush tjetër mbasi të tilla ishin, si të thuash, ligjet që... i tillë ishte kufiri shtetëror që na ndante ne në Shqipëri dhe ju në Kosovë. Pavarësisht se ky kufi shtetëror nuk ndante kurrë dhe nuk ka për të ndarë ndonjëherë komunikimin e madh e të sinqertë shpirtëror që kishim me njëri-tjetrin, kështu që letërsia që zhvillohej këtu në Kosovë vinte në Shqipëri, po edhe letërsia që zhvillohej në Shqipëri vinte në Kosovë. Shpeshherë kam diskutuar dhe kam kërkuar edhe kur kam punuar në Lidhjen e Shkrimtarëve të Shqipërisë që asnjëherë të mos ndahej letërsia që zhvillohej në Kosovë nga letërsia që zhvillohej në Shqipëri, që asnjëherë të mos bëheshin krahasime kush është më e goditur: letërsia që zhvillohet në Kosovë apo letërsia që zhvillohet në Shqipëri. Të dyja letërsitë ishin një letërsi e vetme, ishin letërsi shqipe, ishin letërsi shqiptare dhe secila jepte kontributin e vet simbas tematikave dhe shqetësimeve krijuese që kishin vetë krijuesit me temën që ndesheshin në jetën e tyre të përditshme.

Më kujtohet që në Shqipëri kishte një mendim shumë të mirë për poezinë e poetëve që jetonin në Kosovë. Kështu mund të them se poezia e Ali Podrimjes, poezia e Azem Shkrelit, e Beqir Musliut, Agim Gjakovës (megjithëse Agim Gjakovën e kishim një kohë të gjatë në Shqipëri), Eqrem Bashës, Ramadan Musliut, Ymer Shkrelit, Ibrahim Kadriut, Sabit Rrustemit, Teki Dërvishit ishte një poezi e tillë që e ngriti edhe më lartë gjithë poezinë shqipe, që hyri dhe që zuri vendin që meriton në gjithë historinë e letërsisë dhe të poezisë shqipe.

Po kështu, krahas poetëve, një brez i fuqishëm prozatorësh i dhanë prozës shqipe peshën e rëndë të artilerisë letrare. Emri i Anton Pashkut, Nazmi Rrahmanit, Mehmet Krajës është i dashur për lexuesit shqiptar.

Kritika letrare është ndër zhanret më serioze dhe më të mprehta në mendimin shqiptar. Emri i Rexhep Qosjes, Sabri Hamitit, Mensur Arifit, Ali Aliut, Prend Buzhalës apo edhe e mikut tim Anton Nikë Berishës janë emra të cilët lexuesi u beson për thellësinë e mendimit dhe paanshmërinë e tyre. Në letërsi nuk hyhet me dhunë, në letërsi hyhet me mjeshtëri, talent, përkushtim, kulturë, mundim dhe nderim për të gjithë ata që kanë dhënë ndihmesën e tyre në lartësimin e emrit të letërsisë shqipe. Vetëm duke e nderuar njëri-tjetrin mund të nderosh emrin tënd. Vetëm duke u ndodhur pranë njëri-tjetrit mund të çash në shtigje të reja. Shtigjet e letërsisë janë të pafundme; është i lumtur ai krijues që zgjedh për të çarë shtegun më të vështirë, shtegun që ecën paralel me shtigjet e ndritur që kanë çelur të tjerët.

Ju faleminderit!"

Anton Nikë Berisha

NJË VEPËR E PASUR LETRARE QË PËRLIGJ NJË JETË NJERIU

"Shkrimtari Nasi Lera është njëri nga prozatorët tanë bashkëkohorë më të shquar. Me një varg përmbledhjesh me tregime dhe romane të botuara, ai e ngriti dhe e pasuroi prozën tonë nga rrafshe dhe aspekte të ndryshme.

Kur i qasësh dhe vendos ta vlerësosh veprën letrare të Nasi Lerës, atëherë mendimi i parë që të lindë doemos është se ajo është fryt i një pune dhe zotimi të vijueshëm për rreth 60 vjet; një krijimtari që në qenësinë e vet bën jetën e vetë autorit. Kjo krijimtari ka shkuar duke u pasuruar e duke u ngritur pikërisht në rrafshin e artit e të komunikimit që ka nxitur (shkaktuar) dhe nxit në vazhdimësi me marrësin.

Nasi Lera është ndër shkrimtarët tanë të rrallë që di pse shkruan dhe di çka shkruan; vepra e tij, është e lidhur me botën tonë; e shpreh këtë botë dhe i kthehet po kësaj bote nëpërmjet artit dhe të komunikimit artistik që nxit teksti poetik.

Kumtesën timen për veprën letrare të Nasi Lerës, i cili sot me meritë po e merr shpërblimin letrar "Beqir Musliu", e lidh, jo rastësisht me dy mendime të Ernest Hemiguejt.

I pari lidhet me botën që e përfton Nasi Lera përmes strukturës gjuhësore shprehëse, përmes gjuhës poetike. Bota e veprave të tij përafrohet me njëmendësinë (realitetin) ku jeton dhe vepron krijuesi, po përmes artit të mëvetësishëm ajo bëhet më e pasur dhe më e veçantë dhe me një mundësi ndikimi estetik të dukshëm. Shkrimtari i shquar, shkruante: "Në të gjitha tregimet e mia unë përpiqem të jap ndjesinë e jetës së vërtetë, jo thjeshtë ta përshkruaj jetën ose ta kritikoj, por faktikisht ta bëj atë të gjallë. Kështu që ti, kur të lexosh diçka timen, ta përjetosh me të vërtetë atë që lexon".

Kjo është një cilësi që i përshkon të thuash të gjitha veprat letrare të Nasi Lerës. Pra, ato nuk janë imitim i asaj që ndodh ose në jetën konkrete, po krijesa të mëvetësishme që ngrihen përmes shtjellimit të menduar dhe përmes gjuhës së zgjedhur, përmes një teksti të përpunuar, nga i cili dalin kuptime të shumta.

Teksti i tij nuk synon informacionin e rëndomtë, të thjeshtë, po shumësinë e mesazheve që nxitin përsiatje të ndryshme. Vepra e tij ngrihet mbi parimin e poetikës së Aristotelit: vepra letrare shqipton të mundshmen dhe të vërtetën artistike, që nuk është cilësi vetëm e veprave letrare.

Ndodh kështu për arsye se e mundshmja dhe e vërteta artistike ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për të dëshmuar imagjinatën krijuese dhe për të krijuar një botë sa të mëvetësishme, po aq dhe të vlefshme e të rëndësishme për pasurimin shpirtëror të marrësit.

Mendimi i dytë i shkrimtarit të madh, Heminguejt, ndërlidhet po ashtu me veprën që e ka krijuar dhe po e krijon ende Nasi Lera: "Kur të shkruarit bëhet vesi kryesor dhe kënaqësia më e madhe, vetëm vdekja mund t'i japë fund."

Natyrisht se kjo u ndodh krijuesve të mëdhenj, atyre që janë të lidhur ngushtë me krijimin e veprave të artit të fjalës, të nevojës që të komunikohet përmes artit me dukuritë e botës e të veprimit të njeriut dhe e pasurojnë atë nga brenda.

Veçantitë që i përmenda më lartë përligjen në mënyra të ndryshme qoftë në tregimet, qoftë në romanet e Nasi Lerës. Në të dy llojet letrare ai dëshmoi krijuesin që di si i qaset një objekti poetik, di si ta shtjellojë atë në mënyrën poetike, sidomos të dëshmojë kujdesin e madh që i kushton të shprehurit, përkatësisht gjuhës poetike, e cila kushtëzon në mënyrë të pandërmjetme komunikimin dhe ndikimin estetik.

Në qenësinë e vet proza e Nasi Lerës është një gjurmim i vijueshëm i dukurive të botës konkrete dhe i dukurive të botës së brendshme të personazheve, që dëshmohen në rrjedha të ndryshme të veprimit jetësor. Veçmas i shpreh shqetësimet, dramat dhe tragjiken që i cilësojnë dhe i përcjellin personazhet.

Këtë botë sa të veçantë e të ndërliqshme Nasi Lera e pasuron me romanet, ku bota e njeriut tonë shqiptohet në aspekte e në rrjedha të ndryshme dramatike, po njëherit përftohet një botë përmes tekstit, një botë poetike, e cila është më komplekse dhe më e qenësishme sesa nga ajo konkrete. Kjo botë e krijuar përmes artit të fjalës, ka atë cilësi dhe atë vlerë që ndikon fuqishëm estetikisht në marrësin dhe në përtëritjen e shpirtit të tij.

Nasi Lera e shqipton sidomos realitetin që ndërlidhet me botën e brendshme, ku fshihen dukuri nga më të veçantat dhe më misterioze. Këtë botë autori e vështron poetikisht në lidhje të ngushtë me rrethanat dhe kushtet jetësore. Pra, dramat që ngërthejnë personazhet në veprimin e përditshëm, janë shkaktari kryesor i dramave, i tragjikes dhe i pësimeve të brendshme.

Duhet thënë se këto dy bot njësohen mjeshtërisht në tekstin poetik, duke u shndërrohet në një botë të mëvetësishme. Në thelbin e tyre, këto dy botë përafrohen dhe bashkekzistojnë edhe atëherë kur i ndan koha, vendi, hapësira, edhe kur janë në pajtim ose në kundërshtim midis tyre.

Kjo strategji e rrëfimit poetik dëshmohet, fjala vjen,në romanin "Orët e qytetit të vogël", "Nata e premierës", "Të gjithë premtojnë Parisin" e të tjerë, ku shpaloset drama dhe tmerri i realitetit konkret të njeriut tonë, shpesh dhe vetëdija e tij e fjetur.

Një veprimtarinë e Nasi Lera, një vend me rëndësi zënë edhe përkthimet e shumë veprave të letërsisë botërore, përkatësisht përkthimet e shkrimtarëve nobelistë, si E. Heminguej, A. Kamy, J. Saramago, G. G. Marquez, A. Zhid, Le Clezio, M. V. Llosa, J. Kavabata, Kenzaburo si dhe të autorëve të mëdhenj si M. Kundërsa, M. Duras. M. Turnie, Akutagava, S. De Bavuar, M. Gallo, D. Merezhkovski etj.

Këto përkthime kanë vlerë të madhe jo vetëm për faktin se ato lidhen me disa nga veprat më të rëndësishme që u krijuan në fushën e artit të fjalës, letërsisë, po para së gjithash për përkthimin cilësor, për gjuhën e pasur poetike dhe të mënyrës së të shprehurit shqip", tha Anton Nikë Berisha, në fjalën e tij mbi krijimtarinë e shkrimtarit Nasi Lera.

Një vlerësim mbi krijimtarinë e Nasi Lerës, kishte dhënë edhe shkrimtari Besnik Mustafaj përmes një statusi në profilin e tij në FB:

"Një vlerësim plotësisht i merituar. Sapo kam lexuar edhe librin e tij te fundit me tregime "Vetmia e syve të qenit", një dëshmi tjetër e mjeshtërisë së jashtëzakonshme autoriale te Nasi Lerës. Juria e Çmimit "Beqir Musliu" ka nderuar edhe veten në këtë rast. Urime te përzemërta!, ka shkruar Mustafaj.

RAPORTI I JURISË PËR ÇMIMIN LETRAR VJETOR "BEQIR MUSLIU" QË SIVJET IU DHA SHKRIMTARIT NASI LERA

Sivjet për çmimin "Beqir Musliu", juria nga një listë me tetë emra të mundshëm, zgjodhën shkrimtarin e njohur nga Shqipëria, Nasi Lerën, duke u mbështetur në një varg veprash të tij të botuara, me të cilat e pasuroi dhe vazhdon ta pasurojë letërsinë tonë për të rritur dhe për fëmijë.

Siç dihet, për herë të parë çmimi "Beqir Musliu" i është ndarë poetit Ali Podrimja më 2004 dhe në vazhdim, nëpër vite, deri më sot janë nderuar gjithsej 14 shkrimtarë.

Shkrimtari Nasi Lera erdhi në Gjilan me një biografi të pasur letrare e intelektuale. Ai u lind më 20 shtator të vitit 1944 në Korçë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërkaq studimet i vazhdoi dhe i kreu në Universitetin e Tiranës. Fillimisht punoi mësimdhënës, më vonë redaktor në Radio e Televizionin e Tiranës, por edhe redaktor në Shtëpinë botuese "Naim Frashëri".

Duke qenë përherë i lidhur me letërsinë ishte edhe sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, por gjithherë aktiv në fushën e krijimtarisë origjinale e në përkthimin e një varg veprash të autorëve të shquar të letërsive të tjera.

Që nga vitet e gjashtëdhjeta Nasi Lera është krijues aktiv, duke bërë provën e parë me librin me titull "Bora e fundit"të botuar më 1972, për të vazhduar me dhjetëra e dhjetëra libra të tjerë: tregime, romane dhe përkthime. Pra, lista e botimeve të tij është mjaft e gjatë.

Me këtë rast po përmendim vetëm disa sosh, si për shembull vëllimet e tregimeve: "Era e pishave", "Sytë e dashurisë", "Duaje emrin tënd", "Ulërima e heshtur", "Tregime të zgjedhura" etj., romanet: "Gjaku i prillit", "Të jetosh kohën", "Ngjallja e diktatorit", "Të gjallë dhe të vdekur", "Sytë e Sofisë", "Vetmia e syve të qenit", "Treni ecën drejt bores "etj.

Në opusin e tij krijues janë edhe dhjetëra vepra të përkthyera të shkrimtarëve të njohu botëror.

Nasi Lera ka përkthyer shkrimtarët e njohur të letërsisë botërore: Fransua Sagan ("Martesa e Zhozesë"), Milan Kundera ("Vallësi i lamtumirës"), Gi de Mopasan(Vëllim me tregime),Gabriel Garsia Markez ("Gjenerali në labirintin e vet"), Jasumari Kavabati ("Gjëmimi i malit"), Isabela Alende ("Për dashurinë dhe hije"; disa vepra të Joze Saramaga, Albert Kamy etj.

Brenda veprimtarisë së tij janë edhe skenarët e filmave: "Duaje emrin tënd", "Të jetosh kohën", "Telefoni i një mëngjesi" e "Mëngjese të reja".

Për veprat e Nasi Lerës duhet thënë se ato cilësohen me një stil të ngritur e të pasur poetik dhe përshkohen me një ndjeshmëri lirike, prandaj çmohet ndër shkrimtarët më lirikë në letrat shqipe.

Veprimtaria e tij romanore përvijohet përmes një kategorie të tërë personazhesh, përmes një sfondit të gjerë të realitetit artistik që imponohet me kreativitet shumëdimensional. Opusi i tij i gjerë i tregimeve dhe i romaneve dëshmon për një individualitetin krijues të rëndësishëm si në llojllojshmërinë e dukurive të trajtuara, ashtu dhe në shtrirjen e atyre dhe në mesazhet poetike që ngërthejnë veprat e krijuara nga ky shkrimtar.

Me bindje themi se Nasi Lera vijon të mbetet një ndër personalitetet më të njohur dhe të respektuar nga lexuesi dhe kritika letrare për origjinalitetin e spikatur artistik, si edhe për kontributin e shumanshëm në lëmin e letërsisë origjinale dhe të veprave të përkthyera.

Mbështetur në atë që thamë për veprimtarinë e tij letrare, origjinale dhe të përkthyer, Nasi Lerës i jepet me plot meritë çmimi "Beqir Musliu" për vitin 2021", thuhet në raportin e jurisë, të cilin e parqiti shkrimtari Ibrahim Kadriu.

Shkrimet e vëllimit '*Vështrime Stilistike*' konfirmojnë vlerën dhe thelbin e brendshëm të këtij raporti, duke dëshmuar se sa thellë duhet të shkojë qasja e çdo studiuesi në interpretimin e veprës letrare. Të gjitha shkrimet, me tezat e reja, kundërshtojnë dhe provokojnë studiuesit e letërsisë.

SFIDAT E XHEVAT LLOSHIT NË INTERPRETIMET E DISA VEPRAVE LETRARE

Nga Floresha Dado

Për herë të parë vjen një përmbledhje shkrimesh (që kanë peshën e studimeve shkencore) ku lexuesi do të befasohej për teza që u kundërvihen trajtimeve të deritanishme të studiuesve dhe kritikëve letrarë mbi vepra të letërsisë sonë. Madje ka teza që 'trondisin' këtë opinion interpretues, të krijuar prej dekadash në mjedisin tonë shkencor. Nuk është fjala për fshirje vlerash...por për kuptime të reja, për përmbysje kuptimesh mbi specifika të veprave të spikatura të letërsisë sonë, duke nisur nga *Meshari* i Buzukut dhe autorët e shek.XVI e në vazhdim, deri te shkrimtarët më të shquar të gjysmës së parë të shekullit XX. Vetëm një ndjeshmëri e veçantë për letërsinë dhe nervi i një studiuesi të fjalës në ligjërimet e ndryshme të saj, mund të bënte që një gjuhëtar (stilisticien) të zhytet thellë në strukturën e brendshme të krijimit letrar dhe ta interpretojë atë, jo vetëm me parime e kritere shkencore, por edhe me ndjeshmërinë dhe ngjyrat e një ligjërimi mbreslënës. Gjuhëtari i njohur Xh.Lloshi në një farë mënyre befason, shfaqet i veçantë si studiues i letërsisë, duke i dhënë vlerë lidhjes së ngushtë të shkencës së gjuhësisë me studimin letrar. Kjo lidhje ish konfirmuar që me Formalistët Rusë, Shkollën e Gjenevës, tezat e De Sosyrit, Strukturalizmin, etj. por, në praktikën tonë të interpretimit të letërsisë marrëdhënia midis dy shkencave, që kanë objekt studimi fjalën (në funksionet e ndryshme të saj), përgjithësisht është konceptuar më shumë formalisht dhe këto dy shkenca pothuajse mbetën të ndara secila në objektin e vet...Shkrimet e vëllimit '*Vështrime Stilistike*' konfirmojnë vlerën dhe thelbin e brendshëm të këtij raporti, duke dëshmuar se sa thellë duhet të shkojë qasja e çdo studiuesi në interpretimin e veprës letrare. Të gjitha shkrimet, me tezat e reja, kundërshtojnë dhe provokojnë studiuesit e letërsisë.

Metodologjia e studimeve

Është shtylla që mbështet konceptet bazë të studiuesit, që orienton raportin e tij me veprën letrare. Mendoj se parim i rëndësishëm i metodologjisë së studimit të letërsisë prej Xh.Lloshit është largimi nga pohimet e karakterit të përgjithshëm, me epitete... dhe zhytja në strukturën e brendshme për të provuar, me koncepte dhe analizë shkencore, pse x-autor është poet i madh, pse y-autor është përkthyes i shquar etj. Parimi metodologjik se 'thellimi te e veçanta shtron rrugën për përgjithësime më të hapta', përqendrimi te teksti, vështrimi gjuhësor/stilistik jo thjesht në aspektin teknik që varfëron ndjenjën, emocionin, depërtimi në thelbin e brendshëm të shkakut për shembull të stilit satirik, shpotitës, humorit përqeshës deri agresiviteti i hapur (F.Konica...) zgjojnë vemendjen për mënyrën e qasjes shkencore. Boshti i nënkuptuar në konceptin e një punimi shkencor mbi tekstin letrar të Xh.Lloshit është edhe : duhet shkruar për një autor apo për një vepër letrare atëhere kur qasja sjell një kuptim origjinal, specifik, të pa thënë më parë, qoftë edhe nëse ky interpretim është i ndryshëm nga rezultatet e deritanishme.

Duke lexuar me kureshtje shkrimet e këtij vëllimi arrij në konkluzionin se tre janë tiparet themelore të metodologjisë së këtij autori : a) Njohja, pothuaj në mënyrë shterruese, e studimeve të mëparshme mbi veprën që interpretohet rishtazi. b) Sjellja e fakteve të reja, si rezultat i kërkimeve arkivore dhe bibliografike. c) Qasja stilistikore/ligjërimore në interpretimin vetiak, nisur nga pesha e fjalës në letërsi... Mbi bazën e këtyre aspekteve, thelbësore për çdo studim shkencor, autori shkon natyrshëm, dhe me kokëfortësi, drejt përvijimit të kuptimeve të reja, drejt kundërshtimit të interpretimeve të bëra deri tani, drejt polemikave shumë serioze, por korrekte, me një numur të madh studiuesish të letërsisë, shqiptarë apo dhe të huaj. Kështu, sipas tij, mbështetur në shqyrtim semantik, stilistik e tekstor, leksiko-gramatikor dalin veçori të pavëna re më parë që ndryshojnë disa përcaktime, për të ardhur, për shembull, në pohimin se *Meshari* nuk është përkthim liturgjik fetar, se është larg nga një tip i tillë kanonik, se Buzuku bëri një libër fetar shqip, duke qenë 'idealisti i parë i librit shqip, i gjuhës shqipe'. f.300 Vjen ndryshim, gjithashtu, në interpretimin e deritanishëm të simbolit të *Fyelli*-t (N.Frashëri), duke u nisur nga teksti dhe jo parateksti (Rumiu), madje duke marrë si paratekst poezinë *Fjalët e qiririt*. Depërtimi në thelbin e brendshëm sjell pohimin : 'qiriu është simbol dhe fyelli krahasim, se qiriu vjen si metaforë, si njëjtësim nga ngjashmëria, kurse fyelli si metonimi, si ngjashmëri pa njëjtësim, por me pranëvënie.'f.28. Përballet kështu një interpretim i ri i dy poezive.

Kërkimet arkivore dhe njohja e literaturës shkencore të deritanishme u japin shkrimeve të Xh.Lloshit vlerën e zbulimeve thelbësore mbi personalitetin e autorit. Të dhënat rreth biografisë së Kristoforidhit, të aktivitetit të tij botues, depërtimi në strukturën e *Gjahu i malësorëve*, duke hapur diskutim për karakterizimin gjinor (e quan 'skeçi i parë shqip, ndërkohë që në tekstet shkencore është përcaktuar si 'më i vjetri tregim i prozës artistike'). Por, për herë të parë pohoet se ky krijim i K.Kristoforidhit ka një trajtë të pazakontë, ku ndërthuren tri forma letrare: skeçi, proza dhe ndërhyrjet e autorit në shpjegimet që jep për shqiptarët...Argumentimet e Xh.Lloshit për këtë specifikë gjinore si dhe synimet e këtij krijimi, të veçantë në llojin e vet, përbëjnë një interpretim origjinal në studimet tona..

Në tezat e reja që sjell, si në analizën e poezisë *Marshi i Barabajt* (F.Noli), apo të veçantën e *Lirizmit të lirikut L.Poradeci*, apo *Dy gjedheve stilistike të Fishtës* studiuesi ndërton një strukturë krejt të veçantë të kuptimit të krijimeve poetike. Kështu poezinë e Nolit nuk e sheh thjesht si shkrim me tingëllim biografik, por si një përpjekje për 'sublimim poetik të vetvetes', 'si një përfytyrim i Fan Nolit nga poeti Fan Noli'. Sipas autorit të studimit "Noli kërkonte që jeta e tij të mbetej në një lexim universal, mitologjik, sublimues për arratinë e tij. Kërkonte një fitore artistike përkundër një disfate politike" f.93, dhe në këtë mënyrë studiuesi kundërshton të gjithë interpretimet që e kanë lidhur këtë poezi, por edhe të tjera, me 'hesapet politike'. Qasjet origjinale ndaj figurës së Nolit i ndeshim edhe kur synon të shpjegojë shkencërisht përse Noli ishte një përkthyes i shquar dhe sekretin e gjen në katër aspekte themelore : a) në raportin e ngushtë që krijon përkthyesi me veprën që përkthen, b) në raportin e veçantë që vepra duhej të krijonte me lexuesin; c) në përjetimin e roleve të personazheve si një aktor dhe d) në përpjekjen që teksti i përkthyer të tingëllojë bukur. Është një përgjithësim i veçantë dhe origjinal ideja se kur përkthente Noli nuk kishte përpara një tekst, por një pamje njerëzore të shndërruar në një tekst.

Ndërsa lidhur me disa teza kontradiktore që janë shfaqur në kritikën letrare për poemën e Gj. Fishtës. Xh.Lloshi ndjek dy burimet që ushqyen poetin : krijimet epike të letërsisë greko-latine e deri në krijimet e kohëve më të reja evropiane, si dhe eposi i kreshnikëve, pra gjedhja folklorike. Mbi 15 raste të dukurive poetike konstatohen në këtë punim për të provuar ndryshimin e ndikimit të gjedhes folklorike, apo tek satirat, ku ndihen ndikimet e satirave të antikitetit çka reflektohet edhe në natyrën më artificiale të këtij lloji poetik. Ndryshe nga pikëpamjet që janë shprehur nga studiues e kritikë, sipas Xh.Lloshit në letërsinë e asaj periudhe 'poema epike (jo folklorike) ka dështuar, nuk ka arritur të ndërtohet as me dy veprat e mëdha të N. Frashërit e të Gj. Fishtës dhe as me krijimet e arbëreshëve të Italisë. (123). Referimet me qasje kundërshtuese ndaj studiuesve që kanë shkruar për lirizmin e Lasgushit janë të shumta, si G.Petrota, K.Maloku, E.Çabej, R.Qosja,... Shpesh kritika bëhet e ashpër... Autori njeh mirë interpretimet e studiuesve të shumtë të Lasgushit, zbulon kontradiktat dhe kundërshtitë midis tyre; ndërkohë që, nga ana tjetër, kundërshton disa trajtime të deritanishme. Gjithashtu, duke marrë në shqyrtim mjetet shprehëse stilistike të poezisë lasgushiane, vjen në tezën që pranimi i lirizmit, si ligjërim i veçantë stilistik, kërkon patjetër zbërthim edhe të ligjërimit vetiak të poetit (prandaj krijon termin 'lirizëm lasgushian'), madje propozon idenë që koncepti i lirizmit duhet të zgjerohet edhe në nivelin e teorisë. Në specifikimin e tipareve thelbësore të lirikës lasgushiane autori e sheh këtë origjinalitet te ndryshimi i trajtave morfologjike, te shndërrimet fonetike të fjalëve, te zgjerimi i neologjizmave,

te ndërtimet e larmishme sintaksore, te një lloj mjegullimi i kuptimeve që së bashku krijojnë harmoninë e përsosur. Të gjitha këto i quan përpjekje për eksperimentim, si tipar themelor të një poeti të vërtetë.

Siç e thashë më parë, njohja e rezultateve të studiuesve të tjerë është parim i rëndësishëm i metodës kërkimore të autorit i cili, mbas ballafaqimit të drejtpërdrejtë, shkon në teza të reja lidhur me "rrëfenjësin Mitrush Kuteli". Në kundërshtim me shumicën e studiuesve autori veçanësinë e prozës së Kutelit nuk e gjen te përpunimi i prozës tregimtare, ose folklorizmi. Për të provuar pikëpamjen e tij vëzhgon disa tipare themelore që karakterizojnë folklorin gojor, të cilat Kuteli jo vetëm nuk i ka shfrytëzuar, por, përkundrazi i gjen krejt ndryshe te ky prozator. Kështu vjen konkluzioni se 'vepra e Kutelit nuk është nisur nga folklori, edhe kur shfrytëzon mjetet e tij, ajo është krijim i mirëfilltë i letërsisë artistike të kultivuar, i nisur nga rrëfimi gojor, madje-sipas tij-ajo i dha formë të plotë një stili të prozës së kultivuar.' Kjo tezë shtjellohet përmes krahasimit dhe dallimeve midis përrallës dhe prozës së Kutelit. Sipas tij folklori nuk është objekt dhe burim parësor. Rrëfimi i Kutelit nuk është folklori, por tip i ligjërimit të folur, sepse nuk përfton vepra që pastaj rrëfehen gojë më gojë... Pra kemi një tip rrëfimi artistik. Me këto pohime Xh.Lloshi zhvillon një qasje më specifike; jo vetëm kundërshton trajtimet e deritanishme, por i jep përmasë tjetër vlerës së rrëfimit kutelian, duke e drejtuar vemendjen në çeshtjen thelbësore të ligjërimeve të ndryshme stilistike. Krahas kësaj saktëson terma të përdorur nga studiues të ndryshëm. Duhet thënë se një ndër parimet metodologjike të Xh.Lloshit është se autorët e interpretuar i sheh jo të shkëputur, por në procesin e zhvillimit të trashëgimisë letrare. Por, mbi të gjitha, vëmë re se si tipar thelbësor metodologjik në studimin e veprës letrare Xh.Lloshi ka depërtimin në *strukturën ligjërimore* t*ë tekstit*, raportet e brendshme të aspekteve thelbësore të saj.

Metodat e interpretimit

Në vartësi të konceptit metodologjik mbi studimin e tekstit letrar në shkrimet e Xh.Lloshit shfaqet natyrshëm shfrytëzimi i disa metodave. Sigurisht metoda bazë e këtij stilisticieni në interpretimet e veprave letrare është ***metoda stilistikore,*** e cila nuk skematizohet, nuk kthehet në numeracion e konstatime të zakonshme. Si njohës i objektit të stilistikës ai kupton dhe 'sheh' funksionet e brendshme të fjalës poetike, ka aftësinë t'i shmanget varfërisë dhe skematizmit të interpretimeve të fjalës, vënë re në disa shkrime të mëparshme. Në teoritë letrare moderne u bë e qartë se gjuhësia ishte disiplina më e rëndësishme që ndihmoi zhvillimin e teorisë letrare, sepse ishte edhe vetë teoria gjuhësore që mori një karakter të veçantë…. Mbi baza teorike të reja studiuesi kërkon lidhjet midis niveleve të gjuhës, duke synuar zbulimin e tipareve specifike të strukturës së çdo teksti si dhe tiparet individuale të përmbajtjes së tij. Autori synon të depërtojë në marrëdhënien midis funksionit simbolik të fjalës dhe funksionit emotiv të saj dhe, mbi bazën e kuptimit të shtresave të brendshme kuptimore që rrezatojnë figurat, fjala poetike, ai përmbys pikëpamje mbi poezinë e disa autorëve, zgjeron qasjen ndaj tyre. Si reflektim i parimeve të tij metodologjike vjen origjinale edhe ***metoda krahasimtare***: krahasim dhe analizë e disa përqasjeve midis përftesave të poemës së Fishtës me eposin homerik, apo prozës së Kutelit me krijimin popullor, krahasimi i ligjërimit të Asdrenit me Naimin, ku zbulohen si ndryshimet ashtu dhe i njejti shoqërim tematik i fjalëve, plani krahasimtar edhe midis dy poezive të të njejtit autor, si te Naimi apo Asdreni, etj. Pohimi i guximshëm, sipas të cilit 'të shkarkoj Naimin nga ligjërimi patriotik shqiptar dhe nga ligjërimi filozofik-persian, ta mënjanoj Naimin e ndërtuar prej kritikës, për të parë Naimin e ndërtuar prej Naimit në tekstin e vet'(38) shprehin origjinalitet dhe ndërmarrje të guximshme të studiuesit, që, gjithsesi, synon krahasimet e brendshme të fjalës poetike dhe raportet e veprës me procesin e brendshëm krijues. Ky proces krahasimtar sjell në vëzhgimet e Xh.Lloshit teza të reja, kuptime të reja mbi dukuritë letrare, jo rrallë mbi bazën edhe të ***qasjes intertekstuale.***

Në interpretimin e stilit të prozës *Bukuria* q*ë vret* analiza stilistikore mpleket thellë me ***analizën semiotike***; vëzhgimet e hollësishme, futja në kuptimin e brendshëm të motivit, të simbolikës letrare, bëhen përmes ndërtimit origjinal të një strukture të veçantë të analizës. Si rezultat i rendjes brenda kësaj strukture studiuesi e sheh prozën e Migjenit si një pikturë, si një skulpturë…Nga vëzhgimi i figurave migjeniane studiuesi zbulon një muzikalitet, ritëm të brendshëm ndërmjet grupeve ligjërimore. Tri rrathët stilistikë të fjalë (jeta, vdekja, bukuria), të përcaktuar prej tij, kanë sjellë një tjetër vëzhgim origjinal : sipas tij, në planin linear të prozës, pra në sipërfaqe, stili është lirik, me ngjyrim impresionist, por 'përmbajtja e fjalëve lirike është tragjike' (255). Një pohim, në dukje i çuditshëm, por që shpreh thelbin e ngarkesës emocionale që përcjell kjo prozë te lexuesi.

Qasja stilistikore dukshëm kalon në ***teorin***ë ***strukturaliste t***ë ***strukturës shtresore***. Në hetimin e tre niveleve të strukturës poetike të vjershës *Vjeshta* të Asdrenit: aspektet fonetike, morfologjike dhe sintaksore, analiza e Xh.Lloshit zgjeron vëzhgimin e raporteve të strukturës kuptimore, duke dhënë orientimin e rëndësishëm që interpretimi i një teksti letrar nuk është thjesht praktikë gjuhësore e aplikuar, por një organizim i ndërlikuar gjuhësor, kuptimor dhe i shprehësisë estetike.

Analiza stilistikore e nxit studiuesin të ndërtojë *imazhin*

poetik në poezinë *Marshi i Barabajt,* ku ***metoda impresioniste*** vjen paksa e papritur për stilin e një gjuhëtari.. Gjithnjë në polemikë me përcaktime të studiuesve të tjerë, studiuesi shpreh bindjen se efektet muzikore janë pjesë thelbësore e artit poetik, deri në atë shkallë ku në disa rryma letrare ana muzikore e shpërfill tërësisht semantikën. Metoda e qasjes impresioniste është po aq interesante edhe në interpretimin e poezive të Asdrenit, ku herë duket sikur studiuesi ka përpara një pikturë, në lëvizje. Kjo ndjeshmëri kritiko-letrare theksohet më tej në rastin kur studiuesi e interpreton vjershën *Vjeshta,* jo vetëm si pikturë e gjallë por edhe vetë interpretimi i tij sikur krijon një pikturë. Qasje të tilla krijojnë për herë të parë një përjetim ndryshe të stilit asdrenian.

Pra, vemë re se Xh.Lloshi depërton si studiues specialist në thelbin e ligjërimit letrar, dhe, si pasojë, në mënyrë të natyrshme i është drejtuar edhe metodave të tjera. Kjo ka logjikën e vet : duke qenë se letërsia është arti i fjalës, me marrëdhënie të pafundme në plan linear dhe atë vertikal, me aftësinë e shumkuptimshmërisë, me shtresat e brendshme të mendimit dhe emocionit vetëvetiu vijnë mënyra të ndryshme të qasjes tek ajo. Por, e veçanta e këtij vëllimi me shumë interpretime është ***kundërvënia***, kundërshtimi i pikëpamjeve të shumë studiuesve. Madje zakonisht çdo shkrim që në fillim paralajmëron një ose disa kundërshti. Nuk kemi ballafaqim me një apo dy studiues, por përgjithësisht me disa studiues të njohur dhe me kontribute në shkencën dhe sidomos kritikën letrare. Përballë të gjithëve ! Kjo dukuri, jo e zakonshme në mendimin tonë kritik-letrar, ngjall jo thjesht kureshtje, por vemendje të përqëndruar, verifikim dhe përballje të re me vepra të traditës sonë letrare.

Rast tipik i lidhjes së gjuhësisë me shkencën mbi letërsinë

Interpretimet e Xh.Lloshit mbi vepra të shquara të traditës sonë letrare, ndonëse nuk janë me numur të madh faqesh, kanë peshën e studimeve të rëndësishme shkencore, sepse nuk janë vlerësime standarte, që i kemi hasur në shumë e shumë shkrime, dhe se sjellin teza të ndryshme. Analizat e këtij studiuesi janë përmbysje interpretimesh, janë provokim për kuptimet e propozuara më parë, janë modele të një koncepti tjetër të analizës, janë praktikë studimore e shkrirjes së dy shkencave : i marrëdhënies së *shkencës së gjuhës (fjalës)* me shkencën e *kuptimit artistik të fjalës*. Realizimi i kësaj marrëdhënieje në strukturën e brendshme të tekstit e ka çuar Xh.Lloshin, për shembull, në konkluzionin se specifika e stilit të Konicës del më dukshëm në rrafshin letrar se sa në rrafshin gjuhësor, ndonëse studiuesi është thelluar në çështje të reja si kontributi në europianizimin stilistik të shqipes së shkruar, në etimologjizimin e përftesës stilistike, në atë që e quan 'stili skajshmërisë', në ritmin e brendshëm që krijojnë figurat stilistikore etj. Duhet thënë se veprat dhe autorët, për të cilët shkruan Xh.Lloshi, janë nga më të shquarit në historinë e letërsisë sonë, rreth të cilëve janë shkruar aq shumë studime dhe vlerësime kritiko-letrare. E megjithatë, gjuhëtari që shfaqet edhe si studiues i letërsisë me intuitë jo të zakonshme, i rimerr, për të sjellë kuptimin e vet origjinal, duke polemizuar, kundërshtuar mjaft studiues të tjerë. Ka raste kur gjuhëtari e mbizotëron kritikun letrar, si në rastin e krahasimit të dy botimeve të *Historisë së Skënderbeut* të F.Nolit. (1921 dhe 1950). Nëpërmjet vëzhgimeve të hollësishme si gjuhëtar/stilisticien lidhur me ripunimet gjuhësore e stilistike të botimit të dytë ai sjell për herë të parë katër anë kryesore të zhvillimit të gjuhës letrare të shkruar, ku shquan bashkëveprimi ndërmjet varianteve letrare të shkruara, qëndrimi largues i Nolit nga tradita e vjetër lerare dhe përpunimi i gjuhës së shkruar letrare, duke u diferencuar nga gjuha e folur. Këto konstatime, ndonëse përgjithësisht i përkasin sferës gjuhësore, shprehin specifikat e përpunimit të fjalës artistike.

Provokime për ndryshime në Historinë e Letërsisë dhe në Enciklopedinë shqiptare.

Thamë më sipër se ndër tre burimet thelbësore që kanë nxitur kundërshtim dhe teza vetiake të Xh.Lloshit është zbulimi i fakteve të reja si rezultat i kërkimeve arkivore dhe bibliografike. Rasti më i dukshëm është shkrimi kushtuar dramave të Sami Frashërit. I gjithi një befasi, një ndërtim tjetër i trashëgimit letrar…Hidhet poshtë mendimi që ka zotëruar në historiografinë letrare shqiptare se Samiu shkroi dy vepra (dramën *Besa* dhe romanin *Dashuria e Talatit dhe e Fitnetes*) ; jepen të dhëna të reja për tre drama të tjera, të përkthyera, si dhe për disa dorëshkrime.(Dramat *Sejdi Jahjai*, *Farkëtari Gjave*, *Ndërgjegjia.)* Studiuesi hedh poshtë mjaft interpretime diletanteske, të politizuara, për dramën 'Besa'. Të dhëna me interes janë fakte që ndriçojnë historikun e jetës publike-skenore të dramës, ka shumë informacione për jehonën e saj, në organe të shumta që shkruan për të nga 1901 deri 2013, për interpretimet e bëra nga autorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit. Me interes të veçantë janë sqarimet e konceptit të Samiut mbi raportin histori-vepër. Këto të dhëna, dhe të tjera, provokojnë dilemën e domosdoshmërisë së ndryshimeve që mund të bëhen, si në *Historinë e letërsisë shqiptare*, ashtu edhe në zërin përkatës në *Enciklopedinë Shqipare*. Po kështu, në shkrimin kushtuar Frang Bardhit, mbi bazën e të dhënave historike, albanologjike, Xh.Lloshi shpreh kundërshtitë e tij për karakterizime nga studiues të huaj, analizon *Fjalorin* e Bardhit duke ndryshuar kuptimet e tij, përcakton tre tipare themelore të veprës, jep të dhëna interesante mbi botime-fjalorë të autorëve të huaj në vende të ndryshme, etj. Sigurisht edhe këto fakte, që ndryshojnë ç'është thënë deri tani, mund të ndikojnë në rishikimin e kapitullit përkatës në Historinë e Letërsisë sonë. Në përgjithësi, tezat e Xh.Lloshit mbi shumicën e teksteve që analizon, mund të diskutoheshin për të gjykuar objektivitetin shkencor të tyre, nëse do të duhej të reflektoheshin në dy tekstet madhore të letërsisë dhe kulturës shqiptare…Pyetja që del është : a janë të pranueshme tezat e tij për të reflektuar ndryshime kaq të rëndësishme ?

Serioziteti i një studiuesi shfaqet në korrektësinë e referimit shkencor, në dhënien e **bibliografisë** së studimevet, kritikave me të cilat polemizon studiuesi. Bibliografia përkatëse në fund të çdo shkrimi e bën më të lehtë ballafaqimin e studiuesve të tjerë me interpretimet e deritanishme përballë tezave të reja, krejt të kundërta, të gjuhëtarit, që në këtë vëllim shfaqet si një specialist i studimit të letërsisë.

* * *

Pooor…A mund të themi se të gjitha interpretimet e studiuesit Xh.Lloshi janë të pranueshme ? Natyrshëm do të vinin reagimet e disa studiuesve të tjerë… Kjo nuk ka asgjë të keqe. Përkundrazi ! Dimë se jo vetëm lexuesi i zakonshëm, por edhe lexuesi i specializuar, ka mënyrën individuale të përjetimit dhe përfytyrimit letrar. E rëndësishme është që ky përfytyrim të çlirohet nga skemat, klishetë e rrënjosura prej interpretimeve të mëparshme si dhe prej subjektivizmave të sipërfaqshëm. Letërsia asnjëherë nuk i ka shteruar domethëniet artistike të ndërlikuara të saj, mënyrat e ndryshme të përjetimit dhe interpretimit nga studiuesit, në kohë dhe hapësira të ndryshme.

Duhet të them se veprat letrare dhe risitë që Xh.Lloshi sjell në interpretimet mbi to janë më të shumta se ato që referova në këtë shkrim… E rëndësishme është se në këtë vëllim me studime mbi tekste letrare nuk kemi subjektivizmin e një lexuesi të zakonshëm, por kuptime, mbikuptime të një specialisti të ligjërimeve, pra dhe të ligjërimit letrar…Kjo ka peshën e vet… Xh.Lloshi është *studiues i lirë,* me vëzhgime të vetat, të cilat, brenda subjektivitetit të natyrshëm, ngrihen përgjithësisht mbi koncepte dhe parime shkencore. Prandaj interpretimet e tij e venë në mendime studiuesin e letërsisë, i cili, ose do të bjerë dakort, ose do të hapë një hapësirë tjetër të debatit shkencor. Ndoshta është koha që rivlerësimet mbi letërsinë tonë të ngrihen mbi një bazë metodologjike më të qartë, të çliruara nga kuptimet e ngulitura gjatë pothuaj një shekulli në studimet dhe kritikën tonë letrare. Xhevat Lloshi guxon, provokon …duke nxitur mendimin e ri dhe të hapur në shkencën mbi letërsinë.

Rreth romanit "Mbi tokën e ngushtë" të Thanas Dinos

NJË GJIROKASTËR SA ÇUDANE AQ DHE E ËMBËL...

Nga Josif Papagjoni

Jemi miq të vjetër me Thanas Dinon. Mall kam tek takohem me të. Dhe rrjedh vetiu biseda si në një virua. Letërsi, letërsi, por edhe pak aventurë jete, pak politikë, pak gazetari, doemos dhe shaka. Thanasi qesh shumë. Qesh me idiotësitë e njerëzve. Me kokëshkrepjet. Por edhe bën pyetje shumë. Ka një shpirt sa shpotitës, aq dhe të ndezur nga kureshtja. Një poet e shkrimtar fisnik, që e lidhi jetën me Gjirokastrën e tij, u bë bard i saj, i respektuar gjithkund. Unë kam shkruar për disa nga romat e tij si "Shenja e shenjtë", "Mesi", "Fshati i prerë", që i çmoj të bukur dhe domethënës, të cilësisë letrare më të mirë, sidomos dy të parët. Por ai ka shkruar afër 10 romane. Në publicistikë ka botuar gjer tani 16 tituj librash, një pasqyrë e kronikë ngjarjesh, pesonazhesh, historish njerëzore, që të ngopin me informacionin e tyre të bollshëm dhe qasjet e veçanta. Zeja e tij si gazetar rreth 50 vjet ka ndikuar jo pak edhe në shkrimtarinë e tij. Unë e shoh këtë në dëshirën që Thanasi ka për të krijuar tablo portretesh, bëmash, historish çudane (shpesh). Andaj dhe ty syrin ta rrëmben te ky roman blloku i gurit. Por teksa largohesh paksa prej atij blloku guri (portreti, bëma, historia), ja ku dallon murin; largohu dhe ca, ja ku dallon mëpastaj kështjellën hijerëndë, kalanë impozante. Kjo është një teknikë e sofistikuar dhe shumë e vështirë e të shkruarit. Thanasi, mund të them, ia ka marrë dorën për bukuri, është bërë një usta i kësaj lloj narrative: qendis detajin dhe i jep frymë tablosë.

Romani "Mbi tokën e ngushtë - vite nga dhjetvjetshi i parë" i Thanas Dinos është i tipit të tablosë, pa atë modelin klasik tradicional të një personazhi që bëhet strumbullari i lëndës, qofshin edhe disa syresh, në funksione kompozicionale të ndryshme, por që ecejaken në fatet e ndërsjellta. Dhe duke qenë roman tablor, ai e rrok lëndën si në një tërësi, në rastin tonë në dy kahe, atë historike dhe atë letrare psikologjike. Duket sikur je diku në një pikë të epërme dhe e sheh çdo gjë nga lart, për shembull sikur je në Kala apo në Kocull dhe e kundron Gjirokastrën, domethënë njerëzit dhe bëmat e tyre, që andej. Gëlojnë këta njerëz-personazhe në ato rrugë të ngushta, të pjerrta e të kalldrëmta, kredhur në shtëpitë e tyre, mbuluar me rasa guri gri, në vrapin e çmendur të përmbysjeve të mëdha të fillimviteve '90, ashtu të hutuar, të shastisur nga befasitë dhe shpejtësitë e ndryshimeve pa rend e në rrokopujë, të dëshpëruar a të mbyllur në vetvete, të hazdisur nga liria e beftë e tunduese apo të frikësuar nga të papriturat dhe e panjohura, duke u rrekur të provojnë "salcrat e shijshme" të kohës së re, të ngjallin a ta bëjnë nul të shkuarën komuniste, të përshtaten me akrobacitë e pushtetit të ri, ta dredhin, të zhvatin troje, toka, shtëpi, të fitojnë poste ku burojnë paratë, të provojnë zaret e politikës ku zë fill kamja, t'ia mbathin udhëve të kurbetit ku rafsha mos u vrafsha, ca me vula nëpër konsullatë e ca shtegut të maleve në kufi, njerëz e portrete lloje-lloje, deri dje në rregull e miq, me censurë për një vjershë e Sekretarë të Parë, sot në rrëmujë e armiq, as mish e as peshk. E çfarë nuk gjen në vëllimin e vogël prej 157 faqesh të këtij romani? Jo thjesht Gjirokastra, por Shqipëria krejt është aty e përthyer përmes këtij qyteti të gurtë e të çuditshëm. Ca nga njerëzit e ndërkryer mua më kujtojnë nojmat e Kadaresë dhe besoj se Thanasi mund ta ketë një ndikim nga pena e të madhit të letrave tona, se edhe miqësi të hershme ka pasur me të e bisedat vargan i ka çuar.

Thashë që është një roman *tablor*. Në shumësinë e episodeve mua më kanë lënë mbresa disa syresh. Ja... një Rait Kërpi, nga ata minjtë e zyrave të PPSH dikur, e ndjejnë erën e pushtetit, se e kanë nën lëkurë, andaj dhe në kohën e re e nuhatin që tej erën e djathit, aty ku buron paraja, e mira, autoriteti, hajnia. Por bri tij qe dhe një tjetër, Dizdar Gaziu, që e shihte partinë si mundësi korruptimi e pasurimi për vete, fenomen ky që lidhej më pas me kapjen e pushtetit dhe të vetë shtetit nga të pasurit, ata që më vonë u quajtën "oligarkë" dhe që financojnë partitë në fushatat elektorale. Ja dhe dy gra, Eli Milaj dhe Lemani, që provojnë të "panjohurat" e seksit a përfitojnë nga uritë e pashuara të njerëzve duke e kthyer në tregti qejfin e ëmbël të mishit. Është koha kur në qytet vijnë homoseksualët e parë nga Evropa e flenë bashkë në një krevat (aman, o zot, aman!...); koha kur tabutë e seksit thyhen, qejfet rriten e tok me të thyhet edhe vetë tradita e mortifikuar. Më tutje na shfaqet një Hamit Shkurta, kokëkrisur, që i kishte shkuar konsullit të Greqisë në Gjirokastër dhe i kishte nxjerrë revolen duke i kërkuar vizë. Dhe ai i mjerë, dyll i verdhë nga frika, ç'të bënte tjetër, ia kishte dhënë. Kohë kur njerëzit mblidheshin trumba-trumba te kosullata greke në Gjirokastër për një vizë dhe ajo ishte kthyer si nje shtet i vogël në shtetin e madh. Kohë, kur njerëz të fantaksur bridhnin si fantazmat natën dhe hapnin gropa për të gjetur florinjtë e fshehur plojave të luftërave, ullinjve të fshatrave të Çamërisë, madje edhe në varre; kur një sozi i Enver Hoxhës, por i shkurtër, që nanuriset me madhështinë e të "vërtetit", si dhe vetë hija e Enver Hoxhës që bredh kujtesës së qytetit, ngrin në gur në një skulpturë gjigande që më pas e thyejnë dhe e bëjnë copë-copë ata që e urrenin, dhe e ëndërrojnë ta ribëjnë ata që e donin edhe në vdekje. Ja dhe një kongres e një parti që vinte nga ulluqet e përgjakura e të pista të PPSH dhe që kërkonte të rinovohej, të dukej e re, paçka se anëtarësia e vjetër qe aty dhe kalbjen e kishte brenda si trashëgimi historike. Po dhe një parti e re, PD, që shpallej si e "re", por që kishte nën këmbë qelbin e kohës së urrejtjes, një ish komunist të konvertuar në demokrat si lider. Në rrokapjekthin e madh social politik të fillim viteve '90, dolën njerëz urithë që nuhatën paranë dhe projektuan mashtrimin e madh të firmave piramidale, sikurse të tjerë njerëz që nisën t'i zgjidhnin lakmitë dhe konkurrencën me revolet e fshehura nën xhaketa... Historia e Xhevat Avdallit, këngëtarit të famshëm të isopolifonisë së jugut, i njohur edhe për këngën e tij kushtuar Enver Hoxhës, edhe pse dy faqe gjë, të mbetet në mendje. E rrahën keq ndoca rrugaçë të ndërkryer teksa regjimi përmbysej, të keqpërdorur nga politika e revanshit, akt sa i frikshëm, kriminal dhe i pacipë, aq dhe dëshpërues e fyes për qytetarinë gjirokastrite. Një nga figurat e pastra, të rrënjës gjirokastrite, i rrethuar nga aora e simpatisë autoriale ishte inxhinjeri i njohur Sokrat Kalivopulli, i biri i mjekut të shquar që ish burgosur nga komunistët e kish vdekur aty, ashtu dinjitoz dhe i pafjalë. Por ky inxhinjer kish një shpirt të madh, si i ati dikur, i kuptonte zhbërjet që vinin nga pushteti dhe e keqja, andaj qëndronte si një karakoll në mbrotje të së mirës, njerëzve, hallexhinjve, sikundër provokimeve të ardhura nga segmentet e errëta nacionaliste të politikës duke ruajtur marrëdhënien e mirë historike midis minoritarëve grekë e shqiptarëve. Është vërtet një figurë mallëngjyese ky Sokrat Kalivopulli, njeriu që bashkon, që do, që i ndreq gjërat, nuk i prish, as urren...

Romani ka edhe elemente biografikë. Ai që e njeh Thanasin dhe librat e tij e di se Josif Mërtiri është Thanas Dinua vetë, ndërsa Pavllo Çerkezi është poeti i njohur gjirokastrit Petro Çerkezi, sot jeton në Qipro, siç edhe e përshkruan romani. Dy personazhe, që lundrojnë më shumë fletëve të tij si një velierë morale e si dëshpërim shpirtrash të butë prej shkrimtarësh. Nuk janë asish që të nguliten në kokë si ndoca të tjerë rreth tyre, ata që përmendëm më sipër dhe ata që s'i zumë në gojë. E megjithatë janë burma që lidhin subjektin.

Ka një stil të shkruari të vetin Thanasi, me një frazë të mbledhur, që herë-herë ruan atë formë ligjërimi si të ardhur nga rrëfimet e të moçmve, ku edhe struktura e fjalëve ka qejf të mbaj përsipër myshkun dhe leskrat e qëmotit, si për t'i dhënë kështu ca më shumë vjetërsi, lezet, kripë. Do pak kohë sa të mësohesh me këtë lloj ligjërimi të ngjeshur, të prerë, që nuk të lë kohë të lakadredhesh me epitete e plotësues foljorë të shumtë, por duke i shkurtuar maksimalisht ato, falë një pauze medituese që duhet ta mendosh vetë, ai kalon direkt te pasoja psikologjike dhe pjesa vepruese e personazheve. Dhe kështu "pauza" mbushet vetiu nga lexuesi me domethënie. Së dyti, proza e Thanasit e ka më fort suksesin te qëmtimi i tipave "ndryshe", me një vetjakësi të paqortueshme, ku nderet një jetë e damar krejt i veçantë karakterial, shpesh i habitshëm, grotesk, ndoca bëma e thagma si prej kokëshkretësh a kokëkrisurish. Dhe kjo e bën letërsinë e tij të bashkojë dy brigje në një, në dukje të largët, por realisht të afërt: klasiken me modernen.





Vëllimi me tregime "Tregime të një personazhi" të Esmeralda Shpatës

TREGIMET E NJË PERSONAZHI TË RI

Nga Ballsor Hoxha

Përmbledhja me tregime e Esmeralda Shpata "Tregimet e një personazhi" është qysh në fillim një 'teoretizim' dhe teknikë udhërrëfyese për leximin e kësaj përmbledhjeje, ajo/titulli bën me dije se ka dy shtresa, së paku, të të lexuarit e kësaj përmbledhjeje:

1. si mishërim i narratorit në tërësinë e këtyre tregimeve, dhe aq më shumë, dhe më tutje (në piskanalizë), si psikë e cila është e pandashme dhe e padallueshme nga njëri tjetri, por në të vërtetë është një membranë gjithëpërfshirëse;

2. dhe më tutje si projektim (Heidegger dhe Freud këtu) i Të Kuptuarit dhe prezencës së ankthit ekzistencial, si zhvendosje dhe kondensim (Freud) i të thënshmes së ankthit.

Kjo në të vërtetë është kërkim i një shprehjeje dhe shfaqjeje origjinare, të lindur, apo ashtu siç është lindur, siç është krijuar dhe në përpjekje për të shmangur skematizimet e shpirtërores.

Duke u nisur që nga poezia e Emily Dickinson e tutje, hasim në letërsi tejet interesante – introverte. Kjo letërsi gjithherë ka shenjat e saj të dallueshme:

1. Përthyerjen me kah përbrenda të interpretimit/narracionit

2. Ngërthimin e narracionit

3. Përpjekjen apo, (lexo: ankthin), për fshehje të udhës drejt unit krijues

4. Të poetikës unike.

5. Dhe aq më shumë, ndër të tjera, kondensimin dhe projektimin (sipas psikanalizës) të ankthit!

Dhe duke u nisur, dhe ndërlidhur dy antagonistë, Heidegger dhe Freud, projektimi në të vërtetë është, për Heidegger – coping – (përballje) e Të Kuptuarit primordial, të para- vetëdijshëm, derisa për Freud është mekanizëm mbrojtës i të shprehurit të ankthit! Por në fund të dyja janë e njëjta gjë, shtrirja e ankthit të të qënit.

Më tutje, Heidegger, në një prej veprave kryesore të tij për artin (The Origin of the Work of Art) thotë se çdo projektim (artistik/gjuhësor) në vete përmban të thënën e tij por dhe të pathënën e tij. Gjë që në tregimet/prozat e Esmeralda Shpata na dërgon gjithnjë në kompleksin e projektimit, qoftë edhe të kondensimit dhe të zhvendosjes së të thënës, ku e pathëna gjithnjë shfaqet si përpjekje për të ruajtur pastërtinë dhe lirikën e shprehjes së saj, si dhe të qenies dhe qëniesimit përballë ankthit të ekzistencës.

Ankthi i ekzistencës është i dy shtresave në tregimin e Esmeraldës, është i perspektivës individuale dhe të kolektivizuar, dhe aq më shumë të një përpjekjeje të autores për të vënë brenda një komuniteti, imagjinar, tërë penetrimet e saj artistike.

Në kolektiven, ajo shquan një komunitet të dezintegruar në presionin e sociales si mërgimi e pesha e rëndë e krizës shoqërore, dhe në anën tjetër me kokë ulur, të dorëzuar, 'dërmuar' nga të gjendurit në prag të mbijetesës.

Ndërsa në perspektivën individuale, gjë të cilën e krijon në masën më të madhe të tregimeve të saj, ajo krijon episode të intimes, të psikës dhe të Animes individuale.

"*Ligjëratat ishin futur në kuti shkrepësesh të vogla. Njerëzit ishin fijet që rrinin stivë brenda. Të shtrirë dhe të trembur. Shkrepësja (kutia) ta merrte frymën, në skajin më të largët të saj ishe ti me këmbët e tua. E gjithë bota u përkufizua rreptësishtë. Ajo iu zbatua kundërshtarit.*" (Tregimi "Litota")

Dhe

"*Marina ime.*

Një të diel maji ishim shtrirë të dy nën blirin e madh afër shtëpisë së lyer me gëlqere... nga qiejt fryu erë. E ndjeva të pashmangshmen në trup. E ndjeva dhe gjaku më shkoi në fund të këmbëve... vajza më përmendi. Marina. Përfytyrimi im i mori dorën, ia puthi dhe ia vuri mbi buzë." (tregimi "Dy Marinë")

Para se të kalojmë në këta dy shembuj të cituar, në përmbledhjen me tregime "Tregimet e një personazhi", është mjaftë e shpeshtë qoftë – çarja – sipas Anime (Carl Jung) dhe qoftë sipas skizoides psikologjike, në kryesisht dy qenie, dy përfytyrime të të njëjtës psikë. Gjë që është në lidhje direkte me kastrimin dhe me ndalesën e njeriut në qëniesimin e tij/saj, në pamundësinë e mishërimit të qëniesimit të tij/saj të brendshëm si pasojë.

Duke iu kthyer dy shembujve të cituar nga përmbledhja e Esmeralda Shpata, në të parin është kondensimi i projektuar në "*Kuti të shkrepëseve*" dhe në të dytin është e cekura – çarje – Anima, e njeriut, individit dhe qenies.

"Fija e shkrepëses" së projektuar në njeri, në introverten paradoksale, apo thënë ndryshe, njeriu i Interpretuar përmes këtij tregimi si fije e shkrepëses, është në "kërkim të të vërtetës"! Është në kërkim të kundërshtarit, vetë të vërtetës. Por, sipas Carl Jung dhe asaj që thuhet rreth introvertes në këtë fushë, ajo qoftë edhe po të zbulohet, kompleskohet/kondensohet në një projektim të fshehur dhe të shmangur nga Publikja.

Gjë që, na sjellë tek ajo që është tejet e theksuar në tregimin e autores, - çarja – në Anime ndërmjet dy përjetimeve të vetes të një individi. Kjo është aq më shumë, e theksuar në personazhin e Era, Bora, Gjumi etj.

Në shembullin e dytë të cituar, në të vërtetë, ka një zhvendosje të perspektivës, nga narratori i cili rrëfen në veten e parë, duke kaluar po i njëjti në përfytyrim të personazhes për të cilën rrëfehet, vetë Marinën. Kjo është pikërisht projektimi i introvertes e cila thyen, dhe shmangë çfarëdo kontakti me Publiken dhe të udhës së këtij projektimi, për të zbuluar të "pathënën" se në të vërtetë është individi i cili kastrohet, apo është i kastruar në pamundësi të qëniesimit dhe të mishërimit të qëniesimit të tij, gjë që e ndanë në të depersonalizuar dhe të pa-qëniesueshëm.

Ty dy këto shembuj të cituar në të vërtetë e japin eksplicit, të "pa thënën" e pamundësisë së qëniesimit. Të një bote të "Projektuar" si – coping – dhe të kastruar nga ankthi i banorëve të qytetit, që si një personazh i Esmeraldës vazhdimisht na bën me dije se jemi një bashkë-qëniesim i pamundur.

Më tutje, duke u ndalur pikërisht në tregimin hyrës "Grafikë", i cili është përfaqësuesi më ekzakt dhe më i drejtpërdrejtë i introvertes në tregimet e Esmeraldës, mund të lexojmë këtë gjarpërim të udhës së rrëfimit të saj.

"*... dikur ishte shpirti njëplanësh dhe i sakatuar i lepurit...*

nisi pastrimin, se vendi duhej pastruar nga dëshmitë e gjurmët e tij prej lepuri... ai gjallonte. Kuptimi i lepurit Tim *jeshil u kthye në mit. Nuk ka më mister ku fle lepuri.*

Nuk ka më minj gjirizesh për të ngrënë sytë, ka lepur jeshilë mishngrënës. Është ai që shpëtoi nga frika e tij instinktive dhe sot të bren shpirtin.

Në brendësi mund të gjeni ndonjë impuls frike, por peizazhi i lamtumirës së lirisë është më i fortë.

Tani ka hipur mbi kullën e Sahatit dhe po bren akrepat."

Në këtë tregim së pari kemi të shkuarën e një "lepuri" ("frike njëplanshe"), i cili pastaj gjendet në gjyqin e "heqjes së simbolit të tij si frikë"; më tutje kemi aludimin ironik të 'fshirjes së misterit" të vendit ku fle lepuri. Dhe pastaj kemi kthesën ku lepuri, simboli i frikës në këtë tregim, personalizohet, dhe kalon saktësisht në "lepurin tim jeshil". Dhe në kulminacionin e tregimit, ku "frika" dhe "liria" kalojnë në paradoks, të frikës që më nuk mund të gjendet, e që është "lamtumira e lirisë". Dhe fundi ku "lepuri" një herë i kaluar në mit, i hequr simbolikën e frikës, "po bren akrepat".

Sigurisht, tregimi hyrës në këtë përmbledhje, është edhe ironi e ankthit të ekzistencës, e edhe lojë me pamundësinë e lirisë në personalen e narratorit, por është edhe mirë i informuar dhe aq më shumë bartë teorinë e ekzistencializmit përbrenda.

Janë dy shfaqje që dalin nga ky Projektim (sipas Heidegger) i – shpërthimit tutje prej pamundësisë së mundësisë së jetës! Dhe në anën tjetër, sipas Freud, është projektim i ankthit të ekzistencës në kah introvert, duke zgjedhur pikërisht ankthin dhe me këtë frikën dhe simbolin popullor të shtresuar si "lepur" për të penetruar në vetë paradoksin e ankthit të ekzistencës ndaj lirisë.

Dhe shfaqja e një udhe të natyrshme, origjinare (sipas lindjes së këtij ankthi), dhe e cila gjithnjë tenton të – fshijë – po këtë udhë, gjë që përkundrazi e lë gjurmën në po të njëjtën.

Kjo është introvertja e rrëfimit të Esmeraldës, e cila, luan dhe nxjerrë në pah, nga e përgjithësuara në personalen, pastaj tutje në universalen e ankthit të ekzistencës.

Në përgjithësi tregimi i Esmeralda Shpatës është një risi dhe përpjekje për të shmangur skemat dhe për të krijuar në 'lindje', në 'origjinare, në esencën e 'pastërtisë' së psikës. Gjë që më tutje na sjellë para një poetike krejtësisht personale, më shumë se origjinale, jo për ta kritikuar, por për të zbuluar se në rrëfimin e saj kemi të bëjmë me një Un krijues i cili, siç shprehet në një nga tregimet, "*megjithëse kurrë nuk e ka takuar njeriun me emrin Kren*" në të vërtetë, në realitet, është tërë kohën e përballur me po të njëjtin. Është tërë kohën në përballjen e saj me shtypjen. Është tërë kohën në përballje me Të Kuptuarit, dhe në këtë Interpreton po të njëjtën, si ironi e hollë ndaj pamundësisë së këtij qëniesimi.

Miqësia tek "Udhëtim në Malin e Shenjtë" nga Nikos Kazanxaqis

Nga Damian Alia

Miqësia dhe vrulli i pandalshëm i jetës janë dy kategoritë e mëdha që veprojnë brenda tekstit të vogël të Kazanxaqis. Miqësia është ngjizje; vrulli jetësor, shtysa drejt kësaj të përpjete. Kazanxaqis na tregon një përvojë që shkon në kufijtë e njerëzores. Brenda këtyre kufijëve ziejnë vorbullat e parehatura që janë sepse ka kufijë që i kushtetojnë, e nuk qetësohen sepse kufijtë duhen zgjeruar e përthyer.

Si ta kuptojmë më mirë miqësinë arketipale mes Kazanxaqis dhe Siqelianos tek teksti i tij i fundit "Udhëtim në Malin e Shenjtë"? Një harmonizim i përsosur përgjigjet Kazanxaqis: "U bëmë, menjëherë, papritmas, miq; aty për aty, me mend se njëri kishte nevojë për tjetrin dhe se të dy së bashku do të përbënim njeriun e përkryer."[1] Një sforcim i madh e i pandalshëm i jetës për të prodhuar forma më të larta e të përsosura, për të krijuar vetveten nga pjesët më të mira të vetes do të thoshim ne. Jetësor i një lloj të ri prej frymës, ky është komuniteti i miqësisë. Mishi e kockat, gjaku e ropullitë janë shumëfishësi jo më prej individualitetit por prej përmasave që fryma shpalos vrullin. Trupi nuk mjafton më, trupat bëhen një, të ndarë e të bashkuar; një shumëfishësi organesh e gjymtyrësh që shkojnë drejtë farkëtimit të një specieje të re. Miqësia është një përpjekje e tillë e jetës e ndoshta rezultati i saj është civilizimi. Ndoshta, një miqësi njerëzish të tillë është fara e nëndheshme e çdo civilizimi të madh. Vërtetësia e kësaj teze kërkon pranimin se koncepti i njeriut si të tillë nuk ekziston në këtë rrugëtim qytetërues, as si qëllim, as si shkak e as si pasojë. Njeriu abstrakt nuk ekziston, por në mënyrë të pakundërshtueshme imponohet qenia e një entiteti që vjen duke u formuar prej miqësisë si frymë, si jetë që i mundëson vetes, rrallë, takimet e duhura në vendet e duhura. Kështu e kuptoj pra, miqësinë e Kazanxaqis me Siqelianos, një miqësi kozmogonike, një ndër mundësitë e lindjes së vazhdueshme metafizike që jeta i siguron vetes. Mbarsje dhe lindje jo organike.

Elementët e këtij komuniteti janë kushtet e domosdoshme për të formuar strukturat e këtij koncepti kozmogonik të miqësisë, të këtij erosi jofizik. Ky wshtw Siqelianos sipas Kazanxaqis: "Mirëpo, një ditë, shndriti drita. Atë ditë, në Kifisia, u takova me një djalosh të moshës sime, të cilin do ta doja dhe çmoja pa ndërprerje dhe ishte nga ata pak njerëz, prania e të cilëve më gëzonte më shumë se mungesa e tyre. Ishte shumë i hijshëm dhe e dinte; ishte poet i madh lirik dhe e dinte; kishte shkruar një poemë të mrekullueshme; atmosferë poetike, varg, gjuhë, harmoni magjike, nuk ngopesha së lexuari e së shijuari atë poemë. Ky poet ishte nga raca e shqipeve; me të shkundur pak flatrat, mbërrinte në kreshtë. Më vonë, kur deshi të shkruante edhe prozë, e pashë që ishte, me të vërtetë, shqipe; kur nuk fluturonte, por përpiqej të çapitej në tokë, i ngjante shqipes së rëndë, që mezi çapitet; forca e tij ishte ajri. Flatra kishte, mendje të qëndrueshme nuk kishte; vështronte larg dhe vagullt. Mendonte me pamje dhe krahasimet poetikë ishin, për të, argumente të pakundërshtueshëm logjikë; kur ngatërrohej nëpër përsiatje pa gjetur dot zgjidhje, vetonte brenda tij një pamje shkëlqimtare ose shpërthente në një gaz shkundullues dhe shpëtonte. Por kishte fisnikëri të madhe, dhunti të rrallë dhe mirësjellje; ta shihje tek fliste me syrin e kaltër që i ndrinte çartur apo ta dëgjoje tek recitonte vjershat e veta duke i bërë të trandeshin xhamat e shtëpisë, kuptoje se ishin rapsodët e lashtë, që, të kurorëzuar me gjethe hardhish a me lule vjollcash, silleshin nga pallati në pallat dhe zbusnin, me këngën e tyre, njerëzit, që ishin ende bisha. Vërtet, qysh nga çasti i parë që e pashë, ndjeva se ai djalosh i rriste nderin racës njerëzore."[2] Ky është poli i cili beson se mund të ringjallë të vdekurit teksa përpiqet një natë të tërë të risjellë mes imazheve të gjalla fqinjin e tij, rrobaqepësin. Poeti që mund të të rënqethi prej shkarkimit elektrik që përcjellin duart e tij zeusiane. Një pushtim absolut fuqish e bënë ti thotë Kazanxaqisit:

"-Kaq Zot ndjehem thellë vetes, saqë, sikur të më prekësh dorën këtë çast, ka për të lëshuar shkëndija.

–Nuk fola.

–Çfarë, nuk beson? ia bëri ai, ngaqë më pa tek rija në heshtje; provoje, preke! dhe më nderi dorën."[3]

Këtu kemi të bëjmë me një lloj të riu që shkëlqen në këtë formë vetëm prej lashtësisë së forcave që e kaplojnë, dashur apo pa dashur. I riu që kthehet në enë, mish teurgjik, shprehje e hyjnores. Besimi është gjysma e udhës.

Tjetri, rrëfyesi, i kënaquri, dyshuesi, i habituri dhe besuesi, Kazanxaqis, nuk mund të vendoset më poshtë në këtë komunitet të barabartësh brenda rrafshit hierakik. I riu që udhëhiqet nga parimi "Unë prij duke kurorëzuar ngadhnjimtarët e tjetër."[4] Më i ekuilibruar, më apollonian në pozicionet e tij, në përpjekje të vazhdueshme për stabilitet me furinë dionisiake të mikut të vetë, Kazanxaqis është miku tjetër, miku i domosdoshëm i kësaj mbarsjeje kozmike. Përpjekja e tij titanike për harmonizim të forcave vjen edhe në imazhin e fundëm të dramës universale. "...do të vijë dita e shpëtimit përfundimtar, e pajtimit përfundimtar, do të shuhen flakët e Skëterrës dhe Biri Plangprishës, Satanai, do të ngjitet në qiell, do t'i puth dorën atit dhe do t'i rrjedhin lot nga sytë: 'Gabova', do të thërrasë; dhe Ati do të hapë krahët: 'Mirë se erdhe', do t'i thotë, 'mirë se erdhe, bir; më fal që të mundova kaq shumë!"[5] Shija dionisiake trafikohet në këtë vizion paqtor të fundit të kohëve. Diskutimi me At Ignatin mbi mëkatin si shërbim ndaj Zotit nuk është gjë tjetër veçse konfirmim i kësaj force dehëse brenda çdo forme të ndritshme. Fundja, a nuk mëson Sabbatai Zevi dhe të nistuarit e dorës së majtë në traditat hinduiste se shpërbërja e formave është udha tjetër për te transhendenca, për tek Zoti?

Kjo miqësi e gllabëron Malin e Shenjtë Athos, duke e kthyer atë në spektator të formave të reja që po përgatiteshin teksa Kazanxaqis dhe Siqelianos kalojnë nga një manastir në tjetrin, nga murgu i ngopur tek oshënari në kocka. Kështu, udhëtimi është esencialisht jo një njohje e të gjeturve në mal, por e të paardhurve ende. "Është domosdoshmëri; ka ardhur koha ta bëjmë Krishtin të qeshë; të mos rrihet më me kamxhik, të mos qajë, të mos kryqëzohet. Të përthithë dhe t'i përshtasë vetes zotat e fuqishëm dhe të qeshur të Greqisë së lashtë."[6]

Ja pra, pjella e re që ravijëzohet. Nëpër dhoma të ndriçuara prej qiririt apo në shëtitje buzë liqeneve në mbrëmje, vijnë e marrin trajtë porositë e mëdha të së ardhmes, nxjerrin kokën potencialet e të shkuarës, të pa-aktualizuara plotësisht, të pashmangshme përfundimisht. Miqësia është ky proces zierje dhe krijimi, e dhimbshme, me krenaritë dhe përplasjet e veta, e ëmbël, me guximet dhe këngët e veta. Dy miq janë në këtë tekst, pafundësi formash shfaqen virtualisht në bisedat e tyre, në vështrimet, heshtjet, të qeshurat...dy miq dhe një vend përcjelljeje e mbërjeje krijohet sepse "Klithma nuk është e jotja. Nuk flet ti, flasin paraardhësit e tu të panumërt me gojën tënde. Nuk dëshiron ti; dëshirojnë breza të panumërt pasardhësish me zemrën tënde. Të vdekurit e tu nuk prehen nën dhe. U bënë zogj, pemë, ajër. Rri nën hijen e tyre, udhqehesh me mishin e tyre, frymon frymën e tyre. U shndërruan në ide e pasione, dhe përcaktojnë dëshirën e veprimet e tua."[7]

1 Nikos Kazanxaqis, *Udhëtim në Malin e Shenjtë*, Zenit Editions, Tiranë, 2013, f. 14.

2 Nikos Kazanxaqis, *Udhëtim në Malin e Shenjtë*, vep. e cit., ff. 13-14.
3 Po aty, f. 17.
4 Nikos Kazanxaqis, *Udhëtim në Malin e Shenjtë*, vep. e cit., f. 15.
5 Po aty, f. 73.
6 Po aty, f. 44.
7 Nikos Kazanxaqis, *Asketika – Salvatores Dei*, Zenit Editions, Tiranë, 2021, f. 31.

DHE DIÇKA TJETËR

Tregim nga Raymond Carver

Përktheu nga origjinali: Aristidh Shqevi

Bashkëshortja e L.D-së, Maxine, në momentin që u kthye nga puna vonë në mbrëmje dhe e gjeti atë të pirë, e madje tek sillej në mënyrë abuzive me Rae-n, vajzën e tyre pesëmbëdhjetë vjeçare, i kërkoi atij të largohej nga shtëpia. L.D. dhe Rae ishin ulur në tavolinën e kuzhinës dhe po debatonin ashpër me njeri tjetrin. Maxine nuk arriti as ta vinte çantën në vendin e vet, as ta hiqte pallton.

Rae tha: 'Thuaji, mama. Foli për ato që biseduam bashkë.'

L.D. rrotulloi gotën që mbante në dorë, por nuk ktheu asnjë gllënjkë. Maxine ia kishte ngulur sytë me një shikim shqetësues.

'Mos fut hundët në gjëra të cilat nuk i kupton,' tha ai, dhe pa vonesë shtoi: 'unë nuk mund t'i marr seriozisht njerëzit që qëndrojnë ulur gjithë ditën duke lexuar revista të astrologjisë.'

'Kjo nuk ka asnjë lidhje me astrologjinë,' tha Rae. 'Ti nuk ke përse të më fyesh.'

Përsa i përket Rae-s, ajo kishte javë të tëra që nuk shkonte në shkollë. Ishte e mendimit se askush nuk mund ta detyronte të bënte një gjë të tillë. Maxine tha se kjo ishte një tragjedi tjetër në serinë e gjatë të tragjedive të vogla.

'Përse nuk e mbyllni gojën që të dy? tha Maxine. 'O Zot, jam bërë me dhimbje koke.'

'Foli, mama, ndërhyri Rae. 'Thuaji se problemi është gjithçka që ai ka në kokë. Çdokush që merr vesh nga këto punë do ta thotë se problemi ndodhet aty!'

'Po për diabetin, ç'ke për të thënë?' pyeti L.D. Si i bëhet me epilepsinë? A mundet truri ta kontrollojë atë?'

Ai ngriti gotën lart pothuajse në lartësinë e syve të Maxine-s dhe i dha fund pijes që ishte në të.

'Po, edhe diabetin e kontrollon,' tha Rae. 'Epilepsinë. Çdo gjë! Sa për dijeninë tënde, truri është organi më i fuqishëm në trupin e njeriut.'

Ajo mori paketën e tij dhe ndezi një cigare një për vete.

'Sëmundja e keqe. Po për këtë çdo të thuash? vazhdoi L.D.

Ai pati përshtypjen se aty e kapi mat. Sytë i hodhi nga Maxine.

'Nuk e kuptoj se përse filluam të flasim për gjëra të këtilla,' iu drejtua L.D. Maxine-s.

'Sëmundja e keqe,' tha Rae duke tundur kokën në shenjë mohuese për shkak të naivitetit të tij. 'Këtu përfshihet dhe sëmundja e keqe. Ajo e *ka* zanafillën te truri.'

'Kjo është çmenduri!' thërriti L.D. Ai goditi tavolinën me kurrizin e dorës. Taketukja hovi përpjetë. Gota e tij ra anash dhe u rrokullis. 'Ti je e çmendur, Rae! A ke dijeni për këtë?

'Qepe gojën!' bërtiti Maxine.

Ajo zbërtheu kopsat e palltos dhe vendosi çantën e vogël të dorës mbi banakun e kuzhinës. Tek ktheu vështrimin nga L.D. ajo tha: 'Unë nuk duroj dot më. Po kështu edhe Rae. Gjithashtu, të gjithë ata që të njohin nuk të durojnë dot më. E kam menduar gjatë. Kërkoj që ti të largohesh nga shtëpia. Sonte. Këtë minutë. Tani. Shporrmu sysh pa e zgjatur.'

L.D. nuk kishte ndërmend të shkonte gjëkundi. Fillimisht ai i hodhi një shikim Maxine-s dhe më pas kavanozit të turshive, i cili pushonte në tavolinë që nga dreka. Ai rrëmbeu kavanozin dhe e flaku atë përmes dritares së hapur të kuzhinës.

Rae brofi nga karrigia. 'O Zot! Ai ka luajtur mendsh!' Ajo lëvizi në drejtim të mamasë për të qëndruar pranë saj. Merrte frymë me gojë.

'Thërrit policinë,' tha Maxine. 'Ai është i dhunshëm. Dil nga kuzhina përpara se ai të godasë. Thërrit policinë,' përsëriti ajo.

Me disa hapa të ngadaltë prapa, ato nisën të dalin nga kuzhina.

'Po iki,' tha L.D. 'Në rregull, po largohem që nga ky çast,' tha ai. Nuk e kam fare problem. Sido që të jetë, të dyja jeni të meta. Këtu është një çmendinë e vërtetë. Jetë ka edhe gjetkë. Më besoni, të qëndrosh këtu është e pamundur; bëhet fjalë për një çmendinë.'

Ai ndjeu në fytyrë një rrymë ajri që kaloi përmes një të çare në dritare.

'Atje kam për të shkuar,' tha L.D. 'Tutje larg,' tha ai duke treguar me gisht në distancë.

'Mirë,' u përgjigj Maxine.

'Dakord, unë po iki,' vijoi L.D.

Ai përplasi dorën me forcë mbi tavolinë. U ngrit në këmbë dhe shkelmoi karrigen ku kishte qëndruar ulur.

'Mua nuk keni për të më parë më kurrë,' tha L.D.

'Ke bërë aq shumë gjëra ti, saqë e kam të vështirë të të harroj,' tha Maxine.

'Në rregull,' u përgjigj L.D.

'Vazhdo, dil jashtë,' tha Maxine. 'Qiranë e paguaj unë këtu, dhe jam unë ajo që po të them largohu. Tani, këtë minutë.'

'Po iki,' tha L.D. 'Mos më shtyj,' shtoi ai. 'Jam duke ikur.'

'Mos bëj gjë tjetër, ik,' tha Maxine.

'Po iki nga kjo çmendinë,' tha L.D..

Ai përshkoi dhomën e gjumit dhe mori nga dollapi një prej valixheve që i përkiste asaj. Ishte një valixhe e vjetër rrobash në ngjyrë të bardhë, e markës Naugahyde, me njërën prej dy sustave të prishur. Ajo e kishte përdorur dikur atë për t'i mbajtur aty pulovrat e saj kur shkonte në kolegj. Edhe L.D. kishte qenë në kolegj. Ai e hodhi valixhen mbi shtrat dhe filloi t'i sistemojë aty të brendshmet, pantallonat, këmishët, rripin e vjetër prej lëkure të mesit me tokëz tunxhi, çorapët, dhe gjithçka tjetër që kishte të vetën. Për të lexuar mori disa revista nga komodina. Mori dhe taketuken. Në valixhe futi gjithçka që pati mundësi, çdo gjë që mund të zinte vend. Ai mbërtheu sustën e mirë, siguroi rripin e shtrëngimit, por në fund fare u kujtua për gjërat që përdorte në banjë. Çantën e dorës të veglave të rrojës, prej vinili, e gjeti në raftin e vogël prapa kapelave të saj. Ai vendosi aty briskun dhe pastën e rrojës, pudrën, deodorantin si edhe furçën e dhëmbëve. Ai mori gjithashtu me vete pastën dhe fillin për pastrimin e dhëmbëve.

* * *

L.D. i dëgjoi ato tek flisnin me zë të ulët në dhomën e ndenjjes. Ai lau fytyrën, pastaj ngjeshi sapunin dhe pecetën në çantën e vogël. Më tej, vazhdoi me gotën që gjeti mbi lavaman, prefësen e thonjve dhe biguditë që ajo i përdorte për qerpikët e saj.

Çantën e rrojës nuk mundi ta mbyllë, megjithatë kjo nuk përbënte ndonjë problem të madh për të. Ai hodhi pallton mbi supe dhe rrëmbeu valixhen. Më pas u kthye në dhomën e ndenjjes.

Në momentin që e vuri re, Maxine hodhi krahun mbi supet e Rae-s.

'Ja, pra,' tha L.D. 'Kjo është lamtumira ime,' shtoi ai. 'Nuk di ç'të them tjetër veçse, ma do mendja, nuk kam për t'ju parë më kurrë me sy. Këtu përfshihesh dhe ti,' tha L.D. tek i'u drejtua Rae-s. 'Ti dhe idetë e tua të krisura.'

'Vazhdo,' vijoji Maxine. Ajo tërhoqi Rae-n nga dora. 'Nuk të mjafton dëmi që ke bërë në këtë shtëpi? Vazhdo L.D. Largohu nga shtëpia që të kemi edhe ne qetësinë tonë.'

'Vetëm mos harro,' tha Rae. 'Problem janë të gjitha ato që ti ke në kokë.'

'Po iki, nuk kam se ç'them tjetër,' tha L.D. 'Kudo qoftë. Mjafton të jetë larg nga kjo çmendinë,' tha ai. 'Kjo është më kryesorja.'

Ai i hodhi një vështrim të fundit dhomës së ndenjjes, kaloi valixhen nga njëra dorë në tjetrën dhe vendosi çantën e rrojës nën sqetull. 'Rae, ty do të kontaktoj; Maxine, do të ishte më mirë për ty që të largoheshe nga kjo çmendinë.'

'Ti e shndërrove shtëpinë në çmendinë,' tha Maxine. 'Nëse është çmendinë, është sepse ti e bëre të këtillë.'

L.D. uli valixhen përtokë, dhe vendosi çantën e rrojës mbi të. Ai drejtoi trupin dhe qëndroi në këmbë përballë tyre.

Ato bënë një hap prapa.

'Kujdes Mama,' thirri Rae.

'Nuk e kam frikë,' tha Maxine.

L.D. vendosi sërish çantën e rrojës nën sqetull dhe ngriti valixhen.

Ai tha: 'Dua të them dhe diçka tjetër.'

Por L.D. nuk tha asgjë, papritur atij i'u këput filli i mendimeve.



MARK POLIZZOTTI

SIMPATI PËR TRADHTARIN: NJË MANIFEST PËR PËRKTHIMIN

Përktheu nga origjinali Granit Zela

Çështja nëse është apo s'është i mundur përkthimi, deri në çfarë niveli, sa "humbet" tek ai, dhe se çfarë do të thotë kjo, ka qenë shqetësim i përkthyesve dhe studiuesve të përkthimit që nga agimi i gjuhës njerëzore, ose të paktën qyshse njerëzit vunë re se kishin më shumë se një gjuhë për përdorim. Me kalimin e viteve, jo vetëm shumë studiues, por edhe disa përkthyes kanë dalë nga vetja dhe ia kanë ulur vlerat përkthimit duke e quajtur përpjekje të kotë, po të gjykojmë nisur nga ligjërimi kundër asaj që bëjnë, kur bëjnë komente për përkthimin. Sigurisht, përgjigja *eppur si muove* është e mundur - përkthime bëhen çdo ditë, në të gjitha llojet e konteksteve. Umberto Eco ka vënë në adukje një herë se: "çdo teori e arsyeshme dhe e saktë e gjuhës tregon se përkthimi i përsosur është ëndërr e pamundur. Pavarësisht nga kjo, njerëzit përkthejnë".

Në vijim të kësaj, do të ishte utopike të mëtosh që lexuesi i një përkthimi po përjeton vërtet origjinalin, ose se në leximin e çdo lloj përkthimi nuk ka një shkallë ndryshimi - *ndryshim* më shumë sesa *humbje* - midis tekstit që po përkthehet dhe vetë përkthimit. Thelbi i çështjes është nëse përkthimin e konceptojmë si rezultat përfundimtar praktik apo si ideal të paarritshëm. Nëse është e dyta, atëherë defektet e qenësishme dhe të pashmangshme të veprimtarisë së përkthimit, do të bënin që e gjithë përpjekja të dukej e kotë. (Por a nuk mund të thuhet e njëjta gjë për një shkrim?) Filozofi spanjoll Ortega y Gasset ka vënë në dukje se ndërsa përkthimi është pa dyshim një "detyrë utopike", është e tillë vetëm sepse "gjithçka që bën njeriu është utopike". Duke dashur ta pres këtë nyjë gordiane, filozofi francez Paul Ricoeur rekomandon që të arrijmë në fazën e pranimit, duke thënë troç së të mos e bësh është njësoj si të mbash zi, ndaj "të heqim dorë nga ideali i përkthimit të përsosur" njëherë e përgjithmonë.

Kur përkthej Patrick Modiano-n, me stilin e tij vetëm në dukej të qartë, përpiqem të përthith ndjeshmërinë e tij, të brendësoj strukturën, subjektin, mënyrën e tipizimit të personazheve, sintaksën, ritmin, të gjitha elementet që Modiano ka përfshirë gjatë krijimin e tekstit - në mënyrë që t'u jap lexuesve të tij në gjuhën angleze të njëjtën përvojë leximi që kanë pasur lexuesit në gjuhën frënge. S'ka nevojë të themi që kjo është një ëndërr e çuditshme: vetëm e vetëm



sepse, siç e dimë, gjuhët nuk janë thjesht përmbledhje përkufizimesh dhe rregullash gramatikore, por përkundrazi kushtëzohen nga një mori faktorësh të tjerë, historia, kultura, përdorimi, tradita letrare, politika, ndodhi të rastësishme, madje edhe diçka kaq e pa kuptim sa skandali i fundit i një personi të famshëm, dhe të gjithë këta faktorë bëjnë që fjalët dhe frazat të kenë kuptimin e tyre, nëntekstin e tyre, i cili për më tepër zhvillohet me kalimin e kohës. Marrëdhënia e ndërsjelltë midis kulturës dhe gjuhës, midis modeleve të mendimit dhe gjuhës, perceptimit dhe gjuhës, karakterit kombëtar dhe gjuhës, ka qenë një element kryesor i teorisë së gjuhës për shekuj me radhë, nga Herder-i te Humboldt-i, nga Coleridge-i te Sapir-i, nga Wittgenstein-i te Whorf-i. Nëse sjellim në kujtesë faktin se letërsia e një kombi mbruhet në formën dhe në thelbin e vet, nga gjuha e mjedisit thjesht po ripohojmë diçka mëse të dukshme. "Qoftë me vetëdije apo pa vetëdije", shkruan George Steiner, "çdo veprim i komunikimit njerëzor mbështetet në një strukturë të ndërlikuar, të ndarë, e cila, në mënyrë të drejtë, mund të krahasohet me imazhin e një bime me rrënjë të thella dhe të padukshme ose me një ajsbergu me pjesën më të madhe nën ujë".

Për të tjerë, dhe ndoshta shumë me të drejtë, teksti i përkthyer është një bashkëpunim. S'është i njëjtë me origjinalin, por domosdoshmërisht është një ri-interpretim, leximi i dytë i një shkrimtari, rikrijimi i fjalive të shkrimtarit të parë, me fjalë të tjera një proces subjektiv i pashmangshëm – arsyeja pse kur flas për lexuesit anglezë të Modianos, në të vërtetë nënkuptoj lexuesit *tanë*, të tij dhe të mi. (Për më tepër, në shumë raste, ka edhe një shkrimtar të tretë, redaktori i tekstit, i cili e rishikon punën e përkthyesit dhe ndryshon më tej përfaqësimin e veprës në gjuhën e synuar.) Edhe pse s'më pëlqen ta pranoj, versioni im i Modiano-s nuk

është vetëm e vetëm "ai" ashtu si në rastin e përkthyesve Barbara Wright, Joanna Kilmartin, ose Damion Searls, apo të ndonjë përkthyesi tjetër që ka provuar forcën me përkthimin e librave të tij. Me nivele të ndryshme suksesi, secili prej nesh ka sjellë zërin e Modiano-s në anglisht, dhe duke vepruar kështu, secili prej nesh e ka dhënë në mënyrë të pashmangshme atë zë me tonalitetin e vet.

Pa dyshim, është ky ekuilibër që zhvendoset vazhdimisht midis faktit objektiv (teksti që do të përkthehet) dhe interpretimit subjektiv (versionit të caktuar të një përkthyesi të tij) ekuilibër që shpjegon vazhdimësinë dhe forcën e bindjes se përkthimi është në thelb i pamundur. Kjo bindje mbështetet në një koncept të gjuhës njerëzore që e sheh ligjërimin thjesht si bartës të informacionit, ose, siç shprehet David Bellos, një "dëshirë për të besuar (pavarësisht nga të gjitha provat për të kundërtën) se fjalët janë thelb emrat e gjërave". Ashtu si e vëren Bellos-i, ky konceptim gjendet që te Libri i Zanafillës, ku Adami vendos të emërtojë "çdo krijesë të gjallë" – gjë që shtron pyetjen se si Adami do të kishte emërtuar një nuancë të veçantë blu (ose llullaq, apo e bruztë) që rri pezull mbi horizontin e Parisit në muzg, ose ndjenjën e melankolisë (përmallimit, zymtisë) që mund t'ju kaploj në atë orë. Por kjo nuk shpjegon as faktin se edhe emrat gjoja të drejtpërdrejtë, të tillë si *qen*, kanë ngjyresa kuptimore të ndryshme në kultura të ndryshme, edhe nëse përcaktojnë të njëjtën specie. Dhe, së fundmi, le të lëmë mënjanë faktin që, si përkthyes, zgjedhja ime për ta dhënë fjalën në frëngjisht chien si *dog, hound, cur, pooch, canine,* ose *mutt* do të ndryshojë ndjesinë që të jep fjalia ime në anglisht, dhe një nga detyrat e mia si përkthyes është të vendos se cila nga këto mundësi është më e përshtatshme për kontekstin e dhënë. Gjuha s'ka të bëjë vetëm e vetëm me përcaktimin e kuptimit. Kuptimet e vërteta shpesh gjenden në hapësirat midis thënieve, te lëvizja e krijuar nga renditje të veçanta fjalësh, shoqërizime dhe referenca të fshehura. Kjo është ajo që bën letërsia, në rastet më të mira. Dhe është ajo që mund të bëjë edhe përkthimi.

Por mbase më shumë se gjithçka, bindja për pamundësinë e përkthimit buron nga një konceptim monolit i mënyrës se si lexojmë një vepër letrare, e cila logjikisht të çon në përfundimin se leximi i vetëm, i pandryshueshëm i një vepre s'mund të riprodhohet saktësisht në një gjuhë dhe kulturë tjetër. Megjithatë, realiteti është se leximi, edhe brenda një kulture të vetme, është nga natyra një proces subjektiv dhe aktiv. Çdo lexues, ashtu si çdo përkthyes, "humbet" diçka gjatë përjetimit të veprës së një autori - prej keqkuptimit, ose prej mosvëmendjes, prej paragjykimit personal, apo prej faktorësh të tjerë, dhe në të njëjtën kohë sjell diçka të vetën që askush tjetër s'mund ta sjellë. Edhe pa zhurmën e bardhë të shtuar që mbart vepra burimore - të tilla si vlerësimi i mëparshëm i kritikëve, suksesi tregtar ose polemikat skandaloze - kurrë s'mund ta dimë se si do të reagojnë lexuesit e synuar ndaj një përkthimi sepse s'e dimë se si kanë reaguar apo do të reagojnë lexuesit burimor ndaj origjinalit nga një lexim në tjetrin. Nëse e mendojmë tekstin burimor jo si një tërësi monolite, të përcaktuar, që nuk mund të përsëritet kurrë në mënyrë të mjaftueshme, por më shumë si një zonë energjie, gjithmonë në vërshim, e pafund, e prirur ndaj përvetësimeve dhe interpretimeve të ndryshme, atëherë fillojmë ta kuptojmë më mirë punën e përkthimit, i cili, ashtu si çdo akt komunikimi, është jo vetëm i mundur, por edhe dinamik.

Mark Polizzotti *ka përkthyer më shumë se pesëdhjetë libra, ndër të cilat vepra të Patrick Modiano, Gustave Flaubert, Raymond Roussel, Marguerite Duras dhe Paul Virilio. Botues dhe kryeredaktor në Muzeun Metropolitan të Artit, ai është autor i "Revolucioni i mendjes: jeta e André Breton-it" dhe shumë librave të tjerë. Në librin e vlerësuar gjerësisht "Simpati për tradhtarin: manifest për përkthimin" botuar në 2018 nga MIT Press, autori tregon se si të lexohen jo vetëm përkthimet por edhe vetë akti i përkthimit, duke mos e parë si një problem për t'u zgjidhur por si një arritje për t'u kremtuar, po të përdorim fjalët e Gëtes, si diçka "e pamundur, e nevojshme, dhe e rëndësishme."*

ISHULLI
Deti i Veriut

nga Rainer Maria Rilke

Përktheu nga origjinali Arb Elo

I

Batica e radhës ia fshin shtegut në vat vazhdën,
dhe tëreçka nis të bëhet njëlloj anekënd;
porse ishulli i vogël tutje, atje përjashta
i ka të mbyllur sytë; prita u merr mendtë

banorëve, se në një gjumë lindin banorët e tij
e ngatërrojnë shumë botë brenda n'atë gjumë
teksa heshtin; se rrallë flasin ata, ata s'flasin shumë,
dhe porsi epitaf e kanë secilën fjali

për diç' të nxjerrë në breg, të panjohur, diçka
që nuk merret vesh nga vjen e pse është aty.
Dhe kështu është gjithçka u shkruhet ndër sy
qysh prej fëmijërisë: diçka që s'ka të bëjë me ta,
diçka që s'pyet për asgjë, diç' si dërgesë, diçka
e madhe, që ua shton edhe më vetminë atyre.

II

Si të shtrihej në ndonjë rrethore krateri
në ndonjë hënë: çdo shtëpi përreth ka pritë,
dhe njësoj të veshur kopshtet, njëri si tjetri
ngjeshur e krehur si jetimë njësoj të gjithë

prej asaj stuhie, që aq rreptë i rrit e i mëson
dhe me ditë të tëra i frikëson ligsht me dekë.
Atëherë rrinë në shtëpi brenda dhe shikojnë
gjërat e çuditshme në pasqyra të varura keq

që vihen mbi komodina. Dhe njëri nga bijtë
del në mbrëmje para derës, fizarmonikës i bie
e i nxjerr një tingëllimë të butë porsi një e qarë;
ashtu siç e ka dëgjuar atë në një port të huaj -.
E tutje nis e merr njëra nga delet trajtë, pothuaj
kërcënuese, e madhe fort, mbi pritën e parë.

III

Pranë është veç brendia; gjithçka tjetër larg. Paq
është e zënë ngushtë ajo brendi, e rrëmbushur plot
përditë me gjithçka dhe e papërshkrueshme dot.
Ishulli është porsi një yll fort i vogël, i vogël aq

sa hapësira nuk e vë re dhe e shkatërron pa zë
në të qenit e vet pa vetëdije e frikshme, e pamatë
e kështu ai, pa iu vënë veshi, i pandrirë, nëpër të
fillikat

që e gjitha kjo të marrë sidoqoftë një herë fund
rreket të ecë, i errët, në një orbitë të stisur vetë
rreket verbërisht, në planin për kometa e planete,
diej e sisteme, pa u marrë parasysh e asgjëkund.

Paris, 23 korrik - 20 gusht 1907

Rainer Maria Remark, vepër e piktorit Leonid Pasternak



Yu Hua

TE JETOSH

OnufriRoman